



BEDER JOURNAL OF HUMANITIES

ISSUE:3 VOLUME: 1 SPRING 2014





HËNA E PLOTË BEDËR UNIVERSITY

About the Journal

Beder Journal of Humanities (BJH) is a peer-reviewed journal published by Hëna e Plote Beder University Faculty of Humanities.

The main objective of BJH is to provide international scholars an intellectual platform for the exchange of contemporary research.

The journal publishes research papers in the fields of Humanities such as Anthropology, Communications, Education, Economics, Environmental Sciences, History, Health Sciences, International Relations, Law, Literature, Philosophy, political Science, Psychology, Religious Studies, and Sociology.

BJH publishes original academic paper, review papers, case studies, empirical research, and book review. Special Issues devoted to important topics in humanities will be published occasionally

Editorial Board:

- **Prof. Dr. Ayhan Tekineş** (Editor in chief)
“Hëna e Plotë” (Bedër) University, Albania
- **Assoc. Prof. Dr. Rahim Ombashi**
“Hëna e Plotë” (Bedër) University, Albania
- **Dr. Bayram Karci**
“Hëna e Plotë” (Bedër) University, Albania

Assitant Editors:

- Ramadan Çipuri
- Ada Güven

International Advisory Board

- **Prof. Dr. İsmail Albayrak**
Australian Catholic University, Australia
- **Prof. Dr. Ednan Aslan**
University of Wien, Austria
- **Prof. Dr. Ferit Duka**
Tirana University, Albania
- **Prof. Dr. Kudret Cela**
Tirana University, Albania
- **Prof. Dr. Hans Köchler**
Innsbruck University, Austria
- **Prof. Dr. Admiel Kosman**
Potsdam University, Germany
- **Prof. Dr. Jon Pahl**
Lutheran Theological Seminary, USA
- **Prof. Dr. Ismet Busatlic**
University of Sarajevo, Bosnia and Herzegovina
- **Prof. Dr. Mark Webb**
Texas Tech University, USA
- **Prof. Dr. Altin Shegani**
Tirana University, Albania
- **Prof. Dr. Paul Weller**
University of Derby, U.K.
- **Prof. Dr. Briseida Mema**
“Hëna e Plotë” (Bedër) University, Albania
- **Prof. Dr. Ardian Nuni**
Tirana University, Albania

• Prof. Dr. Qazim Qazimi

- Prishtina University, Kosovo
- **Prof. Dr. Adnan Aslan**
Süleyman Şah University, Turkey
- **Prof. Dr. Zekerija Sejdini**
University of Innsbruck, Austria
- **Prof. Dr. Cafer Sadık Yaran**
Ondokuz Mayıs University, Turkey
- **Prof. Dr. Francesco Zannini**
Pontificio Istituto di Studi Arabi e d'Islamistica, Italy
- **Assoc. Prof. Dr. Mark Marku**
Tirana University, Albania
- **Assoc. Prof. Dr. Muhamed Ali**
Islamic Science Faculty, FYROM
- **Assoc. Prof. Dr. Zeki Sarıtoprak**
John Carrol University, USA
- **Assoc. Prof. Dr. Agron Tufa**
Tirana University, Albania
- **Assoc. Prof. Dr. Faredin Ebibi**
Faculty of Islamic Sciences, Macedonia
- **Dr. Ferdinand Gjana**
“Hëna e Plotë” (Bedër) University, Albania

Journal Details:

Publisher:

Hëna e Plotë Bedër University, Faculty of Humanities

Publication Frequency:

Biannual
ISSN: 2306-6083

Email: bjh@beder.edu.al

Phone: +35542419200

Address: Rr.Jordan Misha, Tirana, Albania



Contents

Prof.Dr. Ayhan Tekineş Editorial.	7
Prof.Dr.Artan Fuga Etnokracia. A mund të jetë garant për paqen ?.....	9
Agron Tufa Roli i Mediave për njohjen e Krimeve të Komunizmit.....	20
Prof. Dr. Ali Fuat Bilkan Klâsik kùltùrùmuzde bariş dili.....	31
Prof.Dr. Cafer S. Yaran The Role of Wrong Conception of Human Nature in (Ethical) Crises from Plato to the Present Day	36
Dr. Enri Hide Identiteti dhe politika: Islami politik si vektor gjeopolitik në Lindjen e Mesme.....	42
Fatmir Shehu Inter-Religious Dialogue and Contemporary Peace-Building: From Hostility to Mutual Respect and Better Understanding.....	59
Dr. Gapur Oziev The Role of Socio-Cultural and Religious Factors in Peace Building the Case of Ingushetia (Russian Federation).....	77
Dr. Mehmet Yavuz Şeker Tasavvuf'un Barış/Huzur Eğitime Katkısı.....	92
Prof. Dr. İbrahim Özdemir Promoting a culture of Peace and Tolerance through Education.....	106
Prof. Dr. Osman Güner Barış İnşasının Temel Bir Dinamiği Olarak 'Müspet Hareket' Prensibi; Barış İnşasına Duyulan Özlem.....	117
Prof. dr. Rami Memushaj Ndikimi i lajthitjeve leksiko-semantike në përkapjen e mesazhit.....	134
Ferdinand Gjana, PhD, Nereid (Redi) Shehu, Msc Social Conflict as a Consequence of Freedoms Imbalance	145
General Guidelines.....	165

Editorial

Prof.Dr. Ayhan Tekines

Journals are nurseries for ideas to sprout. Sometimes, new ideas flourish and grow up first time in journals. Critiques and commentaries of society encourage authors to revise and develop their ideas and opinions.

With the recent developments in vocal and visual media, it is very easy to reach speeches of various intellectuals. Although these speeches have some unique features, writing always preserve its advantages like protection of knowledge and text critique. As keeps and protects information and ideas, writing reproduces itself with additions. It can also be deconstructed. With these characteristics, it is impossible to put aside writing.

Since we believe the importance of journal publishing in writing culture, we present third edition of our journal. In this edition, articles on peace have a wide coverage. We hope that these articles, selected from the conference of "Peacebuilding", will make significant contribution to our intellectual world.

Peace has always worthy place in human life. However, dissemination of "peace culture" is much more important to protect peace to prevent conflicts.

Globalization caused that everything have opportunity to reach almost every corner of the world indifferent to whether it is good or evil. Since today goodness has great opportunities to expanse like evil, we spread on effort to support every initiative on behalf of peace.

In this edition of our journal, there are articles treating east-west synthesis regarding peace. First article is "Can ethnocentric media afford the expression of cultural diversity?" written by Artan Fuga, notable intellectual of Albania.

Moreover, you have opportunity to reach President of Ipek University Ali Fuat Bilkan's article on the relation of peace and language. In his article, Mr. Bilkan examines the importance of spoken language's decontamination from vulgar and impolite wordings by presenting examples.

In the article "Promoting a culture of Peace and Tolerance through Education", İbrahim Özdemir, prominent with his researches on education, approaches to peace from the aspect of globalization and education.

We attach great importance to the contributions of different countries' intellectuals. There are articles of Gapur Oziev and Fatmir Shehu from Malaysia. Gapur Oziev made significant contribution with his article on the influence of socio-culture and religion on peacebuilding Ingushetia, from Caucasus which shows resemblance to Balkans with some aspects.

Our journal increases its quality with every edition. We hope to meet you with richer content in next edition.

Hëna e Plotë Bedër University, BJH Editor in chief, Tirana, Albania,
Email: atekines@beder.edu.al



Prof.Dr.Artan Fuga

Etnokracia. A mund të jetë garant për paqen ?

Abstract

The issue of the role of mass media in building peace and preventing wars, conflicts and tensions should be viewed from global, regional and local levels. From this point of view, the question of the relationship between mass media and ethnic and national relations appears at the forefront. It is clearly evident not only at global level, but also in the Balkan region, especially in the former Yugoslav region where there have been wars and high national and ethnic tensions. Although it seems that the war is over, serious levels of ethnic hatred, ethnic enclavisation, anger and ethnic stereotypes still continue to exist in the area.

Theoretically, the mass media can play various roles within this context. They can serve as bridges of cooperation, understanding and cultural diversification, but they may also have a negative role in promoting ethnic hatred, informative isolation, ethnocentrism and ignoring or creating a completely negative image of other nations and ethnic groups.

In one way, actual state and administrative borders have become more flexible. However virtual boundaries, set up by the media in the form of "walls" and "trenches", are becoming more acute forms of economic, cultural and social segregation of various ethnic groups and nations that often share the same territorial space.

Media and strategic communication, as a separate field dealing with problems regarding the role of the media in national and international relations, should be considered as one of the main issues related not only to reviewing the media landscape, but also the full geopolitical, cultural and social context of the region.

Two basic concepts need to be considered in a more prominent and central manner, along with many other concepts that require special effort to analyze them specifically.

The first concept is the, so called, "ethnic media" and their role in creating a public space where various cultures clash or cooperate. The idea is to explain what they represent today, particularly in the Balkans, and what role they can play in building peace and

* Prof.Dr., Akademik, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri, Email:
afuga@neuf.fr

intercultural cooperation. Yes, their relationship with ethnocracy should also be analyzed along with the issue of how independent they are as they are transformed from being politically controlled media (by certain ethnic elites) into becoming media serving the public regardless of their ethnic backgrounds.

What will we call multicultural media and landscape is often noted as an incomplete concept. Above all, it is implemented in a way that, instead of creating active cooperation between nations and ethnicities, is transformed into a mechanism leading to misunderstandings, segregation, and the distortion of the image of other nations and ethnicities, promoting tensions and conflicts among them.

Freedom of expression should not only be equated with building ethical language and quality information, but it must be recognized that there is often an abuse of freedom of expression in the media. It is uncontrolled by ethical codes that guarantee peace, social cooperation and stable relations between nations and ethnicities. In terms of online media, language of hatred has taken other expressions and is often structured in an uncontrollable form. It makes intercultural communication a virtual battlefield between individuals who do not have even minimum respect for ethnic codes that are universally accepted. The transition of communication from professional journalism to civic journalism, despite its positive effects, carries the risk of promoting hostile passions under the influence of nationalist extremist groups.

If we observe the content of the two concepts in the building of the Balkan media landscapes, we can open new ways of exploring scientific reasoning, to discuss the deviances from the role needed to be played by the media in an intercultural and multicultural world. They build "facades" of identity for "themselves" and for "others". What corrections or emancipatory efforts can be made to enable the virtual barriers become bridges of cooperation? These areas already require conceptual clarification as well as detailed analysis of programs such as: transmission strategy; editorial analysis; human resource policies; linguistic strategies and funding. Therefore everything that has to do with media management.

It will be seen that in many aspects of the Balkans, the cultural diversity is understood from an ethnocentric viewpoint. Other viewpoints are mostly accepted as a collective projection of the media

These analyses are not considered simply as theoretical, but also as intellectual research methods helping to enable the scientific community to achieve expertise and write reviews which lead to proposals for decision makers. As a consequence, social engineering for building and financing local or global media landscapes would match the peoples' aspirations for peace and democracy.

1. A është liria siguri për paqen?

Kuptohet se ndërtimi i marrëdhënieve të bazuara mbi paqen dhe mirëkuptimin midis popujve dhe kombeve është një proces i ndërlikuar dhe i vështirë. Veç analizave empirike të fokusuara në rajone të ndryshme të botës, ku zona e Ballkanit na intereson më shumë si shqiptarë, realiteti kërkon edhe analiza që larg skemave ideologjike të gatshme dhe të marra në mënyrë të ngurtë, të jenë të bazuara mbi koncepte dhe marrëdhënie konceptuale të vlefshme dhe që gjenerojnë kuptimësi të dukurive të reja gjeopolitike dhe gjeokulturore.

Nisur këtej, ka vend të mendohet se cila është marrëdhënia midis lirisë dhe paqes. Kuptohet që regjimet diktatoriale, që ndrydhnin qytetarët, minoritetet kombëtare dhe etnitë, janë shkak për tensione dhe konflikte të armatosura, për çekuilibre në marrëdhëniet shoqërore, duke prodhuar dhunë dhe barbari. Përvoja e Ballkanit, por edhe ajo e zonave të tjera të Planetit, e provon këtë. Mirëpo, po ta shohim me kujdes gjendjen në këto dekadat e fundit, realiteti flet se edhe në kushtet e lirive politike për qytetarët dhe kombet e etnitë brenda një shoqërie dhe e një shteti, si edhe në marrëdhëniet ndërshtetërore, ka mundësira dhe rreziqe që krijojnë tensione ndëretnike, formësojnë parakushte për destabilizim politik dhe lëkundje të proceseve paqësore të demokratizimit.

Kur flitet për liritë, pa dyshim ndër më themeloret, për të mos thënë më themelorja, është ajo e fjalës, e të shprehurit lirshëm, e pjesëmarrjes të lirë në hapësirën publike të diskutimit, e lirisë së mediave që duhet të shprehin një diversitet kulturor të pasur, çka jep parakushte edhe për marrëdhënie besimi reciprok, si bazë për sigurimin e paqes. Këtu media shihet në një plan shumë të gjerë, duke përfshirë jo vetëm mediat masive klasike, por edhe komunikimin në linjë, komunikimin e përditshëm midis qytetarëve në hapësirat e tyre private apo në hapësirën publike, debatin politik, pra në fakt gjithë strukturimin dhe ristrukturimin e të shprehurit brenda një shoqërie të caktuar. Paqja, , para sesa të jetë produkt i praktikave dhe i strategjive të caktuara, është një realitet konceptual, është ide, strukturim përfytyrimesh, pra realizohet si fillesë dhe si aksion nëpërmjet komunikimit. Nga kjo pikëpamje, ka vend të jepet edhe një përjasje nga pikëpamja e shkencave të komunikimit, e faktorëve që rrisin potencialin paqësor dhe demokratik të një shoqërie sidhe ato që mënjanojnë faktorët e dhunës dhe të tensionit midis grupeve të ndryshme shoqërore dhe etnike e kombëtare.

Duke e parë problemin në këtë rrafsh, theksojmë se Konventa – kuadër evropiane mbi të drejtat e minoriteteve, e formuluar gati njëzet vite më parë dhe e aprovuar nga Këshilli i Evropës, thekson se sidomos në shoqëritë me diversitet kulturor, liritë dhe të drejtat e etnive, minoriteteve kombëtare, e kombeve janë bazë për të mundësuar shoqëri të lira, të qëndrueshme dhe paqësore. Artikulli numër 9 i kësaj Konvente pohon se : « Palët angazhohen për të pranuar se e drejta e lirisë të shprehjes për çdo person që i përket një pakice kombëtare përfshin lirinë e shprehjes të opinionëve dhe lirinë për të marrë ose komunikuar informacione apo ide në gjuhën e vet minoritare, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Përsa i përket aksesit në media, palët bëjnë kujdes që

në kuadrin e sistemit të tyre legjislativ, personat që i përkasin një pakice kombëtare të mos jenë të diskriminuar».

Në kushtet e rajonit ballkanik, këto dhjetë apo pesëmbëdhjetë vitet e fundit janë bërë hapa të rëndësishme përpara, lidhur me të drejtat dhe liritë e pakicave kombëtare, etnive, apo kombeve që jetojnë brenda kufijve të një shteti. Sigurisht që shqiptarët, sikurse edhe kombet e tjerë ballkanikë, kanë qenë dhe mbeten shumë të interesuar për këto liri dhe të drejta, duke ditur se harta e kufijve territorialë në Ballkan dhe ajo e shpërndarjes etnike ka mospërputhje të konsiderueshme. E vërteta është se gjatë këtyre dekadave, sidomos përgjatë viteve 2000, janë bërë hapa pozitivë përpara : Shkollimi në gjuhët amtare, botime në këto gjuhë, liberalizimi i peizazhit mediatik, lindja dhe përforcimi i mediave etnike apo në gjuhët kombëtare, komunikimi i lirë në linjë dhe mediat e lira në internet, njohja si gjuhë zyrtare në shkallë krahinash a më gjerë i gjuhëve të pakicave kombëtare, etj., janë procese që përbëjnë hapa për konsolidimin e paqes dhe bashkëpunimit rajonal.

Mirëpo çështja është më e ndërlikuar sesa kaq. Pyetja që shtrohet është nëse liritë dhe të drejtat politike për të pasur media, në kuptimin e gjerë të diversifikuara, a realizojnë edhe shoqëri ku parimi i diversitetit kulturor të jetë i garantuar dhe konkret? Liria e shprehjes kulturore, arsimore, artistike dhe mediatike a janë të mjaftueshme për të siguruar komunikimin paqësor, bazuar te respekti i parimeve të shprehjes të diversitetit kulturor ?

Parë kështu, nuk mund të mos konstatojmë se Ballkani sot kalon një fazë, kur peizazhet kulturore përfitojnë gjithmonë e më tepër nga liritë dhe të drejtat lidhur me lirinë e shprehjes të identiteteve etnike, fetare dhe kombëtare. Ndërkaq, sikurse na tregojnë monitorime të shumta të përmbajtjes të shprehjes politike, mediatike, kulturore, etj., nuk mund të thuhet se gjuha e urrejtjes etnike është shmangur, përkundrazi, ka raste krizash, kur ajo arrin nivele të larta, megjithë legjislacionin që e ndalon këtë. Botimet dhe përkthimet nga njëra gjuhë te tjetra janë në nivele minimale. Arsimi shumëgjuhësh brenda institucioneve publike shoqërohet me ndarjen e klasave sipas gjuhëve të tyre kombëtare, pra në thelb është formal. Aktivitetet e përbashkëta, ku të kryqëzohen kulturat artistike të kombeve dhe etnive të ndryshme, janë fare të rrallë. Shpërndarja e studentëve sipas universiteteve ku fliten gjuhët përkatëse kombëtare është bërë pothuajse rregull. Njohja reciproke e gjuhëve kombëtare nga bashkësitë etnike të ndryshme është zbehur. Mediat në gjuhë të ndryshme u drejtohen së tepërmi audiencave që përdorin që në lindje gjuhët përkatëse.

Nga kjo pikëpamje kemi nevojë jo vetëm të shtrojmë çështjen e marrëdhënieve midis lirisë dhe paqes, por edhe midis diversifikimit të peizazhit të institucioneve kulturore, shkollore, mediatike, artistike, nga njëra anë, dhe realizimit të komunikimit paqësor sa më fluid ndërkulturor midis pjesëve të ndryshme të shoqërisë. Faktet na tregojnë se njëri nuk nënkupton medoemos tjetrin. Nuk mund të mohohet se shpesh në media mbisundon fryma e mosbesimit reciprok, e tensioneve verbale, e stigmatëve etnike, e stereotipeve diskriminuese, nuk përjashtohet edhe gjuha e urrejtjes ekstreme, çka sigurisht janë faktorë

që **nuk** çojnë në garantimin e paqes, por përmbajnë rrezikun e tensioneve dhe konflikteve ndëretnike.

2. Kontrolli etnokratik i mediave

Pyetja është se përse liritë e shprehjes janë shoqëruar edhe me përdorimin e një gjuhe urrejtjeje që i minon dhe i rrezikon proceset paqësore, përse ndërtimi i një peizazhi mediatik, institucional dhe kulturor i diversifikuar jo medoemos krijon një komunikim ndërkulturor në shoqëri ? Pra, përse liritë politike dhe të shprehjes shoqërohen me rreziqe për paqen dhe stabilitetin social të shoqërisë ?

Lidhur me sa më sipër, do të arsyetoj nisur nga një studim i kryer bashkë me kolegë të tjerë, lidhur me mediat multikulturore në rajonin e Ballkanit, mbështetur nga katedra e UNESCO-s në shkencat e komunikimit, në Universitetin e Strasburgut, si edhe nga një lexim i bibliografisë në këtë fushë studimore.

Pas thërmimit të ish Jugosllavisë dhe lindjes e formësimit të shteteve kombëtare në këtë zonë të Ballkanit, një sërë procesesh demokratizuese ndodhën edhe në fushën e kulturës, lirive të shprehjes mediatike dhe të opinioneve, si e dhe në sektorin e arsimit. Hapësira e opinionit publik u diversifikua sepse atje nisën të shprehen më lirisht edhe etnitë dhe pakicat kombëtare, dikur të privuara dhe nën shtypje kombëtare. Paqja dhe liritë politike sollën një diversifikim të perspektivave kulturore në zonë.

Ndërkohë, me mediat të kuptuara në kuptimin më të gjerë të fjalës, pra, si media informative masive, si industri kulture, pra, e filmit, e botimeve dhe e shprehjes artistike në përgjithësi, si institucione shkollore, etj., ndodhën procese të cilat bënë që duke qenë të lira, ato mbetën nën kontrollin e elitave politike dhe administrative përkatëse në rrafsh kombëtar, rajonal, komunal, madje edhe kur ato kanë një pronësi private. Në një kuptim të caktuar dhe disi natyrshëm, këto elita politike, administrative dhe ekonomike pas lufte dhe në periudhën postdiktatoriale, nisur nga fakti se kishin një legjitimitet fillestar të marrë nga përpjekjet për liri dhe pavarësi kombëtare dhe të drejta etnike, nisur nga ideja se edhe në periudhën paqësore mbartnin në sytë e opinionit publik një mision etnik dhe kombëtar, nisur edhe nga retorika e tyre fillestare e idesë kombëtare, pa asnjë konotacion negativ, konsiderohen edhe si elita etnokratike. Legjitimiteti i tyre shtrihet veç në aspektin kombëtar edhe brenda grupit etnik që përfaqësojnë, apo brenda rajonit ku ky grup jeton. Pra, këto elita etnokratike shfaqen edhe si grupe kontrolluese të pushteteve legjitime në plan shtetror, edhe si elita partiake, por edhe si pushtete financiare dhe ekonomike me lidhje të fuqishme me politikën, që duke pasur një identitet patriotik të dallueshëm, një retorikë nacionaliste, përdorin përgjithësisht një rrjet financiar dhe një ekonomi etnike e llojit të veçantë.

Nisur nga ideologjia dhe retorika politike e kuptueshme e elitave etnokratike, edhe mediat dhe institucionet arsimore dhe kulturore nën kontrollin e tyre të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, sigurisht që do të reflektonin të njëjtin qëndrim, strategji krijimi dhe transmetimi të vlerave arsimore, artistike dhe kulturore e mediatike.

Po të shohim infrastrukturat e mediave, shkollave dhe institucioneve kulturore në zonën e Ballkanit, ajo më së shumti paraqet katër tipologji të ndryshme :

a. **Infrastrukturat publike**, pra mediat audiovizive publike, shkollat dhe universitetet publike, institucionet artistike publike, etj. Të gjitha këto infrastruktura, në plan kombëtar, drejtohen dhe kontrollohen nga pushteti ekzekutiv ose janë nën kontrollin parlamentar, që në fakt është ai i elitave etnokratike kombëtare.

b. **Infrastruktura nën kontrollin e pushteteve komunale**, ku elitat etnokratike janë të diversifikuara në bazë të rajonit, ku është instaluar bashkësia që ato përfaqësojnë. Retorika etnokratike në këtë nivel është edhe më e theksuar, sepse ato janë më afër elektoratit të tyre dhe tensionet mes bashkësive etnike janë më të ndjeshme.

c. **Mediat apo infrastrukturat kulturore dhe arsimore private**, të cilat kontrollohen dhe ushqehen si nga administratorët ashtu edhe nën presionin e audiencave të klientëve me ndërgjegje të theksuar etnokombëtare, me ideologjinë dhe praktikat etnocentrike përkatëse.

d. **Format e komunikimit qytetar në linjë, rrjetet sociale**, të cilat nën humorin dhe influencën e përdoruesve dhe audiencave të tyre, dihet se janë shprehëse e frustrimeve kolektive, bien pre më shpejt se të gjitha llojet e tjerë të mediave të një shprehjeje, ku mbisundon stereotipi kulturor, stigmatet ndaj kombeve dhe etnive të tjera, izolacionizmi kombëtar dhe, sidomos, gjuha e urrejtjes ndaj tjetrit.

Mbizotërimi i infrastrukturave të shprehjes publike nga etnokracia në nivel qendror dhe rajonal (komunal), apo nga elita ekonomiko-politike me prirje etnokratike, është një fakt i mirëkuptuar në periudhën postluftë dhe postdiktatoriale. Dihet se liritë politike dhe ato kulturore, mundësitë për të ardhur në një proces tranzitor paqeje, pas dekadash represionesh kombëtare dhe politike, rrjedhojnë nga idealet kombëtare dhe për pohimin e të drejtave etnike në të gjitha identitetet kombëtare të vendeve ballkanike. Puna është të dihet nëse strukturimi i hapësirave politike dhe i atyre të hapësirës publike të shprehjes, sipas logjikës etnokratike, jep mundësi për një paqe afatgjatë, për harmoni kombëtare dhe etnike në Ballkan, si edhe për një emancim dhe komunikim të vërtetë ndërkulturor në shoqëritë ballkanike.

Ideologjia dhe botëkuptimi etnokratik shoqërohen me realizime pozitive, që nuk mund të mohohen. Në një farë mase, ato janë ushqyer nga frymëzimi kombëtar, i cili është një vlerë humane e rëndësishme. Mediat dhe kultura, arsimit dhe arti, që frymëzohen nga etnokracia, në një farë kuptimi, paraqiten edhe si ruajtës të traditave shpirtërore kombëtare. Ato vigjilojnë që bashkësitë etnike të mos pësojnë tragjizmat e së shkuarës, kësaj janë një lloj barriere ndaj politikave të mundshme diskriminuuese. Përpos këtyre, ideologjia etnokratike shërben edhe për një ngjizje të fortë të solidaritetit social brenda bashkësisë etnike ose të pakicave kombëtare.

Veç këtyre aspekteve, etnokratizmi ushtron edhe ndikimet e veta mbi mediat, kulturën, artin, shprehjen e opinionit shoqëror dhe komunikimin ndërkulturor në përgjithësi. Ka ardhur koha, që këto elemente të njihen dhe të mbahen parasysh duke e trajtuar gjuhën e përjashtimit dhe urrejtjes kolektive ndaj bashkësive të tjera etnokombëtare si jo të rastit, as

thjesht dhe vetëm si inerci e fantazmave të së shkuarës, por si produkte sistematike të një realiteti mbizotërues, i kontrolluar nga elitat etnokratike respektive.

Sidomos në media, marrë gjithmonë në kuptimin më të gjerë të tyre, etnokracia si ideologji dhe strategji shprehjeje publike e vendos informacionin e ekuilibruar, të gjithanshëm, të saktë, nën thundrrën e propagandës, e krijimit të “brandit” kombëtar, si edhe në funksion të propagandës. Në këtë suazë bien jo vetëm mediat dhe infrastrukturat publike, por edhe ato private. Sikurse thekson studuesi amerikan Art Silverblatt : “Madje edhe në vendet ku media është me pronësi private, qeveritë i kanë përdorur mediat si një vektor propagande.”¹ Nuk duhet harruar se shpesh koncepti etnokratik mbi informacionin e shmang informimin e saktë dhe të plotë të audiencave nën pretekstin e mbrojtjes së interesit të grupit etnik. Ndodh që këto dy aspekte edhe përputhen, por qëllon edhe që ato hyjnë në konflikte të pjesëshme apo tërësore midis tyre. Mediat e kontrolluara nga etnokratitë e kanë të pamundur që në këto raste prioritetin t’ia japin informacionit dhe jo spekulimeve ideologjike etnonacionale.

Nuk duhet harruar gjithashtu se, në kushtet e mbizotërimit të strategjive etnokratike, kultura dhe informacioni, krijimtaria artistike e subvencionuar nga pushtetet përkatëse, ka prirje të drejtohet dhe të frymëzohet nga etnocentrizmi, ku vlerat, zakonet, perspektivat e kujtesës historike kolektive, traditat kulturore të çdo kombi, vendosen në qendër, ku grupi e sheh kolektivisht botën, shoqërinë, të shkuarën dhe të ardhmen, thjesht si projekte të subjektivitetit të vet, duke u mbyllur karshi të tjerëve. Vetëlavdërimi kolektiv bëhet në këto raste mënyra e interpretimit të të gjitha të dhënave kulturore, bëhet logjika përjashtuese e ngjarjeve historike. Mediat etnokratike, sikurse theksohet edhe nga studiuesi Alan O’Konor janë “Procese bindjeje në të cilët ne jemi ftuar për të kuptuar botën në një farë mënyre dhe jo në një mënyrë tjetër.”² Mbi këtë bazë, në të gjitha konfrontimet kulturore dhe historike, syzet e etnocentrizmit mbivlerësojnë natyrshëm qendrimet, sjelljen, perspektivën e bashkësisë etnike ose kombëtare, që e zhvillon atë, duke nënvlerësuar dhe përbuzur përvojat dhe vlerat e të tjerave.

Në këtë kuptim, mediat demokratike dhe ato etnokratike, kanë një dallim të madh parimor midis tyre. Nëse të parat kanë synim të informojnë realisht audiencat dhe qytetarin për aktualitetin, të dytat e kryejnë këtë rol, duke informuar në funksion të strategjive editoriale të udhëhequra nga vlerat etnike. Kjo bëhet bazë për riprodhimin dhe shpërndarjen e stereotipeve dhe stigmatëve kolektive kundër etnive dhe bashkësive të tjera fetare e kombëtare, duke nxitur gjuhën e urrejtjes dhe të mosbesimit të ndërsjellë.

Mirëpo jo rrallë qendrimet etnokratike dhe ideologjia në fjalë i tejkalon fort nevojat e bashkësive etnike për vetëmbrojtje dhe vetëpohim. Kjo ndodh sidomos kur ndërmerren fushata elektorale, brenda të cilave elitat politike etnokratike përdorin mediat për të arritur tre qëllime pragmatike : Së pari, për të mobilizuar elektorin etnik në përballje me elektoratin e partive të tjera politike me identitet etnik të ndryshëm. Së dyti, për të reduktuar

¹ Art Silverblatt, *Media Literacy*, p. 215, Praeger, London, 2008

² Alan O’Konor, *Culture and Communication*, p. 37, Sage Publications, 1990

numrin e elektoratit pasiv dhe nxitjen e tij për të votuar. Së treti, për të zvogëluar elektoratin e partive të tjera me të njëjtën bazë etnike, duke i cilësuar ato si tradhtarë, kolaboracioniste, jo patriotike, etj. Në të tre rastet, ideologjia etnokratike, ndonëse e udhëhequr nga faktorë ambiciozë politikë, legjitimohet duke nxjerrë përpara publikut të gjithë arsenalin e armëve të propagandës që anatemojnë bashkësitë e tjera etnike, elitat e tyre etnokratike dhe rivalët e tyre brenda të njëjtës bashkësi kombëtare.

Nën ndikimin e strategjive etnokratike, kultura dhe informacioni, e gjithë hapësira publike, shndërrohen në një univers të përbashkët, që udhëhiqet nga fakti i shndërrimit të informacionit mediatic dhe e kulturës në një instrument të komunikimit strategjik, pra, si mjete arritjesh dhe qëllimesh strategjike në planin e jashtëm, qoftë jashtë shtetit, qoftë jashtë mjedisit të grupit etnokombëtar. Mirëpo, në kushtet kur komunikimi i sotëm dhe teknologjitë bashkëkohore e kanë bërë të pamundur dallimin midis komunikimit me jashtë dhe komunikimit brenda grupit ose kombit, taktikat e komunikimit strategjik në fjalë krijojnë pasoja edhe në informimin e brendshëm qytetar. Në rrafsh kombëtar, mediat etnokratike funksionojnë në format dikotomik, bardh e zi, me stereotipe, si forma promovimi kombëtar dhe etnik, dhe bëhet e pamundur për qytetarin që të orientohet si duhet brenda një universi tensionesh etnike.

Informacionet, kultura, botimet, linjat editoriale të mediave, diplomacia kulturore e shtetit, strategjitë e shërbimeve publike, gjithçka vihet në funksionim të mbërritjes të qëllimeve të promovimit kombëtar. Media dhe kultura humbasin kështu gradualisht aftësinë për të qenë kritike ndaj elitave etnokratike, sa kohë që konsiderohen faktikisht si instrumente komunikimi strategjik. Mediat orientohen jo drejt kritikës të devijimeve të elitave etnokratike në marrëdhënie me qytetarët e bashkësisë së tyre, por përpiqen ta mobilizojnë këtë bashkësi kundër grupeve të tjera etnokombëtare. Sikurse citohet nga studjuesi amerikan Christopher Paul, komunikimi strategjik e konsideron median pjesë e gjithë sistemit të mjeteve për të arritur qëllime në rivalitet me botën jashtë shtetit, kombit ose grupit etnik. Ai citon se : “Cilitdo nivel komandimi i nevojitet një strategji për koordinimin dhe sinkronizimin e temave, mesazheve, imazheve dhe veprimeve në mbështetje të objektivave të komunikimit strategjik duke siguruar integritetin, qendrueshmërinë e temave dhe mesazheve, duke nisur nga niveli taktik më i ulët.”³

I gjithë ky transmetim i mediave etnokratike në instrumente komunikimi strategjik dhe diplomacie publike mbështetet në sistemin e krijimit të iluzionit të pastërtisë të vlerave etnike të çdo bashkësie, kundrejt degjenerimit të vlerave të bashkësive të tjera. Mbi këtë bazë, e gjithë shoqëria rrezikon të lëkundet dhe kërruset nën peshën e gjuhës të urrejtjes, moskuptimeve të ndërsjella etnike, propagandës armiqësore. Mjedisit i shoqërive multikulturore shndërrohet në një fushë beteje midis strategjive të kundërta etnokulturore dhe etnokratike. Sigurisht, nga pikëpamja formale dhe institucionale, sikurse parashikon edhe Konventa – kuadër e të drejtave të pakicave kombëtare, edhe në këtë kontekst kemi

³ *United States Joint Commander's Handbook for Strategic Communication and Communication Strategy*, Suffelk, June, 24, 2010, p. II - 11

një liri shprehjesh socioetnike dhe sociokulturore, por nga mënyra sesi funksionon ky sistem, ai më shumë prodhon moskuptime dhe moskomunikim ndërkulturor, duke krijuar kështu ‘geto kulturore’, nga pikëpamja etnike dhe kombëtare. Peizazhi është multikulturor, kurse komunikimi ndërkulturor e ka vështirë të ekzistojë, sepse nën kontrollin e etnokracisë ai izolohet dhe përmbillet brenda universeve monologuese dhe armiqësore me njëri-tjetrin.

3. Audiencat totalizuese etnike

E drejta e shprehjes të lirë për pakicat kombëtare ose grupet etnike nuk mjafton ende për të pasur një komunikim ndërkulturor efikas që do të krijonte kushtet e një marrëdhënieje paqësore të qendrueshme në shoqëri. Peizazh mediatik multikulturor nuk do të thotë akoma edhe diversitet kulturor në informacionin publik dhe në produktin mediatik. Ngatërrimi i këtyre dy koncepteve sjell moskuptime dhe errësime në analizën e gjendjes reale.

Le të mos harrojmë se në kontekstin ballkanik edhe ato media audiovizive publike, që transmetojnë edhe në gjuhën e minoriteteve etnike apo bashkësive kombëtare, e bëjnë me një numër të kufizuar orësh, a thua se orët e transmetimit dhe numri i individëve, që bëjnë pjesë në këto pakica, kanë lidhje me njëri-tjetrin. Për më tepër, sikurse vihet në dukje në shumë raporte monitorimi, transmetimet në gjuhët minoritare në fushën e informacionit janë shpesh përkthime të informacioneve në gjuhën kryesore zyrtare. Nga ana tjetër, redaksitë e gjuhëve minoritare varen nga menaxhimi i përgjithshëm administrativ i institucionit, i cili kontrollohet nga klasa etnokratike e kombit numerikisht më të madh. Po kështu ndodh edhe me stacionet radiotelevizive komunale si edhe me ato private, ku, po të thuash të drejtën, shumëgjuhësia e transmetive është fare e rrallë ose tepër e reduktuar në orë dhe lloje transmetimesh. Në këto të dytat, privatet, ato jo vetëm ndodhen nën presionin e elitave etnokratike për të marrë subvencione, reklama, lejezyrtare, etj., por edhe nën presionin e audiencave lokale, të cilat në rastet më të shumta janë bashkësi etnike dhe kombëtare lokale. Fidelizimi i audiencave shpesh kalon me të njeëjtën strategji bindjeje, sikurse është rasti në politikë, pra, duke mbajtur një nivel ideologjizimi etnokratik të lartë.

Në këtë mënyrë peizazhi mediatik shumëkulturor dhe i diversifikuar, në fakt, jep një pasojë perverse, të kundërt me atë që pritej parimisht, sepse për audienca të ndryshme, me identitet kombëtar dhe etnik të ndryshëm, sipas funksionimit teorik dhe praktik të audiencave, jep sisteme informimi dhe mesazhe, që i izolojnë ato prej njëra-tjetrës. Peizazhi është shumëkulturor, porse çdo audincë nuk ndjek veçse ato media që përputhen me identitetin e saj gjuhësor, historik, kulturor.

Barazimi i padrejtë i informimit multikulturor me peizazhin multikulturor nuk mban parasysh faktin, që lidhet me konceptin e “përzgjedhjes” si koncept themeltar në shkencat e komunikimit masiv. Audiencat teknikisht mund të ndjekin të gjitha stacionet audiovizive dhe të konsumojnë të gjithë titujt e shtypit të shkruar, por realisht nuk ndodh kështu meqë

strategjia e tyre është ajo e “përzgjedhjes”.

Ka së paku gjashtë lloj përzgjedhjesh⁴ :

a. Sipas **ekspozimit ndaj medias** dhe informacionit kulturor e artistik apo edukativ, duke u hapur vetëm ndaj atyre që përputhen me vlerat e audiencës.

b. Sipas **perceptimit të informacionit**, që edhe kur ndodhet përpara të njëjtit material informues, audiencia kolektive e percepton sipas këndvështrimit të vet interesuar.

c. Sipas ruajtjes në kujtesë, duke lënë të kalojnë e rënë në harresë të gjitha informacionet që nuk përputhen me vlerat identitare.

d. Sipas **vëmendjes**, duke e shkëputur vëmendjen sa herë tingëllojnë informacione pa interes për audiencën.

e. Sipas **vlerësimit të egos kolektive**, çka bën që gjithçka nuk vjen në përputhje me vetëvlerësimin etnocentrik konsiderohet e parëndësishme dhe dizinformim.

f. **Sipas gjuhës**, meqë ndiqen ato stacione audivizive që kuptohen më mirë e lirshëm, pra, që transmetojnë në gjuhën amtare.

Nga kjo pikëpamje audiencat etnike, me sjelljen e tyre normale dhe të pritshme, përbushin atë që nisin elitat etnokratike, por këtë radhë nga “poshtë”, pra, si sjellje audiencash masive. Nga kjo pikëpamje ato vetizolohen dhe kërkojnë më pas që edhe media, të cilën ndjekin, të jetë në përputhje me pritshmëritë e tyre. Audiencat vetizolohen kulturalisht duke prodhuar grupe që përmbillen në vetevete sipas kriterit që politologu amerikan Michael Waltzer i quan “audiencia totalizuese”.

4. Modelet e komunikimit ndërkulturor

Ja, pra, se përse peizazhi multikulturor në media nuk prodhon medoemos një bazë për një komunikim demokratik, të çtensionuar, me baza mirëkuptimimis bashkësive etnike, por më shumë i izolon ato nga njëra-tjetra. Komunikimi ndërkulturor kërkon që infrastruktura e agjencive mediatike, e institucioneve kulturore dhe artistike, të ndërtohet ndryshe.

Po të niseshim nga një analizë tipologjike, do të thoshim se mund të veçoheshin katër modele matricash komunikimi në këtë rrafsh. Por, përpara sesa t'i paraqisim, do të na duhej të shpjegojmë terminologjikisht simbolikën e mëposhtme :

A1 (B1) – Kanali i transmetimit etnokombëtar

A2 (B2) – Komunikuesi dhënë me po atë identitet

A3 (B3) – Gjuha e transmetimit, kodiamtar

A4 (B4) – Objekti i raportuar, shoqëria respektive, grupi, institucioni etnokombëtar

A5 (B5) – Komunikuesi marrës, audiencat me po atë identitet etnokombëtar.

⁴ Art Silverblatt, *Media Literacy*, p.p. 23-24, Praeger, London, 2008

Tipologjitë do t'i ndanim në :

I. Monologuese : Promovim i brandit kombëtar

A1-A2-A3-A4-A5

II. Propaganduese, nëpërmjet komunikimit strategjik

1. Modeli i fortë

A1-A2-A3-A4-B5

2. Modeli i butë

A1-A2-B3-A4-B5

III. Akulturues, nëpërmjet një manipulimi të vetëndërgjegjes të grupeve të tjera

A1-A2-B3-B4-B5

IV. Multikulturor i plotë

A1-B2-B3-A4(B4)-A5(B5)

5. Përfundime

Ndërtimi i paqes sociale në shoqëritë multikulturele kalon nëpërmjet kulturës dhe institucioneve të saj mediatike, në kuptimin më të gjerë të tyre. Liritë politike janë të domosdoshme që të mundësohet shprehja e lirë e kulturave të grupeve etnokombëtare. Por kjo nuk presupozon patjetër edhe realizimin e një komunikimi ndërkulturor efektiv. Liria dhe paqja nuk janë dy vlera që e presupozojnë automatikisht njëra-tjetrën. Po kështu peizazhi mediatik shumëkulturor nuk nënkupton medoemos një produkt shumëkulturor dhe as një informim të hapur ndaj kulturave të tjerave. Mediat nën kontrollin e elitave etnokratike në pushtet ose jo, në kushtet e demokracisë, mund të ringjallin dhe mbajnë ndezur gjuhën e dhunës verbale, armiqësitë, t'i përforcojnë ato, nën sistemin e propagandave intensive mediatike. Prandaj ideologjitë etnokratike, që realizuan çlirimin kombëtar dhe emancimin etnik, jo medoemos janë të drejpërdrejta për ndërtimin e paqes shoqërore në periudhat postdiktatoriale dhe paslufte. Etnokracia, për qëllimet e saj, bashkuar me sjelljen e audiencave totalizuese dhe selektive të informacionit, prodhojnë geto kulturore dhe e ndajnë virtualisht shoqërinë në enklava etnike dhe sociale. Kuptimi i plotë i multikulturalizmit është kur ai gjen vend edhe në nivelin mikrosocial, pra, brenda agjencive mediatike, dhe jo thjesht në atë makrosocial, si formë e ndërtimit të peizazhit mediatik global, që nuk bën tjetër, veç riprodhon armiqësitë e vjetra në kushtet e një konteksti të ri, që janë demokracitë e brishta të shoqërive dhe shteteve shumëkulturore.

Agron Tufa*

Roli i Mediave për njohjen e Krimeve të Komunizmit

Abstrakt

Me rënien formale të sistemit komunist në Shqipëri nuk pati asnjë përpjekje serioze, të bazuar në një strategji të qartë studimi dhe analize mbi kuptimësimin e asaj tragjedie të gjithanshme, që kaloi shoqëria shqiptare përgjatë gjysmëshekulli nën diktaturë. Të vërtetat rrënjëthënëse të kalvarit që përjetoi pjesa më fatkeqe e popullit shqiptar mbetën të panjohura për publikun e më përveçmas, për ata që humbën njerëzit e familjeve dhe për ata të mbijetuar, që e provuan në lëkurën e vet mizorinë e burgjeve komuniste dhe kampeve të internimit. Sistemi arsimor me nivelet e tij, shkolla dhe universiteti, vazhduan të mbajnë një qndrim shpërfillës ndaj kësaj drame shoqërore e kombëtare; kurrikulat shkollore vazhduan të trajtojnë të njëjtin qndrim, si në komunizëm, duke u mjaftuar me disa terma të thatë kritikë ndaj qeverisë komuniste, a thua se në kujtesën shoqërore nuk ka ekzistuar një terror i pandërprerë mbi liritë dhe të drejtat qytetare.

Komunizmi si ideologji dhe sistem qeverisjeje u rrëzua, siç thamë, formalisht, por mbeti e pacënuar trashëgimia e tij; Edhe nëse ka (dhe në fakt ka) historianë, teoricienë apo studiues që i kundërvihen dhe e kontestojnë linjën zyrtare të historiografisë sonë, ata, pavarësisht argumenteve, dëshmime, përgënjeshtimeve të bazuara në dokumenta arkivorë, janë të dënuar të mos përfillen nga perceptimet që ndërton linja zyrtare. E linja zyrtare, është veçse zgjatim i trashëgimisë së komunizmit në kushte gjoja liberale të lirisë.

Këtë mision mediat tona e kanë përcjellë, sigurisht, jo me ndofarë strategjie, por spontanisht e instinktivisht në disa forma e formate, prej të cilëve më të dallueshëm e me traditë kanë qenë:

- a) Botimi pjesë-pjesë i memoaristikës së të mbijetuarve nga burgjet apo kampet komuniste të internimit.*
- b) Nderimi i ndonjë figure të rezistencës antikomoniste në raste përvjetorësh apo jubilesh.*
- c) Dosierët e posaçëm, të tipit minimonografikë, ku në qendër të tyre elaborohet figura qendrore e një heroji (të gjallë apo të vdekur) të rezistencës kundrakomuniste apo të*

* Prof.As.Dr., Universiteti Hëna e Plotë Bedër, Tiranë, Shqipëri, Email:
agrontufa@hotmail.com

burgjeve të komunizmit, ose një ngjarje tragjike, për të cilën gjatë komunizmit ose është heshtur, ose është paraqitur kryekëput e gënjeshtërt, gjithmonë me ndërmjetësinë e dokumentave autentikë arkivorë.

d) Dokumentarë specialë televizivë apo kinematografikë për fatin e një protagonistit apo një grupi kundërkomunist, me gjithë dëshmitë, faktet, argumentet dhe dokumentacionin e arkivave.

Ekzistenca e mediave të shkruara dhe vizive e ka rritur me vite interesin për këto tema, të cilat, duke mos patur vendin e natyrshëm ku të analizohen, kanë gjetur njëfarë ngushëllimi duke e zhvilluar këtë narrativë, së paku në shtyp, për të dalë nga narrativa e tyre e mbyllur e traumatike në një komunikim më të gjerë me shoqërinë.

Gjatë punimit tonë do të shohim, me shembuj konkretë, përvijimin e kësaj natyre të komunikimit mediatik në lidhje me narrativën e dëshmisë nga ferri komunist dhe "luftën e kujtesave" që zhvillohet midis nostalgjikëve e trashëgimtarëve të diktaturës dhe viktimave të saj. Punimi do të rrokë edhe një aspekt krahasues me modelet e përvojën e mediave në vendet ish-komuniste në lidhje me kujtesën dhe Krimet e Komunizmit.

Hyrje

Me rënien formale të sistemit komunist në Shqipëri nuk pati asnjë përpjekje serioze, të bazuar në një strategji të qartë studimi dhe analize mbi kuptimësimin e asaj tragjedie të gjithanshme që kaloi shoqëria shqiptare përgjatë gjysmëshekulli nën diktaturë. Të vërtetat rrëqethëse të kalvarit, që përjetoi pjesa më fatkeqe e popullit shqiptar, mbetën të panjohura për publikun e më përveçmas, për ata që humbën njerëzit e familjeve dhe për ata të mbijetuar që e provuan në lëkurën e vet mizorinë e burgjeve komuniste dhe të kampeve të internimit.

Sistemi arsimor me nivelet e tij, shkolla dhe universiteti, vazhduan të mbajnë një qëndrim shpërfillës ndaj kësaj drame shoqërore e kombëtare; kurrikulat shkollore vazhduan të trajtojnë të njëjtin qëndrim, si në komunizëm, duke u mjaftuar me disa terma të thatë kritikë ndaj qeverisë komuniste, a thua se në kujtesën shoqërore nuk ka ekzistuar një terror i pandërprerë mbi liritë dhe të drejtat qytetare.

Komunizmi si ideologji dhe sistem qeverisjeje u rrëzua, siç thamë, formalisht, por mbeti e pacënuar trashëgimia e tij; po ata mësues e pedagogë, po ata shkrimtarë e shkencëtarë, po ata gjyqtarë e prokurorë, po ata ish-burokratë e instruktorë të PPSH-së vazhduan të drejtojnë katedrat, institutet shkencore dhe Akademinë e Shkencave, të jenë autorët e teksteve, të prijnë drejtësinë vetë ose përmes bijve, shkurt, të njëjtët njerëz që i patën shërbyer shkencës dhe arsimit komunist më parë, tani u bënë "gardianë" të trashëgimisë së komunizmit në sferat e dijes, shkencës dhe shkollës, drejtësisë dhe politikës; ata kontrolluan tashmë institucionalisht gjithë trashëgiminë, kanalet e saj për adresatin nostalgjik, duke imponuar institucionalisht edhe linjën zyrtare që do të legjitimonte, mandej, çdo perceptim.

Edhe nëse ka (dhe në fakt ka) historianë, teoricienë apo studiues që i kundërvihen dhe e kontestojnë linjën zyrtare të historiografisë sonë, kontenstatorët, pavarësisht argumenteve, dëshmime, përgënjeshtërimeve të bazuara në dokumenta arkivorë, janë të dënuar të mos përfillen nga perceptimet që ndërton linja zyrtare dhe vetëdija masive e qytetarëve është e privuar nga një komunikim i plotë dhe cilësor me informacionin e këtij kontestimi. Linja zyrtare, siç e theksojmë, ka dëshmuar bindshëm në mosreagimin e vet, se është veçse zgjatim i trashëgimisë së komunizmit në kushte, gjoja, liberale të lirisë. Kanë kaluar 24 vite nga rënia e komunizmit dhe atë që nuk e ka bërë këmbëngulshëm sistemi arsimor e edukativ në Shqipëri, në lidhje me rishikimin/rishkrimin e historisë apo zhvarrosjen e të vërtetave ngjethëse të diktaturës, ka tentuar ta bëjë, në masën e saj, media.

Të paktën, shoqëria shqiptare, kryesisht gjeneratat e reja, kanë patur të vetmin shans të mësonin diçka rreth Krimeve të Komunizmit mbi qytetarët shqiptarë, vetëm nëpërmjet informacioneve apo rubrikave mediatike rreth ngjarjeve historike, episodeve të terrorit, ekspeditave ndëshkuese, rebelimeve dhe kryengritjeve kundërkomuniste, sikundër dhe për fatin e personaliteteve të dënuar, pushkatuar apo internuar nga rregjimi komunist. Këtë

mision, mediat tona e kanë përcjellë, sigurisht, jo me ndofarë strategjie krejt të vetëdijshme, por spontanisht e instinktivisht, në disa forma e formate, prej të cilëve më të dallueshëm e më me traditë kanë qenë:

- a. botimi pjesë-pjesë i memoaristikës së të mbijetuarve nga burgjet apo kampet komuniste të internimit (nëse aktiviteti botimor mund të konsiderohet si pjesë e medias).
- b. Ndriçimi i ndonjë figure të rezistencës antikomoniste, në raste përvjetorësh apo jubilesh, përmes mediave të shkruara, virtuale apo vizive.
- c. Dosierët e posaçëm, të tipit minimonografikë ku në qendër të tyre elaborohet figura qendrore e një heroi (të gjallë apo të vdekur) të rezistencës kundrakomuniste apo të burgjeve të komunizmit ose një ngjarje tragjike, për të cilën, gjatë komunizmit, ose është heshtur, ose është paraqitur kryekëput e gënjeshtërt.
- d. Dokumentarë specialë televizivë apo kinematografikë mbi fatin e një protagonistit apo një grupi kundërkomunist, me gjithë dëshmitë, faktet, argumentet dhe dokumentacionin e arkivave.

Ekzistenca e mediave të shkruara dhe vizive e ka rritur me vite interesin për këto tema, të cilat, duke mos patur vendin e natyrshëm ku të analizohen, kanë gjetur njëfarë ngushëllimi duke e zhvilluar këtë narrativë, së paku në shtyp, radio, TV apo rrjete sociale virtuale. Kësisoj rrjetet mediatike kanë patur efektin lehtësues për t'i çliruar sadopak mijëra bashkëqytetarë tanë fatkeqë, që panë me sy tmerrin e buhenvaldëve dhe aushvicëve komunistë, në mënyrë që kujtesa e tyre ta shpërthejë rrethin e ngallmuar dhe narrativa e tyre traumatike të mos mbetet e mbyllur, por të përcillet për një një komunikim më të gjerë me shoqërinë, me synimin për t'u shndërruar në përvojë. Madje produkt i kësaj përkrahjeje të pastër mediatike, sidomos për zhanrin e memoaristikës, ka qenë, para pak vitesh, fushata promovuese në media i trilogjisë "Rrno vetëm për me tregue" e priftit françeskan At Zef Pllumi, që u kurorëzua me një sukses të bujshëm. Mandej kjo vepër u përkthye dhe u botua në italisht vitin e kaluar, me tirazhin 17 milionë kopje, nën kujdesin e Silvio Berlusconi. Duhet theksuar, se i njëjti libër (trilogjia "Rrno vetëm për me tregue") që botuar, së pari, në vitin 1995-1996, por askush nuk e mori mundimin të shkruante 2 rreshta. Libri mund të quhet zbulim i mediave vetëm pas ribotimit, 10 vjet më vonë, në vitin 2006! Meqë jam një njohës i mirë dhe sistematik i kësaj literature të dëshmisë, mund të pohoj pa e tepruar aspak, se ekzistojnë tashmë, si fakte, së paku rreth 20 tituj të rëndësishëm veprash memoaristike, të cilat, edhe pse nuk e kanë patur fatin e At Zef Pllumit, janë pothuaj të një rëndësie a niveli të përafërt me të. Po, ne kemi një ndër trashëgimitë më të çmuara të rezistencës së vetëdijes intelektuale, kemi një kujtesë jo më pak dramatike se kampet e GULAK-ut dhe Kolimas, me shembuj karakteresh të pathyeshëm as nga situatat më ekstreme të mizorisë, por duhet të keni parasysh, se këto manuskripte, edhe në rastin kur janë botuar personalisht nga autorët e tyre, edhe në rastet kur ato janë botuar prej të afërmeve të tyre, postmortum, paraqesin botime të varfëra, në tirazh të pakët, simbolik, sipas takatit të xhepit, dhe kësisoj, ato nuk kanë bërë një jetë leximi, sepse u flakën kioskash e bukinistësh, duke mos patur fatin e takimit me lexuesin e gjerë. Një ndër këto shembuj, për shembull, është dhe një ndër

romanet me rrënqethëse e të trishtuar të shkruar nga një ish i burgosur, Makensen Bungo me titull "Këneta e Vdekjes". Libri, i shkruar si një roman memoaristik me ngjarje e personazhe të vërtetë, është një kronikë e hollësishme e përditshmërisë mortore të të burgosurve në kënetën e Maliqit, pra, një libër për nervafortët e po atij niveli të romaneve të Imre Kertezhit apo Hertha Mylerit... Fatkeqësisht në e kemi humbur mundësinë të dëgjojmë këto zëra të hadesit tonë komunist, që ishin zërat dhe narrativa gojëmbyllur e elitës më të kulturuar e idealiste të kombit tonë. Pra, një turp, që nuk rrëfëhet e s'do të mund të rrëfëhet i plotë ndonjëherë...!

II.

Islami politik është gjithashtu një rrymë mjaft e fuqishme, pasi mbizotëron si forca më e madhe ideologjike në botën myslimane. Kjo ideologji nuk operon e izoluar nga forcat e tjera të globalizmit, por paralelisht me forcat e tjera globalizuese në botë, e sidomos në atë pjesë të botës që është ende në zhvillim. Feja myslimane ka qenë ngaherë e pajisur me këtë forcë globalizuese, duke prodhuar tashmë një vijimësi qartësisht të identifikueshme vlerash të përbashkëta kulturore përgjatë gjithë Evropës. Trajtat e ndryshme të Islamit bashkëkohor kanë shumë shqetësime të përbashkëta, të ngjashme me ato të vendeve të tjera në zhvillim, sa i takon fuqisë, kulturës, autenticitetit, vlerave, fesë, reformave, dobësive politike, demokratizimit dhe dilemave të modernizimit dhe globalizmit. Kjo nuk përbën habi sa kohë që problemet e përbashkëta dhe reagimi më së pari ideologjik, e paskëtaj gjeopolitik ndaj tyre, pasqyrojnë përpjekje për të përballuar sfidat e bashkëkohësisë përgjatë feve, kulturave dhe kontinenteve. Porë në këtë këndvështrim, islami politik është pjesë integrale e një bote më të gjerë në zhvillim.

Mobilizimi i grupeve ekstremiste për të praktikuar dhunën si reagim ndaj kërcënimit për ndryshim që vjen nga jashtë, mund të prodhojë akte terroriste si brenda vendit (kundër objektivave të huaj) ashtu dhe në vende të treta. Aktorët e huaj lidhen shpeshherë me ndryshimet që kërcënojnë vlerat fetare të komuniteteve lokale. Nëse largohet mbështetja e huaj, atëherë bëhet më e lehtë për të rrëzuar nga pushteti elitat lokale, të konsideruara si pa fe dhe të lidhura me interesat e huaja.⁴ Pjesa më e madhe e reagimit të grupeve myslimane në shumë vende ka ardhur si kundërpërgjigje ndaj futjes dhe imponimit të vlerave laike perëndimore, çka përbën dhe një element kyç të fuqizimit të Islamit politik në botën myslimane në përgjithësi dhe në veçanti në rajonin e Lindjes së Mesme.

Elementët e huaj mund të shihen si grupe që përpiqen të konvertojnë doktrinën fetare të një komuniteti lokal, duke shkatërruar kështu pozitat e brendshme të fesë që ka dominuar në shoqëri përgjatë pjesës më të madhe të historisë. Raportet që Perëndimi ka ndërtuar me vendet e Lindjes së Mesme kanë synuar të prodhojnë ndryshime, disa prej të cilëve kanë rënë ndesh me traditat dhe praktikat fetare të komuniteteve lokale. Nga ana tjetër, historia e dekadave të fundit⁵ ka dëshmuar se vendet perëndimore shpeshherë kanë favorizuar elitat politike laike dhe të modernizuara të këtyre vendeve, duke i distancuar ato prej lidhshimit fetar. Ky është modeli i liderit që ka sunduar në këto vende gjatë shekullit të njëzetë.⁶ Historia ka dëshmuar edhe një tjetër përpjekje pjesërisht të suksesshme të konvertimit të

⁴ Mark Juergensmeyer, "Terror Mandated by God", në "Terrorism and Political Violence", Vëll. 9, Nr. 2, 1997, ff. 16-23.

⁵ Madje në një kuptim më të gjerë edhe e shekujve XIX-XX.

⁶ Një shprehje kjo mjaft e preferuar në fjalorin e politikës perëndimore për të etiketuar posaçërisht elitën politike të vendeve të Lindjes së Mesme (të paktën deri përpara fillimit të revoltave popullore arabe që çuan në ndryshimin e lidhshimit politik të shumë vendeve, përfshirë Egjiptin, Tunizinë, Libinë, etj.

popullsive lokale në të krishtera.⁷ Këto janë disa arsye përse grupe të ndryshme terroriste zgjedhin të godasin objektiva të huaj në Lindjen e Mesme. Instrumentet e dhunës e të terrorit politik ata i përligjin mbi premisat e agresionit historik nga Perëndimi, i pasqyruar si ‘agresor’ ndaj një kulture tjetër që përpiqet të mbrohet.

Gjithsesi, përkufizimi i parë është tejet përgjithësues dhe nuk shpjegon tërë gamën e aktivitetit politik të ndërmarrë në emër të Islamit. Një përkufizim më i dobishëm për analizën tonë, i cili i shton Islamit politik një dimension të qartë gjeopolitik, ofrohet nga Guilian Denoeux, sipas të cilit: *“Islamizmi është një formë e instrumentalizimit të fesë Islame nga individë, grupe dhe organizata që ndjekin qëllime politike. Ai ofron përgjigje për sfidat e sotme të shoqërive duke përfytyruar një të ardhme themelet e së cilës bazohen në koncepte të zbuluara rishtas nga tradita islamike”*.⁸ Synimi për të ringjallur një epokë të artë të largët historike përkon me një objektiv të qartë gjeopolitik njehsimi dhe unifikimi territorial. Ky i fundit zë vend qendror në instrumentalizimin e fesë për interesa politike. Teza e ringjalljes së traditës islamike ofron instrumentet e duhura për të dehistoricizuar Islamin dhe për ta ndarë atë prej konteksteve të ndryshme brenda të cilëve ai ka lulëzuar gjatë katër shekujve të kaluar. Sipas Ayoob: *“dekontekstualizimi i Islamit u mundëson islamistëve të injorojnë mjedisin shoqëror, ekonomik dhe politik brenda të cilit ekzistojnë komunitetet myslimane. Kjo u ofron atyre një instrument të fuqishëm ideologjik për ta përdorur në funksion të ‘purifikimit’ të shoqërive myslimane [...]”*.⁹

Megjithatë, Islami politik varet nga konteksti brenda të cilit operon. Kështu, ajo çka funksionon në Iran nuk mund të funksionojë në Indonezi, apo ajo çka funksionon në Arabinë Saudite nuk mund të funksionojë në Algjeri. Kjo ndodh për shkak të karakteristikave të shumëllojshme të botës myslimane nga pikëpamja socio-ekonomike, kulturore e politike pa harruar këtu trajektoret e zhvillimit intelektual të këtyre vendeve. Prandaj format e ndryshme politike që merr doktrina fetare islamike kur përfshihet në politikën e brendshme dhe të jashtme të shteteve myslimane, varen në masë të madhe nga konteksti i shteteve përkatës dhe janë rrjedhojë e interpretimeve të ndryshme të perceptimeve fetare në kulturën lokale, përfshirë atë politike.¹⁰ Përveç këtij diversiteti sociologjik ekziston edhe një terminologji e njehsuar islamike e cila gjatë këtyre dy dekadave të fundit ka kapërcyer kufijtë politikë të shteteve, duke u përdorur nga aktorët islamikë shtetërorë, joshetërorë dhe nga grupet ekstremiste. Interesat e këtyre aktorëve

⁷ Vendet perëndimore kanë dërguar historikisht misionarë me qëllim konvertimin e popullsive lokale në të krishtera.

⁸ Guilian Denoeux, “The Forgotten Swamp: Navigating Political Islam”, në *“Middle East Policy”*, Vëll. 9, Qershor 2002, f. 61.

⁹ Mohammed Ayoob, “Political Islam: Image and Reality”, ibid, f. 1.

¹⁰ Siç argumentonte Olivier Roy në mes të viteve 1990-të, duke folur (e në fakt parashikuar) mbi Islamin politik si faktor gjeopolitik: “Nëse debati mbi marrëdhëniet mes fesë islame dhe politikës do të ndërtohej mbi pandehmën e ekzistencës së një doktrine të vetme të unifikuar islamike, të pakufizuar në kohë dhe në gjeografi, atëherë kjo do të ishte pamaturia intelektuale dhe historikisht e keq-orientuar”. Olivier Roy, *“The Failure of Political Islam”*, US, MA: Harvard University Press, 1994, f. vii.

varen nga veprimtaritë e lëvizjeve islamiste, që nga ato pakistaneze e deri tek Fronti për Çlirim Islamik në rastin e Algjerisë, apo tek strategjitë socio-politike të Vëllazërisë Myslimane në Egjipt. Veçanërisht në rastin e Vëllazërisë Myslimane mund të vërejmë ndërthurjen e islamit politik me një vizion të qartë gjeopolitik për shkak të degëve të shumta të organizatës në vende të tjera të rajonit, si në Jordani apo Siri, duke nxjerrë në pah në çdo rast përdorimin e strategjive të ndryshme politike në funksion të konteksteve lokale. Kjo organizatë ka ndryshuar me kalimin e kohës pasi lidhshipi i saj pas viteve 1990-të i ka radikalizuar qëndrimet në përputhje me orientimin ideologjik të Sayyid Qutb, ideologut kryesor të organizatës në vitet 1960-të.

2. Shteti dhe feja në Islam: Mes historisë dhe gjeopolitikës

Nga pikëpamja historike Islami politik është një fenomen rrënjët e të cilit mund të identifikohen në kushtet e botës myslimane, sidomos asaj mesdhetare, në shekujt e nëntëmbëdhjetë dhe njëzetë. Ai është produkt i ndërveprimit ushtarak, politik, ekonomik, kulturor e intelektual të popujve myslimanë me Perëndimin gjatë dy shekujve të kaluar. Sipas Bernard Lewis, bëhet fjalë për një periudhë kur fuqitë perëndimore kanë pasur superioritet; kur myslimanët ishin më shumë objekt i historisë sesa subjekt i saj.¹¹

Produkt i kësaj qasjeje historike dyshekullore është ‘shteti islamik’, term i përdorur masivisht si nga islamistët ashtu edhe nga intelektualët perëndimorë. Si koncept gjeopolitik ai pajton vizionin e organizimit politik islamik, gjeografikisht të përcaktuar, me ekzistencën e shteteve sovranë sipas modelit evropian.¹² Në terma praktikë, interesi i islamistëve për shtetin islamik është shprehur në formën e përpjekjeve për të islamizuar disa prej shteteve ekzistuese myslimane. Por vetëm një pjesë e vogël e islamistëve mendojnë se bashkimi i botës myslimane në një Kalifat të vetëm është propozim i realizueshëm.¹³ Kjo është zanafilla e ndërtimit të një identiteti pan-islamik.

Pjesa më e madhe e lëvizjeve islamo-nacionaliste, nga Afrika e Veriut në Azinë Juglindore u formësuan në kuadër të rezistencës ndaj rendit kolonial. Gjatë periudhës koloniale lëvizjet islamike duhej ta ndanin arenën politike me forcat laike nacionaliste, pasi këto të fundit ishin mjetet kryesore të zhvillimit të betejave anti-koloniale. Megjithatë

¹¹ Ky është argumenti i tij kryesor tek “*The Middle East. A Brief History of the Last 2000 Years*”, Nju Jork: Simon & Schuster, 2009; i përtërirë më pas në veprën “*The Arabs in History*”, UK: Oxford University Press, 2002.

¹² Për një diskutim të plotë të konceptit të shtetit islamik, Seyyed Nasr, “*The Making of Islamic Revivalism*”, UK: Oxford University Press, 1996, Kreu 5.

¹³ Një numër i vogël organizatash ekstremiste islamike kanë mbështetur idenë e bashkimit në një Kalifat islamik, të tilla si Hizb-ut-Tahrir apo Al Kaeda, siç mund të rezultojë nga deklaratat e lidhshpimit të tyre. Për deklaratat e Al Kaedës shih Donald Holbrook, “*Al Qaeda Communiqués by Bin Laden and Al-Zawahiri: A Chronology*”, në Alex Schmid (ed.), “*The Routledge Handbook of Terrorism Research*”, UK: Routledge 2011, ff. 280-94.

lëvizjet islamike të rezistencës asokohe operonin edhe brenda kuadrit më të gjerë të Luftës së Ftohtë. Për shkak se shtetet perëndimore identifikoheshin me kolonizatorët, lëvizjet e rezistencës edhe disa tipare të çuditshme ideologjike marksiste, të çuditshme për shkak të papajtueshmërisë mes marksizmit ateist dhe doktrinës fetare myslimane. Në shumë raste islamistët u ndanë prej grupeve nacionaliste laike duke diversifikuar strategjitë e tyre për transformim social dhe politik. Ndryshe nga marksistët atyre u interesonte më shumë transformimi moral e kulturor i shoqërive, sesa ndryshimet socio-ekonomike. Theksi në kultivimin e disa tipareve kulturore dhe vlerave morale në përputhje me normat islamike vijoi edhe gjatë periudhës post-kolonialiste.

Në disa raste feja myslimane ka përforcuar identitetin kombëtar si reagim ndaj kolonizimit, siç ndodhi në Pakistan dhe Algjeri. Gjatë rendit kolonial Franca e quante popullsinë lokale ‘myslimane’ duke iu mohuar emërtesën etnike ‘algjeriane’, sepse kjo do të legjitimonte kërkesën e vendasve për vetëvendosje. Përshkrimi i vetes si mysliman nuk konsiderohej në antitezë me projektin nationalist sepse identiteti fetar përshkruante shumicën e shoqërisë. Në mënyrë paradoksale, kjo u aplikua edhe mbi republikën laike të Turqisë, pavarësisht përpjekjes së elitës kemaliste për të dobësuar Islamin. Sipas Ayoob, “*nëse Turqia nuk do të kishte qenë myslimane, atëherë ajo nuk do të kishte qenë Turqi*”.¹⁴

Pranimi i fesë islame si pjesë integrale e identitetit të shumicës së vendeve myslimane i hapi dyert Islamit politik. Ndikimi i Islamit politik në procesin shtetformues u forcua për shkak të dështimeve të shumta të elitave politike për të arritur progres ekonomik e për t’u shpëputur nga e kaluara koloniale. Pas pavarësimit të këtyre vendeve (1950-’70) Islami politik mori formë të plotë dhe u faktorizua gjeopolitikisht si komponent i rëndësishëm i politikës së brendshme dhe të jashtme të vendeve të Afrikës Veriore. Gjatë dhe pas kësaj periudhe identiteti fetar po ndërthurej gradualisht edhe me nacionalizmin pan-arab. Ngjizja e nacionalizmit pan-arab me elementë ideologjikë socialistë sipas modelit naserian prodhoi një qasje të mirëfilltë gjeopolitike gjatë gjithë Luftës së Ftohtë.

Në rrjedhën e historisë së shoqërive myslimane sundimtarët thjesht e kanë përdorur për interesat e pushtetit të tyre pandashmërinë e fesë nga shteti. Ata kanë ushqyer idenë e pandashmërisë së fesë dhe shtetit për të legjitimuar regjimet dinastike. Kriteret e vendosura nga juristët myslimanë për të përcaktuar legjitimitetin e sunduesit laik kanë qenë minimale. Legjitimimi i sunduesve kishte një dimension të pastër gjeopolitik sepse e lidhte pushtetin me aftësinë për të mbrojtur territoret e Islamit (*dar-al-Islam*) dhe lirinë e shtetasve për të praktikuar fenë, duke ndaluar paralelisht çdo formë rebelimi. Ndalimi i çdo forme rebelimi nevojitej sepse anarkia (*fitna*) ishte më e keqe se tirania pasi mund të kërcënonte komunitetin e besimtarëve (*umma-n*). Kuietizmi politik ishte rregulli mbi të cilin qenë

¹⁴ Mohammed Ayoob, “Turkey’s Multiple Paradoxes”, në *Orbis*, Vëll. 48, 2004 (Verë), ff. 451–63. Emel Akçali, “EU, Political Islam and Polarization of Turkish Society”, në Michelle Pace (ed.), “Europe, the USA and Political Islam: Strategies of Engagement”, Palgrave Macmillan 2011, ff. 40-58.

ndërtuar shumica e shoqërive dhe shteteve myslimane gjatë periudhës të shek. VIII-XVIII.¹⁵ Supremacia *de facto* e autoritetit laik mbi establishmentin fetar ishte tipar i mbretërive të tre dinastive të mëdha sunite: *Umayyid*, *Abbasid*-e dhe *Osmane*.¹⁶ Prej shekullit XVII osmanët e institucionalizuan këtë formë nënshtrimi duke i asimiluar funksionarët fetarë brenda burokracisë perandorake. Sulltani caktoi Sheikh-ul-Islam¹⁷ si autoritetin më të lartë fetar, post i cili gëzonte autonomi të madhe. Republika turke e trashëgoi këtë traditë osmane. Në emër të laicizmit shteti turk vijon sot të ushtrojë autoritetin e tij mbi një (institucion) fetar tejet të burokratizuar, nëpërmjet institucionit të Drejtorisë së Çështjeve Fetare. Nga ana tjetër, pasuesit arabë të Perandorisë Osmane vijuan gjithaq të ruanin traditën e supremacisë politike, por pa qenë në gjendje të kontrollojnë institucionet dhe ligjërimin fetar me të njëjtin efikasitet si Turqia.

Prandaj, ndryshe nga ç'mund të pritej, shoqëritë dhe shtetet myslimane kanë trashëguar traditat e ndarjes së fushës politike prej asaj fetare dhe supremacinë e sferës politike mbi atë fetare. Akoma dhe në rastin e Arabisë Saudite, që konsiderohet shoqëria myslimane më fundamentaliste, balanca mes familjes mbretërore saudite dhe vahabist ka anuar historikisht në favor të familjes mbretërore. Shtypja e revoltës së Ikhwan-ëve¹⁸ gjatë viteve të para të mbretërisë prej Abd al-Aziz ibn Saud dëshmon supremacinë e shtetit mbi xhaminë. Edhe sot, fetar, nëse e diferencojmë nga ekstremistët islamikë, i është nënshtruar autoritetit dhe rolit të familjes mbretërore saudite.

Krahasuar me lëvizjet e tjera politiko-fetare, islamistët nuk pranojnë shpërndarjen aktuale të fuqisë në sistemin ndërkombëtar, duke refuzuar legjitimitetin e tij. Kjo prodhon një vizion gjeopolitik sa rajonal aq dhe global. Lëvizjet islamike paqësore, por edhe ato që përdorin dhunën, vijnë në sfidojnë në mënyra të shumëllojshme status - kuonë e brendshme dhe ndërkombëtare. Në perspektivën islamiste të dyja lidhen ngushtësisht, sa kohë që e dyta bazohet tek e para. Kjo qasje karakterizon sidomos lëvizjet islamiste të Lindjes së Mesme, nga Maroku në Pakistan. Për më tepër, mbështetja perëndimore për

¹⁵ Carl Brown, *Religion and State: The Muslim Approach to Politics*, Nju Jork: Columbia University Press, 2000, në mënyrë të veçantë Krerët 3–7. Bernard Lewis, *Islam and the West*, ibid, ff. 43-57. Bernard Lewis, *The Middle East. A Brief History of the Last 2000 Years*, ibid, Kreu 12, ff. 218-43.

¹⁶ Bernard Lewis, *The Middle East. A Brief History of the Last 2000 Years*, ibid, Kreu 4, ff. 73-85.

¹⁷ Termi që përdoret në turqisht është 'Sheyhul Islam'. Bernard Lewis, *Islam and the West*, ibid, Kreu 4 (*The Ottoman Obsession*), ff. 72-84.

¹⁸ Në fillim të shekullit të njëzetë hapësira gjeografike e Arabisë që shndërruar në një arenë luftërash tribale, e cila çoi në unifikimin e territoreve nën lidhshpimin e Al Saud. Instrumenti kryesor i arritjes së këtij unifikimi ishte ushtria tribale e ikhwan-ëve (një fis beduin vahabist) e udhëhequr nga Sulltani bin Bajad al-Otaibi dhe Faisal al-Dawish. Revolta e ikhwan-ëve filloi në vitin 1927, kur disa elementë radikalë të tyre hodhën poshtë autoritetin e Ibn Saud, duke arritur kulmin në betejën e përgjakshme në Dhjetor të vitit 1928. John Habib, *Ibn Sa'ud's Warriors of Islam: The Ikhwan of Najd and Their Role in the Creation of the Sa'udi Kingdom, 1910–1930*, Netherland, Leiden: E. J. Brill, 1978.

regjimet autoritariste të këtij rajoni e bën më të lehtë kanalizimin e zemëratës kundër diktatorëve dhe Perëndimit që i mbështet ata. Kësisoj ndjenjat më të fuqishme anti-amerikane në nivel popullor gjejnë shprehje në vende si Arabia Saudite apo Pakistani, regjimet e të cilëve janë aleatë të ngushtë të Shteteve të Bashkuara.¹⁹ Prandaj një element indoktrinimi i Islamit politik është memoria kolektive e myslimanëve në raport me Perëndimin. Ky është një interpretim historiko-politik me natyrë të qartë gjeopolitike sepse përplas jo vetëm qytetërimin perëndimor me atë mysliman, por edhe shtete të caktuara të këtyre qytetërimeve me njëri-tjetrin. Nga Maroku në Indonezi dhe nga Jemeni në Nigeri islamistët përdorin historinë si strehë për të shpjeguar gjendjen e vështirë që po kalon sot shumica e popujve myslimanë.

Shumica e islamistëve radikalë besojnë se, nëse myslimanët i rikthehen modelit imagjinar të epokës së artë të viteve të para të Islamit, atëherë do të jenë në gjendje ta transformojnë raportin e tyre me Perëndimin drejt një marrëdhënieje më të barabartë. Por konteksti aktual historiko-politik është i ndryshëm. Sistemi ndërkombëtar është i organizuar në njësi shtetërore që veprojnë në përputhje me interesat e tyre. Raportet gjeopolitike kanë ndryshuar në favor të fuqive të mëdha, kurse qytetërimet nuk janë homogjene. Prandaj nuk mund të flitet për asnjë raport tjetër gjeopolitik, përveç atij që imponojnë këto rrethana.²⁰ Në këtë kontekst përdorimi i dhunës terroriste, nga grupe ekstremiste islamiste, si instrument gjeopolitik i përligjur nëpërmjet këtij botëkuptimi pseudoromantik, rezulton kundërproduktiv dhe i dëmshëm për qytetërimin mysliman në përgjithësi.

Nga anën tjetër të ekuacionit ndodhet Perëndimi, në përfytyrimin e të cilit Islami politik është unik. Ai e instrumentalizon fenë për qëllimin gjeopolitik të prodhimit të një identiteti mbikombëtar që të transformojë shoqërinë. Ky përbën një kërcënim gjeopolitik, sepse mund të përdoret si instrument për të sfiduar, shpeshherë, nëpërmjet dhunës terroriste, dominimin disashekullor perëndimor në botë. Pikërisht ky dimension i

¹⁹ Gjatë periudhës përpara (dhe menjëherë pas) Luftës së Irakut të vitit 2003, popullariteti i vendeve perëndimore, e në veçanti i Shteteve të Bashkuara në botën arabe, arriti nivelin e tij më të ulët historik. Një sondazh i kryer në disa vende arabe (Egjipt, Jordani, Marok, Liban dhe Arabinë Saudite) në mars të vitit 2003 tregoi se popullariteti amerikan (dhe perëndimor) ishte vetëm 4 % në Arabinë Saudite, 6 % në Marok dhe vetëm 13 % në Egjipt. Ndërsa në një sondazh tjetër të realizuar një vit më vonë në disa vende të mëdha myslimane (Pakistan, Turqi dhe Marok) Shtetet e Bashkuara gëzonin një popullaritet prej vetëm 5 %. <http://peoplepress.org/reports/pdf/206.pdf> (Parë për herë të fundit më 28/02/2013.)

²⁰ Mohammed Ayoob, "The War Against Iraq: Normative and Strategic Implications", në Margaret Crahan, John Goering & Thomas Weiss (eds.) "The Wars on Terrorism and Iraq: Human Rights, Unilateralism and US Foreign Policy", Nju Jork: Routledge, 2004, Kreu. 7. Bernard Lewis, "Roots of Muslim Rage", në "The Atlantic Monthly", Shtator 1990, ff. 47–60. Të njëjtën përjasje analitike ofron edhe Huntington në veprën e tij "Përplasia e Qytetërimeve". Shih Samuel Huntington, "The Clash of Civilizations and the Remaking of World Order", në "Foreign Affairs", Vëll. 22, Nr. 3, Verë 1993.

Islamit politik e ka shndërruar atë në kërcënim gjeopolitik për fuqitë dominuese të sistemit ndërkombëtar. Ky perceptim perëndimor pranon në thelb se fenomeni, përveçse gjeopolitik në përmbajtje, është shumëdimensional dhe i përshtatet kontekstit.

3. Identitetet e shumëfishta të Lindjes së Mesme

Lindja e Mesme dallon për shkak të kombinimit të saj unik të identiteteve *nënshtetërore* me ato *mbishtetërore* (panarabizmi dhe panislamizmi), të cilat dobësojnë dhe kufizojnë besnikërinë ndaj shtetit. Kjo është një shmangie nga modeli tradicional vestfalian i marrëdhënieve ndërkombëtare që ka ndodhur për disa arsye. Së pari, sepse Lindja e Mesme është një rajon i thatë qytetesh tregtare e fisesh nomade, ku identifikimi me shtetin territorial ka qenë historikisht i dobët. Identiteti prodhohej në njësinë nënshtetërore, qytetin, fisin, në komunitetin islamik ose *umma-n*.²¹ Shtetet ishin rëndom produkte të pushtimeve të huaja ose të lëvizjeve fetaro-fisnore që shpërbëheshin pas pak gjeneratash. Edhe kur shfaqej ndonjë prirje shtetformimi, kufijtë ishin gjithnjë të diskutueshëm. Shumë entitete gjeografike në botën arabe kishin eksperiencë të veçanta historike pa themele të forta. Disa sekte themeluan regjime autonome, si: Jemeni, Omani apo Libani. Lëvizjet tribale formuan regjime, si në Arabinë Saudite, ndërsa elitat Mamluk arritën autonominë pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane (si Tunizia dhe Algjeria).²² Vetëm në shoqëritë me popullsi të madhe rurale, si: Turqia, Irani dhe Egjipti, shtetet bashkëkohore kanë trashëguar tipare të qarta modeli të shtetit-komb.

Rritja e shpejtë e identitetit panarab në vitet '50-të të shekullit XX korrespondoi me progresin në arsim dhe letërsi, i cili krijoi ndjesinë e përkatësisë në një botë të veçantë arabe (*al-'alam l-arabi*). Gjatë viteve '80-të shumica e studiuesve arabë argumentonin se arabët përbëjnë një *komb* të vetëm dhe se kufijtë shtetërorë që i ndajnë ata ishin artificialë. Trembëdhjetë prej pesëmbëdhjetë kushtetutave të shteteve arabe e përkufizojnë kombin si *komb arab*.²³ Panarabizmi bazohet tek kujtesa historike e madhështisë së arabëve, kur veprojnë bashkërisht dhe dominohen me lehtësi, kur janë të ndarë.²⁴ Humbja e Palestinës, disfata nga Izraeli në 1967, sanksionet kundër Irakut dhe pushtimi i tij në 2003, janë parë të gjitha si poshtërime ndaj arabëve në përgjithësi, ndërsa lufta e vitit 1973, embargoja e naftës dhe evakuimi i Izraelit nga Libani i Jugut, nën presionin e Hizbullahut, në qershor të vitit 2000, janë përjetuar si fitore të përbashkëta. Në nivel ideologjik, kjo u manifestua në

²¹ Mohammed Ayoob, "Political Islam: Image and Reality", ibid, ff. 1-14.

²² Bernard Lewis, "The Middle East. A Brief History of the Last 2000 Years", ibid, Kreu 18 ("From War to War"), ff. 332-56. Gjithashtu Raymond Hinnebusch, "The Politics of Identity in the International Relations of the Middle East", në Louis Fawcett (ed.) "International Relations of the Middle East", Oxford University Press 2006 (për përkthimin në shqip: UET Press, 2012).

²³ Për një prej hulumtimeve më të rëndësishme të historisë së botës arabe, shih Albert Hourani, "A History of Arab Peoples", Nju Jork: Warner Books, 1991, ff. 434-54.

²⁴ Albert Hourani, "A History of Arab Peoples", ibid, ff. 416-34.

doktrinat e nacionalizmit panarab që i shihnin të gjitha vendet arabe si pjesë të një kombi, shtetet e të cilit duhet të veprojnë në harmoni (siç argumentonte Nasseri i Egjiptit) ose të shkrihen në një konfederatë të vetme (ideologjia Ba'athiste).

Nga ana tjetër, më shumë madje se arabizmi, identiteti islamik ka rrënjë të thella në bindjet dhe praktikat e shoqërive të Lindjes së Mesme. Kritja e lëvizjeve islamike politike ishte produkt i ndërveprimit mes faktorëve objektivë dhe “sipërmarrjes politike”. Shoku traumatik i humbjes së 1967-ës dhe pushtimi i qytetit të shenjtë të Jerusalemit nga Izraeli, që shumë ia atribuonjë nacionalizmit laik, shkaktoi krizë identiteti dhe nxiti bindjen se vetëm rikthimi në monopatën e Perëndisë do e kthente mbrapsht katastrofën.

Islami politik ishte gjithashtu reagim ndaj korrupsionit, pabarazisë dhe “helmatisjes me ide perëndimore” që solli moderniteti. Me rënien e ideologjive laike të cilat kishin strehuar dikur të pakënaqurit e klasave të nënshtruara, një gjeneratë e re predikuesish dhe aktivistësh të politizuar (shpeshherë të financuar nga Arabia Saudite ose të frymëzuar nga Irani revolucionar) gjetën terren të favorshëm nëpër kampe dhe, mbi të gjitha, nëpër xhami, streha kryesore e mbijetesës politike nga shteti autoritarist. Aktivistët islamikë u përpoqën ta shndërronin Islamin në një kundërideologji për të mobilizuar masat popullore kundër regjimeve. Treguesit e rritjes së influencës së mëpasshme shoqërore të Islamit politik janë: mbështetja tek ish klasat e mesme laike; shfaqja e tij si kundërshtari kryesor i shtetit në të gjithë hapësirën arabe; zëvendësimi i “shtetit populist”; dhe marrja e lidershit në betejat e vazhdueshme nacionaliste të rajonit. Hendeku i identitetit që la pas tërheqja e arabizmit në vitet '70-të, u mbush nga një tjetër identitet mbishtetëror: islami politik. Kjo nuk do të thotë se identiteti islamik e ka eklipsuar arabizmin: ata më shpesh e përforcojnë sesa konkurrojnë njëri-tjetrin.²⁵

Ndikimi i Islamit politik në sistemin ndërkombëtar nuk është i madh. Përveç Iranit, ai ka dështuar të marrë pushtetin politik dhe të institucionalizojë një rend të qëndrueshëm islamik. Disa argumentojnë se Islami u heq legjitimitetin shteteve në emër të panislamizmit. Kjo është sidomos e vërtetë për islamistë radikalë, si Sayyid Kutb. Kësaj tradite i përkasin rrjete islamike, mbi të gjitha al-Kaeda, e cila operon në një shkallë ndërshtetërore duke iu kundërvënë shteteve që perceptohen si klientë të Perëndimit.²⁶ Të tjerë argumentojnë se Islami ka qenë harmonik dhe ka marrë trajta “kombëtare”.²⁷ Sundimtarët e Lindjes së Mesme e kanë përdorur rëndom Islamin për të legjitimuar shtetet e tyre specifike. Kështu, për shembull, Arabia Saudite e përdori atë si mbrojtje nga panarabizmi. Lëvizjet islamike

²⁵ Që identiteti arab mbeti i rëndësishëm, u tregua nga fakti se, në një prej pak episodeve ku popujt u detyruan të zgjedhin midis tij dhe Islamizmit, në luftën Iran-Irak, shi'itët irakianë e vendosën identitetin e tyre arab mbi lidhjet e tyre fetare me shi'izmin iranian. Raymond Hinnebusch, *po aty*.

²⁶ Këtë trajton studiuesi Carl Brown, në “*Religion and State: The Muslim Approach to Politics*”, Nju Jork: Columbia University Press, 2000 (në mënyrë të veçantë Kreun 3).

²⁷ Graham Fuller, “*The Future of Political Islam*”, ibid, ff. 77-80. Olivier Roy, “*The Failures of Political Islam*”, ibid, ff. 60-75. Bernard Lewis, “*The Roots of Muslim Rage*”, *po aty*.

janë rivali kryesor për pushtetin politik në shumicën e shteteve të Lindjes së Mesme, por duke kërkuar të islamizojnë shtetin, jo ta shfuqizojnë atë.

Mospërputhja mes kufijve dhe identitetit përplasat me stabilitetin e sistemit rajonal të shteteve. Në thuajse një shekull formësimi të vazhdueshëm shtetëror, shtetet kanë mbrojtur me këmbëngulje sovranitetin e tyre kundër ndryshimit të kufijve. Në vitet 1950-'60 shtetet arabe u mbijetuan lëvizjeve panarabe, që zgjidhjen për dilemën 'një komb shumë shtete' e gjetën tek shkrimi i tyre në projekte konfederatash arabe, si: Republika e Bashkuar Arabe e Egjiptit dhe Sirisë. Duke garantuar kufijtë shtetërorë, sistemi ndërkombëtar i pengoi përpjekjet bismarkiane të absorbimit të fuqishëm të shteteve fqinj, si përpjekjet e Saddam Husseinit për të aneksuar Kuvajtin. Kështu, kufijtë e imponuar në gjenezë të sistemit të shteteve mbeten përgjithësisht të paprekura.

Ndërveprimi mes identiteteve të shumëfishta sjell mospajtimin e identitetit dhe kufijve shtetërorë në rajon, duke krijuar premisat e një destabiliteti të vazhdueshëm gjeopolitik. Është domethënë fakti historik se ndërtimi i shtetit ka përparuar me më shumë sukses në Turqinë joarabe, në Izrael dhe në Iran, ku shtetformuesit kanë rezultuar relativisht më të suksesshëm në përcaktimin e kufijve dhe garantimin e pajtimit mes kufijve dhe identitetit dominues etnolinguistik.²⁸ Turqia dhe Irani kanë histori të gjata si qendra perandorake dhe kanë ndërtuar kombet moderne rreth bërthamave të tyre dominuese etnolinguistike me sukses të konsiderueshëm. Nga ana tjetër, Izraeli përbën një rast unik si shtet i themeluar nga një lëvizje transshtetërore, sionizmi. Në thelb të ideologjisë sioniste qëndron bindja se hebrenjtë (pavarësisht përkatësisë etnike) formojnë një komb që ka të drejtën e një shteti në territorin e Izraelit Biblik. Kjo qasje ndërtoi pretendimin territorial dhe gjeopolitik të një 'hapësire jetike'²⁹ mbi një hapësirë toke, në kurriz të popullsisë palestineze, për rimishërimin e tij modern. Megjithatë, si Turqia ashtu dhe Izraeli, këto shtete përballen me domosdoshmërinë e integritet të minoriteteve.

Në shumë raste të vendeve të Mashrekut, ku kufijtë e imponuar nga jashtë nuk i korrespondojnë historisë së shtetësisë së pavarur, e aq më pak kombësisë, arabizmi ishte për shumë kohë identiteti dominues. Nuk është aksidental fakti se lëvizja kryesore nacionaliste panarabe *Ba'ath* lindi në Siri dhe pati sukses edhe në Irak e Jordani. Nëse uniteti natyror gjeohistorik, *Siria historike e gjeohistorike*³⁰, mund të ketë mbështetur një

²⁸ Për një trajtesë më të plotë të formësimit të identitetit turk dhe shtetit turk: Bernard Lewis, *"The Emergence of Modern Turkey"*, 3rd edn, UK: Oxford University Press, Kreun VII (*"Union and Progress"*), Kreun VIII (*"The Kemalist Republic"*), Kreun IX (*"The Republic After Kemal"*) dhe Kreun XI (*"State and Government"*). Albert Hourani, *"A History of Arab Peoples"*, Nju Jork: Warner Books, 1991. Eugen Rogan, *"The Introduction of Middle East in the Contemporary State System"*, në Louis Fawcett (ed.), *"International Relations of the Middle East"*, ibid, ff. 25-45. Mohammed Ayoob, *"Turkey's Multiple Paradoxes"*, ibid, ff. 451-63.

²⁹ Në terminologjinë e studimeve të gjeopolitikës përdoret rëndom termi *'Liebenstraum'* nga termi në gjermanisht.

³⁰ Për të cilën përdoret në arabisht një term shumë specifik: *"bila dash-sham"*. Albert Hourani, *"A History of Arab Peoples"*, ibid, f. 368. Mbi pan-arabizmin shih Raymond

ekzistencë kombëtare, fragmentarizimi i saj në katër minishtete (Siri, Jordani, Liban dhe Palestinë/Izrael) parandaloi pjesën qendrore të cunguar të Damaskut që të bëhej një epiqendër e fuqishme dhe e padiskutueshme identiteti. Përpjekja për të prodhuar një identitet kombëtar joarab nga Partia Siriane Social-Nacionaliste ishte e pasuksesshme. Në Irak (një shtet artificial i ndërtuar duke bashkuar grupe etniko-fetare rivale në një bashkësi të vetme), arabizmi u përqafua nga disa si e vetmja zgjidhje e kënaqshme, por u mohua nga të tjerë.

Rasti i palestinezëve, një populli pa shtet, e ilustron më së miri evolucionin e identiteteve të shumëfishta. Pa memorie historike të një entiteti shtetëror palestinez, identiteti palestinez ishte një funksion i ndarjes së imponuar të Palestinës nga Siria dhe luftës kundër sionizmit. Duke pasur nevojë për mbrojtjen që siguronte përkatësia në një komunitet më të gjerë, palestinezët u identifikuan edhe me arabizmin, deri në dështimin e tij në vitin 1967.³¹ Pas saj lindi një nacionalizëm më specifik palestinez, që u vonua nga mungesa e një shteti dhe u kontestua nga identiteti islamik. Asnjë prej këtyre identiteteve nuk e përjashtonte tjetrin; prandaj, islamistët palestinezë asimiluan nacionalizmin dhe rezistencën nacionaliste ndaj Britanisë, kurse Izraeli përdori ligjëratën islamike.³²

Gjatë shekullit të njëzetë Lindja e Mesme u shndërrua në fushëbetejë të përplasjes gjeopolitike mes fuqive të mëdha. Këto përplasje kanë shkaktuar konflikte të stërzgjatura mes shteteve të rajonit me përfshirjen e aktorëve të jashtëm, luftëra civile me shumë viktima, apo varfëri kronike të popullsisë vendase. Të gjithë këta faktorë kontribuuan në sendërtimin e një ndjesie të thellë antiperëndimore të popujve të rajonit, e cila përthihet hera-herës në një përfytyrim gjeopolitik të gjithëpërhapur në opinionin publik, i cili bie shpeshherë ndesh me pragmatizmin e elitave udhëheqëse. Ky përfytyrim gjeopolitik kontribuon në radikalizimin e thellë islamik të segmenteve të caktuara të popullsisë si dhe në ligjësimin (legjitimitetin) popullor të dhunës terroriste të ushtruar nga organizatat ekstremiste islamike në emër të tyre. Bashkë me tensionet social-ekonomike, të cilat vitet e fundit kanë dalë jashtë kontrollit (si “*Pranvera Arabe*”), kjo ndjesi antiperëndimore e ka pasur më të lehtë të orientojë vëmendjen popullore drejt (trajtave masive të indoktrinimit ideologjik të turmave, siç është feja?). Kjo në kushtet kur vetë feja në këtë rast mbulohet nga një mantel ideologjik dhe nga një filozofi për organizimin e shtetit që duhet të prodhojë organizimi shoqëror, që nuk përshtatet me botëkuptimin perëndimor. Ky është kuadri brenda të cilit mund të bëhet studimi më i plotë politik i terrorizmit islamik.?

Hinnebusch, “*The Politics of Identity in the International Relations of the Middle East*”, ibid, ff. 154-172. Bernard Lewis, “*From Babel to Dragonians: Interpreting the Middle East*”, ibid, ff. 156-80.

³¹ Bernard Lewis, “*From Babel to Dragonians: Interpreting the Middle East*”, ibid, Kreu 18 (“*The Emergence of Modern Israel*”), ff. 181-87. Albert Hourani, “*A History of Arab Peoples*”, ibid, ff. 411-17.

³² Rasid Khalidi, “*The Formation of Palestinian Identity*”, në J. Jankowski & I. Gershoni (ed.), “*Rethinking Nationalism in the Arab Middle East*”, Nju Jork: Columbia University Press, 1997, ff. 145-209.

Elita politike e Lindjes së Mesme luhetet mes ligjësimi të tyre si liderë arabë ose islamikë dhe identiteteve shtetërore. Ata nuk mund të mbështeten plotësisht në të parën, përderisa kufijtë e tyre nuk janë në harmoni me komunitetet arabe ose islamike dhe për shkak se *aderenca* bashkimi në normat e tyre mund të sakrifikojë interesat shtetërore. Nga ana tjetër, nuk mund të bazohen as tek identitetet shtetërore për sa kohë ato nuk ofrojnë garanci të mjaftueshme për të mënjeluar identitetet rivale mbishtetërore, si panarabizmi dhe panislamizmi.³³ Ata mund të përpiqen ta kapërcejnë këtë dilemë duke huazuar një identitet mbishtetëror si ideologji zyrtare shtetërore, si në rastin e Sirisë dhe arabizmit ose të Arabisë Saudite për Islamin. Këtu vëmë re një përdorim të qartë gjeopolitik të fesë si vektor përçues i interesave politike.

Në këtë kontekst ngrihet një pikëpyetje nëse Islami politik, i cili në nivelin e marrëdhënieve mes shteteve merr trajtën gjeopolitike të panislamizmit, mund të zëvendësojë panarabizmin si ideologji mbishtetërore e aftë të zbusë logjikën shtetërore të *raison d'état* dhe të prodhojë një fuqi të unifikuar myslimane në politikën botërore. Kjo ngre sërish dilemën për përdorimin e ekstremizmit fetar për interesa gjeopolitike. Teza jonë në këtë pikë është se në botën arabe këto janë dy identitete të mbivendosur. Preferencat gjeopolitike që prodhojnë këto identitete në politikën e jashtme e përforcojnë raportin mes tyre, ndonëse dallojnë sa u takon modeleve të rendit të brendshëm.

Si doktrina gjeopolitike e panislamizmit ashtu dhe ajo e panarabizmit theksojnë unitetin arab ose atë islamik mbi interesat specifike të shteteve. Të dyja insistojnë për autonomi ekonomike dhe kulturore të sistemit global të dominuar nga Perëndimi. Të dyja nuk e pranojnë ligjësimin (legjitimitetin) e Izraelit. Lëvizjet islamike radikale, si Hamasi dhe Hizballahu, janë njëkohësisht manifestime të rezistencës kombëtare arabe ndaj Izraelit dhe rigjallërimit islamik. Islami si doktrinë ideologjike ka pasur sukses aty ku nacionalizmi laik ka dështuar, duke i sfiduar seriozisht armiqtë e kauzave arabo-islamike. Aktivistët islamikë përmbysën dinastinë Pahlavi në Iran, imponuan tërheqjen e ushtrisë izraelite nga Libani Jugor dhe i shkaktuan Izraelit kosto të larta gjatë kolonizimit të Rripit të Gazës. Ekzistenca e lëvizjeve islamike ndërshtetërore që formësojnë identitetin e opinioneve publike nëpër rajon duket se i jep Islamit politik një potencial të caktuar për të formësuar dhe harmonizuar politikën e jashtme të shteteve myslimane. Megjithatë deri sot ai nuk ka arritur suksesin e panarabizmit në prodhimin e normave të përbashkëta të politikës së jashtme që mund të organizojnë shtetet myslimane. Kështu për shembull, sukses i pjesshëm mund të konsiderohet Organizata e Konferencës Islamike (OKI) ose Banka Islamike për Zhvillim.

Veçanërisht në kohëra krizash me Izraelin ose Perëndimin, gjenerata më e vjetër e nacionalistëve arabë dhe militantëve më të rinj islamikë, është bashkuar për t'u bërë presion nga poshtë regjimeve. Kështu, vrasja e Sadatit në Egjipt erdhi për shkak të traktatit të paqes

³³ Albert Hourani, "A History of Arab Peoples", ibid, ff. 411-17. Raymond Hinnebusch, "The Politics of Identity in the International Relations of the Middle East", ibid, ff. 154-172.

me Izraelin. Në 1982 rebelimi islamik kundër Sirisë së Assadit ishte pasojë e humbjes së ligjësisimit (legjitimitetit) të regjimit nga ndërhyrja në Liban kundër Ushtrisë Çlirimtare të Palestinës, gardiane e kauzës palestineze.³⁴ Pikësëpari frika nga deligjësimi (legjitimiteti) i brendshëm i detyron shtetet të justifikojnë, të maskojnë ose të përmbahen nga zhvillimi i politikave që fyejnë identitetin arabo-islamik të popullsisë të tyre. Nën presionin e jashtëm shumë pushtetarë janë detyruar të paguajnë kosto të tilla të brendshme. Edhe në rastet kur vetë islamistët kanë arritur të fitojnë akses në levat e pushtetit (si në rastin e Turqisë në 1997 dhe 2002) ose të grumbullojnë influencë në pushtetin legjislativ (si në rastin e Jordanisë, Kuvajtit, Marokut dhe Jemenit), ata nuk kanë qenë në gjendje të imponojnë ndonjë islamizim të konsiderueshëm të politikës së jashtme të shteteve përkatëse. Në Iran, revolucionin islamik e përmbysi totalisht strukturën e mëparshme të fuqisë dhe politikën e tij të jashtme properëndimore. Regjimi islamik u përpoq të eksportojë revolucionin panislamik që synonte krijimin e shteteve të ngjashme islamike. Këto do të vepronin kundër ‘arrogancës së botës’, në emër të të shtypurve të botës myslimane e të Botës së Tretë. Shembulli i Iranit ndikoi shumë në përhapjen e lëvizjeve islamike në rajon, por eksporti i revolucionit islamik u përmbajt brenda Iranit. Në këtë ndikoi edhe radhitja e shteteve të Gjirit Persik përkrah Irakut në luftën Iran-Irak.³⁵ Kështu nuk u përmbys asnjë regjim laik. Ndonëse sot ekzistojnë shtete me prirje islamike (si Irani, Pakistani, Arabia Saudite dhe Sudani), ato janë shpeshherë në konflikt të hapur me njëra-tjetrën. Madje në disa raste radhiten përkrah Shteteve të Bashkuara, të cilësuar si rival ose armik nga shumica e islamistëve.

Në nivel mbishtetëror, institucioni pan-islamik OKI bazohet në njohjen e ndërsjellë të sovranitetit shtetëror. Por organizata nuk ka fuqi të koordinojë veprimtari të përbashkëta dhe nuk ka pasur sukses në sheshimin e mosmarrëveshjeve ndërmyslimane. Ajo është më shumë një arenë ku shtetet myslimane kërkojnë ligjësim (legjitimitet) ose aleatë në emër të interesave shtetërore.³⁶ Rivaliteti midis tre anëtarëve kyç: Arabisë Saudite, Iranit dhe Pakistanit, marrëdhëniet e ndryshme të tyre me hegjemoninë amerikane, e kanë paralizuar veprimtarinë kolektive. Për sauditët, që e filluan OKI si instrument legjitimimi kundër panarabizmit, një politikë e jashtme myslimane efikase do të shkaktonte konflikt me Shtetet e Bashkuara, partnerin e tyre strategjik. Kësisoj ata bllokuan iniciativat e Konferencës Islamike për të zgjidhur pushtimin irakian të Kuvajtit dhe për të armatosur myslimanët e Bosnjës. Frika nga zemërimi i Uashingtonit e ndaloj Konferencën Islamike të shprehej kundër sanksioneve amerikane ndaj Iranit dhe Pakistanit për zhvillimin e të vetmeve kapacitete bërthamore në botën myslimane. Shumica e shteteve myslimane, të cilat janë

³⁴ Raymond Hinnebusch, *“The Politics of Identity in the International Relations of the Middle East”*, ibid, ff. 154-172.

³⁵ Olivier Roy, *“The Failure of Political Islam”*, ibid, Kreu 10 (*“Iran: Shi’ism and Revolution”*), ff. 168-83. Bernard Lewis, *“From Babel to Dragonians: Interpreting the Middle East”*, ibid, Kreu 31 (*“Islamic Revolution”*), ff. 299-312.

³⁶ Olivier Roy, *“The Failure of Political Islam”*, ibid, Kreu 7 (*“The Geostrategy of Islamism: States and Networks”*), ff. 107-30.

vetë multietnike, ishin të interesuara për respektimin e integritetit territorial të shteteve. Kjo parandaloi qëndrimet e Konferencës Islamike në mbrojtje të vetëvendosjes myslimane në Kosovë dhe Çeçeni.³⁷ Për ironi, Konferenca ishte një mbrojtëse energjike e sovranitetit shtetëror, të cilin e konsideronte si mbrojtje kundër hegjemonisë perëndimore. Pas ngjarjeve të 11 shtatorit, Organizata e Konferencës Islamike e dënoi terrorizmin por hodhi poshtë “*çdo lidhje midis terrorizmit dhe të drejtave të popujve islamikë dhe arabë, përfshirë atë palestinez dhe libanez...për vetëvendosje...dhe rezistencë ndaj pushtimit të huaj, të drejta legjitime të garantuara nga Karta e OKB-së*”.³⁸ Nuk mund të pohohet se Konferenca Islamike grumbullon fuqinë myslimane në politikat botërore.

4. Përfundime

Ndërsa vendimmarrësit nuk mund ta injorojnë plotësisht Islamin në politikëbërjen e jashtme, nuk ka rezultuar asnjë islamizim i politikës së jashtme dhe nuk është shfaqur asnjë bllok mysliman për të rregulluar çekuilibrin botëror të fuqisë kundër botës islame. Sikurse me arabizmin, strukturat shtetërore, anarkia e sistemit të shteteve, mungesa e ndërvarësisë ekonomike midis shteteve myslimane dhe varësia e tyre nga qendra, përbëjnë tërësinë e elementeve që privojnë panislamizmin nga një strukturë materiale, që do e bënte identitetin, bazën e një aksioni të përbashkët efikas.

Regjimet postkoloniale në botën myslimane kishin dobësi të mëdha ligjësimi (legjitimiteti). Kjo i bëri shumë represive, duke eliminuar ose dobësuar opozitën laike. Kjo krijoi hapësirën e nevojshme politike për fuqizimin e pozitive të grupeve islamiste. Kjo hapësirë politike u ligjësuara (legjitimua) më tej nëpërmjet konkurrencës politike mes regjimeve diktatoriale dhe atyre islamiste. Islamistët fituan statusin e kundërshtarëve kryesorë politikë, duke garuar me regjimin sa i takon përkushtimit ndaj Islamit.³⁹ Këto përpjekje kanë qenë të shumta në historinë e botës myslimane, e sidomos në Lindjen e Mesme, siç dëshmojnë shembujt e ish presidentit irakian Saddam Hussein apo dhe presidentit Egjiptian Anwar Sadat, i pari në kushtet e një izolimi të tejskajshëm, ndërsa i dyti duke iu dorëzuar retorikës së elementëve islamistë, për të përfunduar më pas i ekzekutuar pikërisht prej ekstremistëve në një atentat në 6 tetor të vitit 1981.

Përpjekjet për t'i shtypur elementët islamistë nëpërmjet dhunës shtetërore forcan mbështetjen e fshehtë të popullit për ta dhe çuan në akte të dhunshme jo vetëm kundër

³⁷ Alex Schmid, “*The Routledge Handbook of Terrorism Research*”, Nju Jork: Routledge, 2011, f. 51 & ff. 136-7.

³⁸ Komunikata e shpallur në Doha të Katarit, të Konferencës Islamike, 10 Tetor 2001, në <http://unispal.un.org/UNISPAL.NSF/0/A6DC158945C30A4D85256AF0004D3718> (Parë për herë të fundit në 12/10/2012).

³⁹ Olivier Roy, “*The Failure of Political Islam*”, ibid, Kreu 7 (“*The Geostrategy of Islamism: States and Networks*”), ff. 107-32. Graham Fuller, “*The Failure of Political Islam*”, ibid.

regjimit, por edhe në akte terroriste kundër mbështetësve të tyre jashtë tij. Nga pikëpamja gjeopolitike, përpjekjet e shumta thuajse në të gjithë botën arabe, u ofruan ekstremistëve islamikë statusin e viktimave të abuzimit me të drejtat e njeriut.

Nga ana tjetër, prirjet ekstremiste, të shfaqura pjesërisht përmes Islamit politik, nuk mund të eliminohen asnjëherë përfundimisht. Së pari, zhvillimi i jashtëzakonshëm i teknologjisë së informacionit sot e bën thuajse të pamundur kontrollin e mjeteve të komunikimit. Së dyti, neutralizimi i ekstremistëve islamikë vështirë të arrihet edhe për shkak të ligjërimit të tyre idiomatik dhe të institucioneve që ata shfrytëzojnë për përhapjen e mesazheve fetare. Leksiku fetar islamik, ashtu si leksiku i shumicës së feve të tjera, përmban në vetvete qëllime politike, duke u kujdesur që të shfaqet politikisht i padëmshëm. Së treti, xhamitë dhe institucionet e tjera, sidomos në vende si Pakistani, Afganistani, Irani, Arabia Saudite, etj, veç predikimeve të pastra fetare, janë përdorur historikisht edhe si përçuese mesazhesh politike të maskuara nën një mantel fetar, duke e përdorur predikimin si një manifest politik.

Kjo e vesh këtë doktrinë fetare me një mantel gjeopolitik mbikombëtar, që i kapërcen kufijtë e një shteti të vetëm komb, duke iu drejtuar identitetit panislamik si përligjës i një vizioni të përbashkët unifikues.

REFERENCA

- Albert Hourani, "*A History of Arab Peoples*", Nju Jork: Warner Books, 1991.
- Alex Schmid (ed.), "*The Routledge Handbook of Terrorism Research*", UK: Routledge 2011.
- Bernard Lewis, "*The Middle East. A Brief History of the Last 2000 Years*", Nju Jork: Simon & Schuster, 2009.
- Bernard Lewis, "*The Arabs in History*", UK: Oxford University Press, 2002.
- Bernard Lewis, "Roots of Muslim Rage", në "*The Atlantic Monthly*", Shtator 1990, ff. 47–60.
- Bernard Lewis, "*The Emergence of Modern Turkey*", 3rd edn, UK: Oxford University Press, Nju Jork: Warner Books, 1991.
- Carl Brown, "*Religion and State: The Muslim Approach to Politics*", Nju Jork: Columbia University Press, 2000.
- Graham Fuller, "*The Future of Political Islam*", Nju Jork: Palgrave Macmillan, 2003
- Guilain Denoeux, "The Forgotten Swamp: Navigating Political Islam", në "*Middle East Policy*", Vëll. 9, Qershor 2002
- John Habib, "*Ibn Sa'ud's Warriors of Islam: The Ikhwan of Najd and Their Role in the Creation of the Sa'udi Kingdom, 1910–1930*", Netherland, Leiden: E. J. Brill, 1978.
- John Goering & Thomas Weiss (eds.) "*The Wars on Terrorism and Iraq: Human Rights, Unilateralism and US Foreign Policy*", Nju Jork: Routledge, 2004.
- Louis Fawcett (ed.) "*International Relations of the Middle East*", Oxford University Press 2006 (për përkthimin në shqip: UET Press, 2012).
- Mark Juergensmeyer, "*Terror Mandated by God*", në "*Terrorism and Political Violence*", Vëll. 9, Nr. 2, 1997
- Michelle Pace (ed.), "*Europe, the USA and Political Islam: Strategies of Engagement*", Palgrave Macmillan 2011.
- Mohammed Ayoob, "Political Islam: Image and Reality", në "*World Policy Journal*", Vëll. 21, Nr. 3, Vjeshtë 2004.
- Mohammed Ayoob, "Turkey's Multiple Paradoxes", në *Orbis*, Vëll. 48, 2004 (Verë), ff. 451–63.
- Samuel Huntington, "The Clash of Civilizations and the Remaking of World Order", në "*Foreign Affairs*", Vëll. 22, Nr. 3, Verë 1993.
- Seyyed Nasr, "*The Making of Islamic Revivalism*", UK: Oxford University Press, 1996.
- Olivier Roy, "*The Failure of Political Islam*", US, MA: Harvard University Press, 1994.

Inter-Religious Dialogue and Contemporary Peace-Building: From Hostility to Mutual Respect and Better Understanding

Abstract

The misunderstanding and misinterpretation of religion and its teachings by its followers and others have given the impression that religion is the sole source of all past and current conflicts faced by humanity. This assumption is perhaps encouraged due to the limited knowledge of other religions and the wrong impression spread because of peoples' ignorance of their own religion. The media presents religion with stories focused exclusively on hatred, war-making, and devastation. However, the value of peace has been considered as the core principle in the teachings of major world religions. The ongoing inter-religious activities initiated by both, religious individuals and institutions have shown very clearly that religion stands for peace and not war. This research sees inter-religious dialogue as the most important element on which the notion of peacebuilding stands. This study attempts to show that inter-religious activities are a great resource for building and sustaining peace between people of different socio-cultural and religious backgrounds in the long term. The paradigm of inter-religious dialogue is to provide people with a better understanding of religion and its teachings and should shift their views from hostility and enmity to mutual respect and better understanding. Descriptive and analytical methods will be employed by the researcher with the intention of providing findings that will serve as solid solutions for the contemporary conflicts witnessed by our contemporary societies.

Key Terms: *Inter-religious dialogue, peacebuilding, change, paradigm, mutual respect, better understanding*

^{*} (Doctorate in *Usuluddin* and Comparative Religion) Assistant Professor Doctor, Department of *Usuluddin* and Comparative Religion, Kuliyah of Islamic Revealed Knowledge & Human Sciences, International Islamic University Malaysia, P.O. Box 10, 50728 Kuala Lumpur Malaysia. E-mail: fatmir@iiu.edu.my

Introduction

The world of 21st century is witnessing many unpredicted changes that have taken place in economic-political-cultural-regional-religious aspects. Such changes have created in the mind of many people, i.e., religious or irreligious, a dilemma about the continuity of peace and harmony in the years to come. The futuristic world peace between fellow men of different socio-economic-cultural-religious backgrounds depends on their genuine willingness to read, know and understand of one another's traditions, cultures, and religions.

3. Në ligjërimin e shkruar hasen edhe një mori epitetesh sinonime si gjymtyrë sintagmash me bashkërenditje e nënrenditje, p.sh.: *trim dhe luan, i qartë dhe transparent, furnizimi me ujë të pijshëm të bollshëm e të freskët* etj. Këto shprehje klishe përdoren për të mbuluar varfërinë e ideve apo për të fshehur mungesën e mjeteve materiale ose pamundësinë për përmbushjen e një premtimi. Shprehje të tilla, shumë prej tyre tipike për propagandën, imitohen jo vetëm nga folësit e thjeshtë, po edhe nga ata që punojnë në fushën e ligjërimit të folur e të shkruar, duke e shterpëzuar gjuhën e tyre.

Të ngjashme me shprehjet e mësipërme janë edhe një numër i madh ndërtimesh tautologjike, në të cilat e njëjta gjë thuhet dy herë ose me fjalë të së njëjtës rrënjë, ose me fjalë rrënjësh të ndryshme, si: *risi të reja; vogëlushi i vogël; Fillimisht e fillova* terapinë me vetveten (Top Channel); *Fillimisht në fillim* do të flas për... (mediet); *Fillojmë fillimisht* (KTV); *Do të rikthehem i sërish*. “Për ne është me rëndësi vazhdimi i kontinuitetit”; *Mendoj se këtë mendim e ndajnë edhe të tjerët; Drafti i projektkushtetutës; Forma kualitativisht më cilësore; Legal dhe legjitim; Projekt drafti i Partisë Socialiste; Pushtuesit dhe okupatorët serbë në Kosovë* etj.

Dhe, si forma më të skajshme të lajthitjeve semantike, janë fjali e ndërtime, përmbajtja e të cilave është e vështirë në mos e pamundur të rrokët: *As të afërmit nuk kanë pasur qasje të burgosurve; Prej sot fshati do të ketë ujësjellës të pijshëm në çdo shtëpi; Kosova ka një kulturë të lashtë të një lashtësie të moçme! Ky problem ka qenë dhe vazhdon të mbetet një problem me rëndësi si gjithë problemet aq delikate* (Shtypi). Gjykuar sipas këtyre gjykimeve mund të konkludohet (=mbështetur në këto gjykime...) Në këtë përmbledhje punimesh studimore objekt studimi është; ilaritet argumentues etj. Këto ndërtime, që i gjejmë me shumicë sidomos te fillestarët në fushën e kërkimit shkencor dhe të gazetarisë, ne i shohim si një lloj skizofrenie gjuhësore, një shfaqje shumë shqetësuese që i ka rrënjët në varfërinë e mendimit. Në të vërtetë, në literaturën përkatëse skizofrenia gjuhësore përkufizohet si “një sëmundje në thelb semiotike, një çrregullim i njohjes dhe i përdorimit të shenjave”⁷. Sigurisht, skizofrenia gjuhësore për të cilin po flasim nuk është një sëmundje psikike dhe as e pashërueshme, po një mangësi, nga njëra anë, në formimin e përgjithshëm kulturor e profesional dhe, nga ana tjetër, në zotërimin e pamjaftueshëm të leksikut e të gramatikës së shqipes, që mund të kapërcehet me punë këmbëngulëse dhe duke lexuar autorë që janë të njohur për stilin e tyre të të shkruarit.

⁷ M. Covington, C. He, C. Brown, L. Naci, J. McClain, B. Fjordbak, J. Semple, J. Brown, *Schizophrenia and the structure of language: The linguist's view*, Schizophrenia Research, 2005, 77, f. 92.

4. Ndryshimi i tipareve semantike të kuptimeve leksikore të fjalëve në ndikimin e gjedheve të fjalëve të huaja prek atë çfarë e bën shqipen të veçantë nga gjuhët e tjera në fushën e semantikës. E gjithë kjo trysni e gjuhëve të huaja mbi leksikun dhe mbi gramatikën e shqipes, ashtu si dhe risitë e ligjërimit që lindin brenda shqipes në praktikën ligjërimore të folësve të saj, nuk duhen shpërfillur nga gjuhëtarët. Pikëpamja që mohon ekzistencën e normës leksikore, që shohim të nyjëtohet edhe nga gjuhëtarë, është e gabuar. Teorikisht, sepse edhe norma ka edhe në fushën e leksikut dhe të semantikës. Për leksikun kjo duket në atë që në fjalorin shpjegues nuk janë përfshirë të gjitha fjalët e shqipes, po vetëm ato që njihen nga shumica e folësve të gjuhës; sa i përket normës semantike, kjo duket në tiparet semantike (semat) që i njihen fjalës në fjalorët shpjegues dhe që pasqyrojnë atë që është e përbashkët dhe e përgjithshme në leksikun mendor të folësve të shqipes. Praktikisht, mohimi i normës leksikore i hap rrugën depërtimit pa asnjë pengesë të fjalëve dhe të strukturave të huaja të panevojshme, të cilat, po të mos vihet një doganë gjuhësore, vjen një kohë që ia prishin originalitetin gjuhës.

Ato duhen vlerësuar për të përcaktuar se cilat prej tyre janë bërë fakte të gjuhës dhe cilat kanë mbetur fakte të ligjërimit, që nuk janë në përdorim të përgjithshëm. Vetëm pas këtij vlerësimi nga këndvështrimi normativ, duhen përjashtuar ato dukuri të ligjërimit që përbëjnë thyerje të normës semantike dhe që për këtë arsye vështirësojnë rrokjen e përmbajtjes së mesazhit prej dëgjuesit a lexuesit duke u bërë burim keqkuptimesh ose moskuptimesh. Duke pranuar ato risi që janë në natyrën e gjuhës sonë, të cilat, si të thuash mbushin “qelizat” e zbrazëta të hojeve të leksikut dhe të gramatikës së shqipes, shqipja i zgjeron mjetet dhe mundësitë e saj shprehëse. Këto të fundit duhen pasqyruar edhe në botimet e reja të gramatikës dhe të fjalorit normativ të shqipes, në mënyrë që të bëhen pronë e të gjithë folësve të shqipes.

Lajthitjet semantike dhe varfëria e leksikut abstrakt dëshmojnë për mungesën e formimit gjuhësor të folësve të përfshirë në sferën e ligjërimit publik, të cilët me anë të medias së shtypur dhe elektronike kanë mundësinë që me ligjërimin e tyre të ndikojnë negativisht edhe te folësit e thjeshtë, duke u ofruar gjedhe të gabuara ndërtimesh. Shkaku i lajthitjeve gjuhësore është puna e dobët e shkollës, e cila nuk po arrin t’i pajisë me kulturë gjuhësore dhe as t’i bëjë të vetëdijshëm për nevojën e kësaj kulture brezat që ulen në bankat e saj. Natyrisht, kur themi shkolla, me këtë kemi parasysh nivelin e pakënaqshëm të kurrikulës shkollore, të teksteve mësimore dhe nivelin e ulët të formimit gjuhësor të mësuesve të gjuhës shqipe. Një shkak tjetër është edhe niveli i ulët kulturor i familjes shqiptare, si pasojë e tranzicionit të tejzgjatur të shoqërisë shqiptare, të shoqëruar me probleme sociale, ekonomike e politike. Trevat shqiptare po jetojnë periudhën e një urbanizimi të vrullshëm dhe të pakontrolluar, që ka ndryshuar raportet demografike, duke bërë që ardhësit nga zonat rurale të përbëjnë shumicën në qendrat tona kryesore të kulturës. Prej kësaj popullate që po dyndet në qytete, po dalin ata që zënë vend në administratë, në institucionet arsimore e kulturore. Niveli i ulët kulturor i tyre nuk ka si të mos pasqyrohet në të gjitha aspektet e jetës shoqërore, përfshirë edhe ligjërimin. Derisa të qytetërohet, sepse

nuk mund të flitet për asimilim të kësaj shumice nga pakica urbane, që, për shkak të shpërpjesëtimit, nuk mund ta integrojë shumicën, dukuri të tilla do të vijojnë të jenë të pranishme edhe për një kohë të gjatë.

Këtu dalim te një aspekt i rëndësishëm i planifikimit gjuhësor që është puna për zotërimin e normës gjuhësore dhe përdorimin e saj në ligjërimit. Pas vlerësimit të fakteve të reja gjuhësore nga specialistët e gjuhës, i vjen radha edukimit gjuhësor, që duhet të synojë jo vetëm njohjen e normës nga folësit, po edhe mënjanimin e përdorimeve që prekin natyrën e gjuhës shqipe. Kjo punë u takon të gjithë faktorëve: shkollës, shtypit të shkruar, televizionit e radios. Ndër këta faktorë, shkolla, si vendi ku gjuha amtare është një nga lëndët mësimore kryesore, doemos që luan rolin kryesor; pastaj vijnë shtypi i shkruar dhe televizionet, të cilat, me modelet e ligjërimit që u ofrojnë folësve, mund të plotësojnë punën që bën shkolla. Por sot roli i këtyre faktorëve është zbehur. Nuk kemi një ligj gjuhësor sikundër e kanë edhe vende fqinje dhe, si pasojë, nuk ekziston detyrimi ligjor për redaktim e korrektim gjuhësor dhe për monitorues në televizione e radio; nuk kemi as polici gjuhësore, as sektorë të kulturës së gjuhës dhe as agjenci të këshillimit gjuhësor, të cilat do të ndikonin në shtimin e kujdesit për gjuhën dhe në ruajtjen pastër të saj. Ndërkaq, merret vesh se Ministria e Kulturës financoon projekte për ruajtjen e dialekteve, në vend që këto fonde të shkojnë për kujdesin ndaj gjuhës standarde. Sepse dialektet janë degëzime të natyrshme të gjuhës, ato fëmija i nxë që në lindje dhe do të ruhen sa kohë që të ketë fshat dhe bashkësi të mbyllura; ndërsa gjuha standarde nuk është e lindur, atë fëmija e mëson në shkollë. Prandaj gjuha standarde ka nevojë për mbrojtje me ligj dhe për kujdes të shtetit dhe të shoqërisë. Aq më tepër ka nevojë për këtë mbrojtje, prej të dy shteteve shqiptare, gjuha jonë standarde, që është e re në moshë dhe që flitet edhe në treva jashtë kufijve shtetërorë.

Literatura

Chomsky, N., *Language and mind*, Cambridge University Press, Cambridge UK, 2006.

Covington M. A., He C., Brown C., Nac L., McClain, J. T., Fjordbak B. S., Semple J., Brown J., *Schizophrenia and the structure of language: The linguist's view*, Schizophrenia Research, 2005, 77, f. 85–98.

Guilbert, L., *Peut-on définir un concept de norme lexicale*, Langue française, 1972, vol 16, pp. 29–48.

Malinovski, B., *The problem of meaning in primitive languages* në C. K. Ogden and I. A. Richards (1923), "The meaning of meaning", HBJ, San Diego . New York . London, 1989, ff. 296–336.

Memushaj, R., *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2002.

Murati, Q., *Nga shqipja standarde te kafazet e vjetra gjuhësore-krahinore* (dorëshkrim).

Saussure, F. de (1916), *Cours de linguistique générale*, Éditions Payot & Rivages, Paris, 1995.

Skendo, L., *Të vëmë re kur shkrojmë*, Diturija, E përkohëshme shqip literare dhe diturake, Mot i parë, 1 janar 1909, N^o. 1.

Ferdinand Gjana, PhD, Hena e Plote Beder University
Nereid (Redi) Shehu, Msc, Hena e Plote Beder University

Social Conflict as a Consequence of Freedoms Imbalance

Abstract

This article is focused on the phenomenon when two guaranteed rights in democratic and liberal-democratic states, collide with each other causing social tension. A special case, to which we will stop, is the case of Prophet Muhammad derogatory cartoons and film, lasted in a period from September 2005 until autumn 2012. It happened to be a phenomenon which caused great tensions and debates across the globe, accompanied with victims and U.S. Ambassador Murder in Benghazi Consulate in Libya. Specifically we will penetrate into the debate of free speech and freedom of religion as the foundation of the conflict caused by the event. Freedom of expression and freedom of religion are inseparable from each other within a given context. Mechanical separation of freedom of expression from faith and its absolutisation, leads to dogmatism of that freedom and any dogmatism has premises to become a dictate. So, if we continue with unlimited absolutisation of freedom of expression, without determining human limits, there's the risk to convert freedom of expression from one of the pillars of democracy to a building of dictate, to a "freedom of expression" dictatorship. What is observed in these approaches is the metaphysical treatise escape of freedom understanding in general and freedom of expression in particular. For this reason, a research on the metaphysics of freedom and freedom order will be present in this paper. Pragmatic division between public and private in modernity, do not take care of moral, as well as ethical, dimension of freedom of expression, which would be impossible without a metaphysical analysis of its source.

Freedom of religion can never be treated as the opposite of freedom of speech, because freedom of speech is an integral part of freedom of religion and vice versa. Hence, the dilemma of freedom of speech or freedom of religion arises only from a secular point of view which is strengthened by the mechanisms of secular criticism as a guardian of this system. Cartoons as artistic genre and its symbolism through visual rhetoric, is a powerful tool which misused can feed the conflict in irreparable proportions. Limitation, that innately exist and they should exist within the freedom of speech when core limits of human society are damaged, as opposed to being problematic, represent a guarantee for the system preservation and social welfare.

Keywords: Freedom of expression, freedom of faith, rule of freedom, metaphysics, criticism, visual rhetoric.

Ferdinand Gjana, PhD, Shkolla e Larte Hena e Plote Beder
Nereid (Redi) Shehu, Msc Shkolla e Larte Hena e Plote Beder

Konfliktet Sociale Si Pasojë e Çekuilibrit të Lirive

Abstrakti

Në këtë projekt kërkimor do të fokusohemi tek fenomeni kur dy të drejta të garantuara në shtete demokratike dhe liberal-demokratike, përplasen me njëra-tjetrën duke shkaktuar tension social. Rasti i veçantë tek i cili do të ndalemi, është rasti i karikaturave si dhe filmit përçmues ndaj Profetit Muhamed, i përfshirë në një periudhë kohore nga shtatori i 2005-ës deri në vjeshtë të 2012-tës. Fenomen i cili shkaktoi tensione dhe debate të mëdha në të gjithë globin duke u shoqëruar edhe me viktima si dhe vrasjen e Ambasadorit amerikan në Konsullatën e Bengazit në Libi. Specifikisht do të ndalemi tek liria e shprehjes dhe liria e besimit si themeli i debatit dhe konfliktit që shkaktoi ngjarja. Liria e shprehjes dhe liria e besimit janë të pandara nga njëra-tjetra brënda një konteksti të caktuar. Ndarja mekanike e lirisë së shprehjes nga besimi dhe absolutizimi i saj, çon në dogmatizëm të kësaj lirie dhe çdo dogmatizëm ka premisa për t'u kthyer në diktat. Kështu mund të themi se nëse vazhdohet me absolutizim të pakufi të lirisë së shprehjes duke mos përcaktuar limite njerëzore, rrezikojmë ta kthejmë lirinë e shprehjes nga shtylla e demokracisë në godinën e diktatit, të një diktati “ të lirisë së shprehjes”. Ajo që vërehet në këto qasje është arratisja e trajtesës metafizike të kuptuarit të lirisë në përgjithësi si dhe lirisë së shprehjes në veçanti që në të vërtetë është një dimension i pashmangshëm i anëtarit të shoqërisë. Për këtë arsye një hulumtim mbi metafizikën dhe rendin e lirisë do të jetë i pranishëm në këtë punim. Ndarja pragmatike mes publike dhe private në modernizëm nuk merr përsipër, le të themi, të kujdeset për një dimension aq sa moral por edhe etik të lirisë së shprehjes, e cila do të ishte e pamundur pa një analizë metafizike të burimit të saj.

Liri e besimit nuk mundet kurrë të trajtohet si oponence e lirisë së fjalës. Sepse liria e fjalës është pjesë përbërëse e lirisë së besimit dhe anasjelltas. Ndaj edhe dilema liri e fjalës apo liri e besimit ngrihet vetëm nga një këndvështrim sekularist i cili është i fuqizuar me mekanizmat e kritikës sekulare si gardiane e këtij sistemi. Karikatura si gjini artistike dhe simbolika e saj përmes retorikës vizuale është mjet i fuqishëm i cili nëse keqpërdoret mund të ushqejë konfliktin në përmasa të pariparueshme. Kurse kufizimet që natyrshmërisht ekzistojnë dhe duhet të ekzistojnë brënda lirisë së fjalës, kur preken dhe çënohen kufij të rëndësishëm të shoqërisë njerëzore në të cilin përfshihet edhe besimi, përkundrajt të qënurit problematikë, janë një garanci e ruajtjes së sistemit dhe mbarëvajtjes shoqërore.

Fjalët kyçe: Liria e shprehjes, liria e besimit, rendi i lirisë, kritikizmi, retorika vizuale.

“Liria e shprehjes e shfrenuar”

Në Shtator të 2005-ës, gazeta më e madhe daneze, “Jyllands Posten”, porositi hartimin e disa karikaturave për Profetin Muhamed nën motivacionin “*Muhammeds ansigt*” – “*Fytyra e Muhamedit*”. Do të duheshin pak ditë dhe në mëngjesin e 30 Shtatorit të po atij viti, ato letra të bardha tashmë të mbushura me ngarkesa emocionale, të cilat dilnin përtej kontekstit të ngushtë në të cilin qene pikturuar, të shpërndaheshin në çdo pikë shitjeje të Danimarkës. “Jyllands Posten”, kryegazeta daneze ishte ajo e cila mori përsipër të botonte karikaturat në të cilat satirizohej as më shumë e as më pak, por një ndër profetët më të mëdhenj të njerëzimit, domethënia shpirtërore e jo më pak se 2 miliardë njerëzve, vetë Profetin Muhamed. Justifikimi ishte i thjeshtë dhe si zakonisht i standartizuar kur bëhet fjalë për të argumentuar qëllimin e një aksioni të tillë mediatik. “Liria e shprehjes”, që fraza e cila nxitoi të mbulonte me status ligjor botimin e karikaturave. Në një formë pandemie, botimi i karikaturave shpejtoi të përhapej në shumë media të shkruara prestigjioze duke marrë flamurin e lirisë së shprehjes. Por gjatë gjithë ecejakeve të veta mediatike, këto botime nuk u shoqëruan kurrë me kriterin bazë që ka lira e shprehjes, kriterin e së vërtetës, të lidhjes reale që këto afishime sarkastike kishin me të vërtetën. Ngjarja e 2005-ës u pasua me një ripërsëritje të një karikature në formë filmi, nga Sam Bacile, gjë që ashtu si në rastin e parë të karikaturave, shkaktoi tensione dhe konflikte të cilat prekën cepat e globit, kryesisht në vendet muslimane, të cilat u pasuan me dhunime të përfaqësive diplomatike por edhe me vrasjen e plagosjen e qindra personave përfshirë edhe Ambasadorin amerikan në Bengazi. Kështu, një debat i gjerë mori udhë në të gjithë hapësirën intelektuale dhe institucionale të globit lidhur me legjitimitetin e botimit të karikaturave si dhe të drejtën për besim të individit, të drejtën për të qenë i lirë në besimin e tij.

Kriza në hapësirën ndërkombëtare

Shumëkush mund të ketë ngelur i habitur me faktin se si një gazetë e një vendi si Danimarka, që në vitin e publikimit të karikaturave kishte jo pak por pothuaj 9 % të popullsisë së saj me emigrantë të kulturave dhe religjioneve të ndryshme, dhe me një popullsi prej rreth 200 mijë banorësh muslimanë¹, të hezitonte që me shpejtësi të mbyllte konfliktin i cili me shumë gjasa mund të transformohej në një minë me sahat në rrafshin social për shoqërinë daneze. Të habitur mund të kenë ngelur edhe të tjerë, kur mësuam se botuesit e gazetës ishin përballur me bojkote të vazhdueshme nga artistë të ndryshëm të cilët i ishin përgjigjur negativisht ftesave pararendëse të gazetës për të pikturuar Profetin Muhamed në disa libra fëmijësh për nivelet e shkollave fillore daneze. Megjithatë, insistimi i gazetës më të madhe daneze për të vazhduar me projektin e saj, lë hije dyshimi mbi atë se, duke qenë organ mbi të gjitha politik, duhej ta dinte se një sipërmarrje e tillë provokuese do të shkaktonte zemëratë publike dhe

¹ Hedetoft, U. “Denmark: integrating immigrants into a homogeneous welfare state”, *Migration Information Source*. 2006. Marrë nga,
<http://www.migrationinformation.org/Profiles/display.cfm?id=485> (vizituar 1 Pril 2013)

një konflikt social lidhur me pothuaj 10% të popullsisë, që edhe pse nuk ishin të gjithë muslimanë, do të përfshiheshin në kategorinë e të qënurit kulturallisht ndryshe, e për pasojë viktimë të stigmatizimit, talljes dhe përçmimit.

Një tjetër habi mund të shkaktonte fakti se si nuk qënka kuptuar se publikimi i karikaturave të cilat personifikonin Profetin Muhamed si terrorist, mund të shkaktonte një cunami në marrëdhëniet ndërkombëtare me jo pak, por dhjetra e dhjetra shtete të cilat si besim parësor të tyre kishin Islamin dhe shtyllë morale e fetare Profetin Muhamed. Është theksuar shpesh se krahu i djathtë konservator qeverisë në Danimarkë, por jo vetëm, ka tentuar gjithmonë të radikalizojë marrëdhëniet me kulturat migratore në vend, dhe si rrjedhojë, është parë nga ana e tyre se lufta kundër këtyre kulturave migratore në rritje brënda shoqërisë daneze, do të mund të bëhej më së miri duke sulmuar boshtin e këtyre kulturave të cilat zanafillojnë me religjionin.

E në fakt ndodhi pikërisht ashtu siç edhe pritej të ndodhte. Ngjarja ndau mediat e përfaqësuesit e tyre me popullsinë e thjeshtë dhe politikanët e diplomatët mes njëri-tjetrit, të cilët u vendosën në një pozicion të vështirë mes ruajtjes së balancës në marrëdhëniet sociale shtresore, si dhe popujve religjiozë të cilët përbënin një pjesë të konsiderueshme të shoqërive respektive.

Më 15 Shkurt të 2006-tës, Presidenti i Komisionit Evropian asokohe, Barroso, shprehej lidhur me situatën në deklaratën zyrtare të përbërë prej disa pikash² se;

Liria e shprehjes është një liri e panegociueshme e institucioneve evropiane dhe po në të njëjtën kohë, liria e besimit të individëve si dhe komuniteteve fetare është po ashtu një liri e panegociueshme. Le të jemi të qartë – vazhdon ai- se opinionet e shprehura nga individët, angazhojnë vetëm ato, e për pasojë ato nuk përfaqësojnë një vend, popullsi apo religjion. Ndërkohë që muslimanët duhet të jenë të lirë të praktikojnë fenë e tyre në të njëjtën mënyrë si çdo pjestar i komuniteteve të tjera fetare në territorin evropian.

Pala e dëmtuar vendeve muslimanë, nën ombrellën e Organizatës së Konferencës Islamike, shprehej në deklaratën tjetër të saj të 18 Janarit 2006 në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të saj , Ekmeleddin Ihsanoglu, se aktet islamofobike shkojnë përtej çdo forme të lirisë së shprehjes apo lirisë së shtypit duke dëmtuar parimet ndërkombëtare të etikës dhe vlerave të bazuara në deklaratat dhe rezolutat e Kombeve të Bashkuara. Liria e shprehjes duhet ushtruar në respekt të vlerave me të cilat edhe mund të mos biesh dakort, sepse thelbi i demokracisë i trupëzuar në lirinë e shprehjes nuk konsiston në lejimin e fyerjes se vlerave dhe simboleve të shenjta të të tjerëve. Aq më tepër kur kjo bëhet duke portretizuar dhe steroi tipizuar muslimanët dhe profetin e tyre si injorantë, djallëzore dhe terroristë.³

Në korin e vendeve të cilat tashmë e konsideronin lirinë e shprehjes si liri e cila nuk duhet të ngrihej duke shkelur mbi truallin e shenjtërisë së të tjerëve, i

² http://www.eu-un.europa.eu/articles/en/article_5696_en.htm (Vizituar 3 Prill 2013)

³ <http://www.oic-oci.org/press/english/2006/January%202006/denmark-3.htm%3E> (vizituar 3 Prill 2013)

bashkohet edhe Vatikani i cili në deklaratën e vet për shtyp të 4 Shkurtit 2006 shprehet se :”Liria e shprehjes dhe mendimit e cila është një ndër të drejtat themelore të parashikuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, nuk duhet të përmbajë të drejtën për të fyer ndjenjat fetare të besimtarëve”.⁴ I Dërguari Special i Komisionit të Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen ndaj formave të racizmit, ksenofobisë dhe intolerancës z.Doudou Diene, lidhur me publikimin e karikaturave nga gazetat në përgjithësi, shprehej po përjetonte situatën më degraduese dhe manifestimin më serioz të islamofobisë.⁵ Përmasat e rënda të konfliktit i cili kaloi territoret nacioanle duke u transformuar tashmë në një përplasje ndërkombëtare jo vetëm idesh mbi mënyrën dhe konceptimin e lirisë, por edhe në përplasje të dhunshme me viktima dhe të plagosur, e tregon edhe një deklaratë e përbashkët e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Konferencës Islamike dhe të Ligës së Shteteve Arabe, zëvendës Kryeministrit dhe Ministrit të Jashtëm të Katarit, Ministrit të Jashtëm të Spanjës dhe Ministrit të Jashtëm të Turqisë, të cilët bashkarisht deklaruan se :

*Ne rikonfirmojmë të drejtën universale për lirinë e shprehjes. I bëjmë apel secilit ta ushtrojë këtë liri në mënyrë të përgjegjshme dhe të mos e përdorë atë si pretekst për nxitjen e urrejtjes apo për të fyer ndjenjat fetare të çdo komuniteti.*⁶

Me këtë deklaratë u bashkua edhe Presidenti i Parlamentit Evropian dhe më pas një deklaratë e përbashkët mes Ministrave të Jashtëm të Turqisë dhe Austrisë pasoi, në të cilën theksohej qartë se liria e shprehjes dhe vlerat religjioze janë trashëgimia më e mirë dhe nuk qëndrojnë në kontradiktë, por përkundrazi ata janë përplotësuese të njëra-tjetrës.⁷

Si pasojë e polarizimit të tejskajshëm të situatës, qëndrimet diplomatike përmes deklaratave të përfaqësuesve të tyre ishin shpesh të kahjeve të ndryshme duke ndarë qëndrimet në pro dhe kundra publikimit të karikaturave. Qëndrimi i Britanisë së Madhe në fjalët e Sekretarit për Marrëdhëniet me Jashtë Jack Straw, përmbledhej në një kërkesë publike që i bëri mediave të mos publikonin karikaturat dhe e quajti botimin e tyre nga disa media evropiane si “*të pasjellshme*”.⁸ Po ashtu gazeta daneze “Politiken” i bën një kritikë të fortë “Jyllands-Posten” dhe zbulon një fakt interesant në të cilin, “Jyllands” kishte refuzuar publikimin e karikaturave mbi “ringjalljen e Krishtit” dy vite më parë, më 2003-shin, me justifikimin se këto mund të përceptoheshin si fyese dhe “nuk ishin aspak për të qeshur”.⁹ Më 5 Shkurt 2006 Ministri i Transportit të Irakut ngrin të gjitha kontratat me Danimarkën dhe Norvegjinë, ndërkohë që kompania daneze “Arla Foods” raporton miliona euro humbje si pasojë e bojkotit të produkteve të saja të bëra nga muslimanët. Irani po ashtu ndaloi të gjitha

⁴ Deklaratë per Shtyp e Selisë së Shenjtë, 4 Shkurt 2006, www.vatican.va/news_services/index_news.htm

⁵ UN Doc. E/CN.4/2006/17, 13 February 2006, paragraf. 23-28

⁶ UN Doc.A/60/706, 25 February 2006

⁷ Deklaratë e përbashkët, 2 Shkurt 2006 (www.mfa.gov.tr/mfa)

⁸ http://news.bbc.co.uk/2/hi/uk_news/4676524.stm (vizituar me 4 Prill 2013)

⁹ “The Guardian”, “Danish paper rejected Jesus cartoons”, 6 Shkurt 20016

marrëdhëniet tregëtare me Danimarkën duke prishur marrëveshjet që kishte me Unionin Evropian. Po në fillim të Shkurtit 2006, mijëra muslimanë mbledhen në Bruksel duke organizuar një protestë paqësore kundër botimit të karikaturave.

Po në të njëjtën ditë, Konferenca Evropiane e Rabinjve hebrej, shpreh pakënaqësinë e saj lidhur me publikimin e karikaturave të cilat nënçmojnë ndjenjat e muslimanëve dhe bënë përngjasimin e tyre me karikaturat antisemire.¹⁰ Mbi një mijë protestues marshuan për orë të tëra në Paris si kundërpërgjigje e publikimit të "Jyllands-Posten". Kryeministri francez asokohe, Dominique de Villepin, dënoi dhunën e ushtruar dhe bëri thirrje për njohje të të drejtës ndaj besimeve, tolerancë dhe respekt ndaj tyre.¹¹ Kriza dhe ndikimet e saj u demonstruan deri në atë pikë sa Ministri i Jashtëm i Danimarkës në fillimet e Shkurtit të 2006-tës, i bënte thirrje qytetarëve danezë të mos shpenzonin pushimet e tyre në vende si Emiratet e Bashkuara, Katari, Bahreini, Egjipti, Maroku, Tunizia, Libia, Omani Jordania etj. duke i shkaktuar një dëm kolosal financiar bashkëqytetarëve të vet¹². Po e njëjta Ministri lëshonte rekomandime për shoqëritë ajrore daneze të anulonin fluturimet drejt Egjiptit. Kryeministri Britanik Tony Blair dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jaap de Hoop Scheffer, shprehën solidaritetin e tyre me Danimarkën në lidhje me djegien e ambasadave të tyre në shtetet muslimane.¹³ Terri Davis, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës u deklarua se publikimi i karikaturave kaloi kufirin etik edhe pse ishte korrekt ligjërisht.

Kompania më e madhe e produkteve ushqimore në botë, "Nestle" shpejtoi të bënte një fushatë publicitare në mbarë botën, e kryesisht në vendet muslimane, duke u kujdesur të shpjegonte se ajo dhe produktet e saja nuk kishin të bënin aspak me Danimarkën.¹⁴ Të njëjtin opinion ndan edhe "Amnesty International" e cila botoi një deklaratë për shtyp ku theksonte se liria e shprehjes nuk është një liri absolute dhe se ajo duhej përdorur me përgjegjshmëri.¹⁵ Ndërsa ish-Ministri i Punëve të Jashtme të Danimarkës, Uffe Elleman-Jensen i bëri thirrje kryeredaktorit të "Jyllands-Posten", Carsten Juste, të jepte dorëheqjen. Në të njëjtën kohë flamujt e Danimarkës, Norvegjisë edhe të Kroacisë u dogjën në protestat që u organizuan në Bosnjë Hercegovinë. Qeveria Japoneze në një komunikim për shtyp udhëzoi që gazetatat e vendit të saj të mos botonin karikaturat e Profetit Muhamed. Megjithë këtë iniciativë të sajën, mediat japoneze nën flamurin e lirisë së shtypit i botuan karikaturat.¹⁶ Në Kenia

¹⁰ Conference of European Rabbis, "The right to satirise is not the right to injure or humiliate". Press release. 5 February 2006.

¹¹ Agence France-Presse "Protests in France against controversial cartoons". 6 February 2006

¹² <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/4684930.stm> (vizituar 4 Prill 2013)

¹³ Danmarks Radio, "Blair supports Denmark". 6 February 2006.

¹⁴ <http://www.foodproductiondaily.com/Supply-Chain/Nestle-moves-to-dodge-Middle-East-boycotts>

(vizituar 4 Prill 2013)

¹⁵ Amnesty International, "Freedom of speech carries responsibilities for all". 7 Shkurt 2006

¹⁶ Browne, Anthony, "The Times". "World leaders rally round as crisis deepens". 9 Shkurt 2006

policia hapi zjarr ndaj protestuesve të cilët kishin mbushur rrugën në kundërshti të publikimeve të karikaturave në fjalë. Kurse Presidentja Irlandeze e asaj kohe Mery McAleese, dënoi pikturimet dhe botimet e tyre dhe u shpreh se muslimanët kishin të gjithë të drejtën të ndjeheshin të zemëruar. Në këtë frymë tensioni e ashpërsimi të konfliktit, Byroja Federale e Investigimeve të Finlandës vendosi të ndërmerre një hetim të hollësishëm lidhur me arsyet e publikimit të karikaturave në gazetën finlandeze, bazuar në Kodin Penal finlandez, i cili ashtu si edhe ai danez, parashikonte dënime për nxitjen e urrejtjes fetare.¹⁷

Në nxitjen e mëtejshme të konfliktit, ndihmoi padyshim edhe Ministri italian Roberto Calderoli, anëtar i Lega Nord, ekuivalentja e partive të ekstremist të djathtë danez, i cili veshi publikisht një fanelë në të cilën kishte të stampuar karikaturat. Ai u zotua që ta vishte përditë këtë fanelë në emër të lirisë së shprehjes.¹⁸ Ky veprim i tij shkaktoi një furi protestash ku veçohet ajo e Benghazit në Libi protestuesit e së cilës sulmuan konsullatën italiane atje. Si pasojë e përlëshjeve humbën jetën 11 veta. Kjo bëri që Kryeministri italian i asaj kohe Silvio Berluskoni ta detyronte Calderolin të tërhiqej nga nisma e tij. Menjëherë më pas Zëvendës Kryeministri italian Gianfranco Fini vizitoi xhaminë më të madhe në Romë duke dhënë një shenjë reflektimi nga ana e qeverisë italiane.

Në Mars të vitit 2007, vendet muslimane lobuan për hartimin e një rezolute në Këshillin e të Drejtave të Njeriut pranë Kombeve të Bashkuara, thelbi i së cilës ishte të ndalonte përdhosjen e religjionit.¹⁹ Pas një qetësie relative, situta filloi përsëri të turbullohej kur në Shkurt të 2008-tës, tre persona me shtetësi të huaj planifikuan të vrisnin autorin e karikaturave Kurt Westergaard. Menjëherë pas kapjes nga policia vendase të tre personave, për të cilët nuk u vërtetua kurrë se kishin planifikuar ndonjë aksion, të gjitha mediat e shkruara daneze i ripublikuan edhe një herë karikaturat²⁰. Kjo shkaktoi trazira përsëri në Danimarkë të cilat u pasuan me djegie të makinave në rrugë dhe të disa objekteve. Protesta u konsiderua e dhunshme edhe për faktin se tre të dyshuarit u deportuan në vendet e origjinës pa bërë një proces gjyqësor ndaj tyre. Në të njëjtën kohë, Egjipti ndaloj shpërndarjen e gazetave "Wall Street Journal" dhe "The Observer" të cilat i ribotuan përsëri këto karikatura

Ç'paketimi i konceptit të lirisë së shprehjes

E gjithë ajo çka ndodhi, nuk ishte gjë tjetër veçse paafësia e të kuptuarit dhe të interpretuarit të tjetrit kulturalisht. Prodhimi i vazhdueshëm i industrisë së frikës që zgjerohet gjithnjë e më shumë, pasurohet përmes kanaleve të komunikimit në dhjetra forma të ndërlukuara. Të gjitha këto forma kontribuojnë në ndarjen e madhe sociale, ku nga njëra anë demokracia liberale, arsyeja, laicizmi apo edhe sekularizmi, projektohen si vlera të bashkëngjitura Perëndimit, dhe nga ana

¹⁷ News Room Finland, "Finland's NBI probes Suomen Sisu's Muhammad cartoon posting". 14 Shkurt 2006.

¹⁸ "Corriere della Sera", 21 Prill 2008

¹⁹ "Der Spiegel", 30 Mars 2007.

²⁰ BBC News. 14 Shkurt 2008

tjetër religjioni, autoritarizmi, tirania si anë e kundërt e përparimit dhe progresit, përceptohen të bashkëngjitura Islamit. Kjo ndarje e nënkuptuar e cila gjallon në atmosferën mediatike ka kontribuar dhe kontribuon në prodhimin e konflikteve të mëdha qytetërimore. Një bashkëjetesë brënda një planeti e cila aktualizohet mbi bazë keqkuptimi, domosdoshmërisht që e ka jetën e shkurtër. Ngjarje të tilla të kësaj natyre, nuk mundet asesi të mos ushqejnë dhe thellojnë këtë ndasi. Kur shoqëria përballet me konflikte të këtyre përmasave siç ishin edhe ato të shkaktuara nga portretizimi i simboleve të fesë përmes zhandresh përçmuese, atëhere përplasja nuk ngelet vetëm në këndvështrimin social, por shtrihet edhe më tej duke formuar një zonë gri juridike mes të drejtash të cilat shoqëritë moderne ia kanë lejuar sot vetes. Kjo zonë gri që shtrihet mes lirisë së shprehjes dhe të drejtës për të mos qenë i dëmtuar nga kjo liri e shprehjes, qëndron e pa mbulur me një shpjegim të qartë juridik. Nga njëra anë kemi retorikën mediatike lidhur me karikaturat dhe filmimet denigruese e blasfemuese, e cila tërësisht mbështetet mbi principin e të drejtës liberale, dhe nga ana tjetër kemi popullsi të tëra besimtarësh identitarë muslimanë, që të drejtën e shohin të bazuar tek principi i dëmit të shkaktuar. Nëse juridikisht do të anohet vetëm drejt njërit prej këtyre dy qëndrimeve atëhere do të legalizohet një koncept të pjesshëm të liberalizmit, pluralizmit dhe tolerancës.

Liria e shprehjes është një e drejtë themelore në shoqëritë demokratike. Ajo e merr këtë atribut në sajë të nenit 19 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut²¹, nga neni 10 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut,²² si dhe nga neni 19 i Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike²³. Por megjithë këtë fakt, liria e shprehjes nuk gëzon atributet e një të drejte absolute për arsye se ajo përmban në vetvehte ashtu si detyra të specifikuar edhe përgjegjësi në raport me shoqërinë, për këtë arsye ajo i nënshtrohet ligjërisht terreneve juridike kufizuese.²⁴ Kështu ne gjejmë shumë shtete që kanë hartuar një kuadër ligjor kundra gjuhës së urrejtjes mbi bazë racore dhe fetare, të tilla si Gjermania, Kanadaja, Anglia, Franca, Danimarka, Australia, Zelanda e Re, legjislacioni i të cilave për rastin konkret ndalon publikimin e deklarimeve nga të cilat një person apo grup njerëzish të ndjehen të diskriminuar për arsye të racës, ngjyrës, besimit apo edhe origjinës etnike.²⁵ Ndërsa kur bëhet fjalë për Shtetet e Bashkuara, legjislacioni është i pakushtëzuar, i hapur në lidhje me gjuhën e urrejtjes duke u mbështetur tek Amendimi i Parë i Kushtetutës amerikane. Meiklejohn, në analizën që i bën dispozitave të Amendamentit të

²¹ GA Res.217 A (III), (Dhjetor 1948) Neni.19: "Secili ka të drejtën e e lirisë së mendimit dhe shprehjes; kjo e drejtë përfshin të drejtën për të mbartur opinione pa ndërhyrje dhe të kërkojë e marrë informacione dhe ide përmes çdo medie pavarësisht kufinjve."

²² ECHR, Neni.10 : "Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes,....Ushtrimi i kësaj të drejte mban përgjegjësi e detyra dhe mund të jetë subjekt i formaliteteve, kushtëzimeve, shtrëngimeve apo ndëshkimeve të parashikuara sipas ligjit në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial dhe sigurisë publike....."

²³ ICCPR, Neni 19

²⁴ U.N.Human Rights Committee, (1983).Dispozita të Përgjithshme nr.10. Neni 19: "Liria e Shprehjes"

²⁵ Waldron, Jeremy, "Why Call Hate Speech Group Libel?" (Pse duhet futur Hate Speech ne grupe e shpifjeve) *Harvard Law School: Holmes Lectures*, 2009.

Parë të Kushtetutës Amerikane, shprehet se ky amendament zanafilloi si zgjidhja përfundimtare e problemeve të lirisë së shprehjes por më vonë u pa një konflikt i cili doli në sipërfaqe mes dy grupimeve të interesave sociale, konflikt mes promovimit të fjalës së lirë dhe interesit social i cili dëmtohej nga ushtrimi i saj.²⁶ Ndërkohë që promovimi i fjalës së lirë gjeti mbështetje ligjore, një gjë e tillë nuk arriti të shtrihej deri tek mbrojtja e vlerave të dëmtuara pikërisht gjatë ushtrimit të lirisë së shprehjes duke u transformuar në përceptimin e përgjithshëm të një antagonizmi mes lirisë së shprehjes dhe interesit publik. Në të vërtetë ka raste kur të drejtat juridike mund të përplasen, por kjo konsiderohet si përjashtim. Ajo që ndodh në rastin e përplasjes së lirisë së shprehjes dhe dëmeve që ajo i shkakton interesit publik është kthimi i një përjashtimi në rregull të përhershëm, pra një konflikt juridik jo i përkohshëm por që ka zënë rrënjë dhe kërkon zgjidhje në çdo situatë sociale. Nga ana tjetër, Ligji Ndërkombëtar i të Drejtave të Njeriut e pajis individin me të drejtën e lirisë së besimit. Kjo liri përfshin pasjen e një feje apo edhe procesin e adoptimit me një fe tjetër, gjithashtu edhe të drejtën e praktikimit të këtij besimi në hapësirat e shoqërisë. Por, pavarësisht kësaj, ky ligj nuk e merr në konsideratë përjashtimin e religjionit nga përqeshja apo fyerja, gjë e cila lidhet direkt me respektimin e ndjenjave besimore të individit.²⁷ Në këtë kuadër edhe shtypi apo masmedia, si forma komunikimi prej të cilave realizohet liria e shprehjes në hapësirat publike, qëllim primar të tyre kanë zhvarrosjen e të vërtetës dhe nxjerrjen e saj në vëmendjen e interesit shoqëror. Po ashtu detyrë themelore e mediumeve është të përcjellin informacione në bazë të kriterit të të vërtetës në përputhje me atë që quhet interesi i përgjithshëm duke e bashkëshoqëruar këtë me detyra dhe përgjegjësi. Si shtyllë themelore e shoqërive demokratike liria e shtypit e ka të caktuar masën e saj të kalimit të kufirit, dhe nëse do të duhej ta bënte këtë, atëherë Komiteti për të Drejtat e Njeriut si dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike shprehet se, edhe pse liria e shprehjes është bazike për shoqëritë demokratike ajo i nënshtrohet të drejtës për kufizime apo shtrëngime të cilat duhet të kenë si justifikim bazë interesin publik.²⁸ Dallimin mes interesit publik dhe atij privat e bën koncepti i lirisë së mendimit i cili në ndryshim nga liria e shprehjes, bazuar në sa thamë më sipër, nuk i nënshtrohet kufizimeve. Liria e mendimit në bazë të nenit 9 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 18 të ICCPR, është liri absolute dhe nuk bën pjesë në asnjë lloj të kufizimit juridik.²⁹

²⁶ Meiklejohn, Alexander, "Political Freedom" (Liria Politike) 1960 fq.54-55 (në këtë punim autori rreket të shpjegojë se Amendamenti i Parë nuk arrin të mbrojë individin dhe lirinë e tij dhe të sigurojë në të njëjtën kohë mbrojtje të interesave sociale). Kurse Bork H Robert në një punim tjetër,

"Neutral Principles and Some First Amendment Problems"(Parimet Neutrale dhe Disa Probleme me Amendimin e Parë), (1971) 47 IND. L. J.1, fq 24-26 (agumenton se Amendamenti i Parë mbron vetëm lirinë e fjalës në diskursin politik).

²⁷ OKB, "Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike", 1966, neni 18,

²⁸ Po aty, neni 19. ICCPR

²⁹ HRC General Comment nr.22, "The right of freedom of thought, conscience and religion", Neni 18

Në veprën e tij *“Natyra dhe Burimet e Ligjit”*, John Gray ndërton një strukturë trekëndore të problemeve që implikojnë lirinë e shprehjes dhe dëmet që ajo mund t’i shkaktojë interesit shoqëror. Së pari, qëndron e drejta e atyre të cilët dëshirojnë të shprehen lirshëm apo të jenë të lirshëm të dëgjojnë të tjerët të shprehen. Së dyti, qëndron pjesa tjetër e shoqërisë të drejtat e të cilëve mund të çenohen apo dëmtohen nga e drejta e të tjerëve për t’u shprehur lirshëm. Së treti, qëndron shteti i cili është përgjegjës për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të dy grupimeve të mësipërme.³⁰ Në këtë kuptim të drejtat e të dy grupimeve të para, në konceptin modern juridik, mund të konsiderohen në të njëjtën kohë si interesa shoqërore dhe roli i shtetit qëndron pikërisht në mbrojtjen e tyre ngase interesi shtetëror është i pandarë nga interesi publik (social). Pra, fenomeni duhet parë si ndërveprim të drejtash dhe lirish, i cili shndërrohet në konflikt në momentin që shteti si rregullator i këtyre të drejtave, që në të njëjtën kohë janë edhe interesa, të sigurojë mbrojtje ligjore vetëm për njërën dhe duke e lënë tjetrin të pambuluar ose pjesërisht të mbuluar ligjërisht. Mekanizmat ligjorë të Konventës Evropiane si dhe Konventës për të Drejtat Civile dhe Politike, janë në vetvehte autorizime ligjore për shtetet anëtare të këtyre konventave, për të aplikuar kufizime të zbatimit të lirisë së shprehjes në momentet kur kjo liri çënon sigurinë publike në kontekstin kolektiv dhe kur ajo çënon dinjitetin e personit në kontekstin individual. Ky autorizim ligjor përbën një formë të detyrueshme kufizimi për sa kohë shtetet anëtarë kanë pranuar këtë trajtim juridik të lirisë në fjalë dhe ato nuk mundet ta trajtojnë lirinë shprehjes jashtë këtij kuadri ligjor të rënë dakort në mes tyre. Këtë e konfirmon Neni 20 i ICCPR-së (Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike) në të cilin theksohet se shtetet anëtare duhet të ndalojnë me ligj: *“çdo avokaturë ndaj urrejtjes me bazë kombi, race apo feje e cila mund të përbëjë nxitje për diskriminim, konflikt dhe dhunë”*. I njëjti obligim ligjor vjen edhe nga Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (CERD) në Nenin 4(a) të saj në të cilën udhëzon shtetet anëtare që :

*...të deklarojnë çdo akt që konsiderohet fyes dhe që është i dënueshëm ligjërisht, çdo përhapje të ideve të bazuara në epërsi apo urrejtje rracore, çdo nxitje të diskriminimeve racore, po ashtu çdo akt dhune dhe nxitjeje të këtyre diskriminimeve të personave apo grupeve me origjinë racore apo etnike, si dhe çdo mbështetje apo financim i këtyre aktiviteteve.*³¹

Danimarka si vendi i origjinës së krijimit dhe publikimit të karikaturave ndaj Profetit Muhamed, është shtet anëtar i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) por dhe anëtare e CERD-it, gjë që e bënte të detyrueshme ndërhyrjen e këtij shteti në rastin kur liria e shprehjes çëronte sigurinë publike apo edhe të raportonte në CERD për këtë rast si akt në të cilin u demonstrua hapur urrejtja dhe diskriminimi ndaj komuniteteve migratore të racave dhe kulturave të ndryshme. Mos të harrojmë se pjesë e karikaturave ishte edhe portretizimi i një qytetari danez i cili kafshonte këmbën e një gruaje me

³⁰ Gray Ch. John, *“The nature and Sources of the Law”*, botimi i dytë viti 1972 fq.18

³¹ International Convention on the Elimination of All Forms of Racial Discrimination
660 United Nations Treaty Series 195. New York, 7 Mars 1966.

ngjyrë. Edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si vendi i origjinës së filmimit përçmues të Sam Bacile, është shtet anëtar i ICCPR-së, por fakti është që SH.B.A-të shprehën rezervat e tyre ndaj Nenit 20 të kësaj Konvente me justifikimin se :

*Ky nen nuk autorizon apo kërkon bërjen e ndonjë ligji apo të një akti tjetër nga ana e Shteteve të Bashkuara, të cilat do të kufizonin të drejtën për lirinë e shprehjes apo të ndonjë akti të ngjashëm, ndaj të drejtave që janë të mbrojtura nga Kushtetuta apo ligjet e Shteteve të Bashkuara.*³²

Ky qëndrim i Shteteve të Bashkuara, mbështetet mbi konceptin që kanë ata mbi lirinë e shprehjes të cilën e konsiderojnë si vlerë kushtetuese dhe mbështetet kryesisht mbi Amendimin e Parë të Kushtetutës së Sh.B.A-ve. Në fakt ky Amendim është marrë shpesh edhe si shembull se si duhet të mbrohet liria e shprehjes në shoqëritë demokratike dhe modeli amerikan është po ashtu konsideruar edhe argument i cili justifikonte absolutizimin e kësaj lirie.

Liria e shprehjes në identitetet qytetërimore

Publikimi i filimitit poshtëruar të Sam Baciles, ndaj Profetit Muhamed, risolli edhe një here në vëmendjen publike atë debat i cili qe aktivizuar herët më 2005-ën ku shumë gazeta printuan karikaturat daneze, lidhur me trashëgiminë e lirisë së shprehjes. Shumë pyetje u ngritën asokohe mbi faktin nëse liria e shprehjes ishte apo jo në softin e Islamit dhe muslimanëve dhe nëse Perëndimi dhe Islami ishin bartës ose jo të vlerave opozitare. Një debat i madh mori udhë mbi pikëpyetjen nëse arsyeja dhe besimi janë dy nocione të përputhshme me njëra-tjetrën, ku me arsyen nënkuptohej vlera demokratike, sekulare liberaliste dhe me besimin nënkuptohej autoriteti, tirania e nënshtërimit, pse jo edhe dhuna. Të vendosura në këtë formacion, qasja hulumtuese duket se është pashmangshmërisht konfliktuale e cila përfundon me një përplasje të paralajmëruar qytetërimore, që formën e saj të shkruar e mori më së shumti nga Samuel Huntington dhe teoria e tij e cila e shihte si thelbësore papajtueshmërinë kulturore mes Perëndimit si bartës të Krishtëritit dhe Islamit, e cila do të përfundonte me një përplasje të madhe. Duke u nisur nga përqasjet që shpesh janë afishuar në media, të jepet përshtypja se doktrina e krishterë është më mikpritëse me demokracinë. Në fakt, demokracia është nocion dhe praktikë e cila vjen nga një qytetërim më i hershëm se ai i krishterë, nga Greqia e lashtë me kulturën athinase të Agora-së, në të cilën qytetarët në formë konsensuale, merrnin vendime të rëndësishme për bashkësinë dhe për marrëdhëniet me shtetet e tjera. Kështu konceptet e demokracisë së sotme moderne na vijnë nga Greqia klasike ku koncepti i bashkësisë ishte shumë i zhvilluar. Sipas Giorgio Zanchinit, një ndër tiparet që dallon demokracinë e lashtë me atë bashkëkohore, është ndarja në sferë private dhe sferë politike. Në atë kohë një qytetar athinas

³² U.S Reservations, Declarations and Understandings, INT'L COVENANT ON CIV. And POL. RTS,

138 Cong.Rec.(Regjistrime të Kongresit) S4781-01 dt 2 Prill 1992

ishte i dedikuar shërbimit ndaj bashkësisë komunitare dhe kjo ishte parësore për të. Jeta publike dilte në plan të parë ndërkohë që jeta private konsiderohej si dytësore³³. Në këtë kontekst fjala idiot që vjen nga latinishtja, prejardhjen e ka nga greqishtja e lashtë (idion) që do të thotë privat dhe përdorej me konotacion përbuzës ndaj atij anëtarit të shoqërisë që merrej më shumë me punë private dhe anashkalonte interesin kolektiv publik të bashkësisë. Megjithatë, do të duhet të bëjmë një saktësim mbi konceptin e atëhershëm të demokracisë në Greqinë e lashtë dhe konceptit modern të demokracisë. Pika ku këto koncepte ndryshojnë nga njëri-tjetri, është tek qasja që ato kanë me individin. Demokracia e sotme si themel të saj ka vlerën universale të dinjitetit të njeriut, pra sistemi është i ngritur duke respektuar këtë premisë me qëndër individin dhe të drejtën e tij. Në Greqinë e lashtë, koncepti i barazisë ekzistonte por nuk arrinte të shtrihej deri tek dinjitetit universal i njeriut. Ekzistonte e drejta për t'u shprehur i lire në forumet, në Agoran-në athinase, por kufinj të individit shiheshin brënda bashkësisë dhe e drejta universale e tij ishte një koncept i tëhuajësuar. Por gjithsesi, nocionet bazë të të shprehurit lirshëm ishin prezente dhe kanë përbërë referencën historike të qytetërimeve të cilat iu qasën asaj.

Duke iu kthyer Krishtërit, duhet të pohojmë se ekziston një boshllëk i madh kohor midis kulturës së shprehjes së lirë në Agora-në athinase dhe shoqërive evropiane të krishtera të cilat filluan t'i japin përparësi individit dhe shprehjes së lirë. Nga Agora-ja e deri tek "kontrata sociale" e Jean Jaques Rousseaus e cila u formulua më pas si "religion civil" e deri tek Republika e Tretë në Francë, qëndrojnë disa shekuj që pak ose aspak kishin të bënin me kulturën demokratike dhe softin demokratik të Krishtërit. Nëse do të zhyteshim në Mesjetën evropiane, koncepti i dinjitetit njerëzor nën latinizmin "dignitas", ishte ekuivalent i shtresave të larta të shoqërisë të cilët pretendonin përkatësinë mbi këtë term dhe aspak i shtresave të ulta të saj. Kështu presupozimi se dinjiteti njerëzor si bazë e demokracisë ishte trupëzuar në Krishtërim, është i pabazë e për rrjedhojë edhe kultura demokratike në shekujt kur qeveriste kasta e Kishës, mungonte në pothuaj të gjitha komponentet e saj. Për më tepër gjatë historisë së saj, Evropa është karakterizuar nga një ndarje klasore e thellë mes shtresave të popullsisë së saj, ndarje e bazuar edhe në identitetet e mëvonshme fetare dhe nacionale, të cilat kanë shkaktuar konflikte të herëpashershme. Këtu duhet të sjellim në vëmendje edhe faktin se përveç mungesës së një demokracie e cila duhej të prodhohej së brëndëshmi në marrëdhëniet brënda vetes së vet, Evropa ka qenë edhe eksportuesja e një historie të gjatë kolonizimi, shfrytëzimi e vuajtjesh të shkaktuara ndaj popujve të kontinenteve të tjera si Azi, Amerikë, Afrikë duke projektuar mungesën e dinjitetit njerëzor përmes shfrytëzimit të burimeve njerëzore e natyrore në mënyrë thellësisht diskriminuese. Nëse do të supozonim se pohimet e Francis Fukuyamës, se doktrina kristiane është e bazuar mbi "dinjitetin universal të njeriut"³⁴ si vlerë unike e civilizimit Perëndimor, atëherë do të duhej të përmendnim këtu thënien e Hannah Arendt-it e cila vërteton se politikat raciste

³³ Zanchini, Giorgio, "TELEDOKRACIA nënshtrë kokëulur apo qytetarë" Tiranë : Instituti Shqiptar i Medias 2001, fq.59

³⁴ Fukuyama, Francis. "The End of History and the Last Man", New York, 2006

të shteteve evropiane kanë qenë themeli i zhvillimit të fashizmit në Evropë.³⁵ Në këtë kuptim, kërkimi për konceptin e “dinjitetit njerëzor” në civilizimin evropian, do të duhej të bëhej vetëm atëhere kur ky civilizim të shkëputej nga pushteti dhe autoriteti i Kishës. Pra, vlerat e demokracisë evropiane morën formë atëhere kur edhe dinjitetit njerëzor dhe barazia mes njerëzve u bë qëllimi prioritar i shoqërive evropiane. Ajo çka duhet thënë në këtë rast është se ky stad arriti vetëm atëhere kur shoqëritë evropiane vendosën të zëvendësonin Kristianizmin si nocion pushteti me sekularizmin dhe shoqëritë liberale. Prandaj sekularizmi në shoqëritë evropiane nuk përbën vetëm një ndarje të thjeshtë të Kishës nga shteti, por në vetvehte është zmbrapsje e religjionit për të mos ndërhyrë në administrimin e shoqërive moderne. Parë në këtë këndvështrim, atëherë përjasja se demokracia është thelbi i doktrinës kristiane do të na çonte në një konkluzion tjetër, ku sipas këtij supozimi, sot Evropa është antidemokratike ngase ka zëvendësuar qëndrën e pushtetit nga një administratë demokratike të Kishës më një administratë sekulare e liberal-totalitariste. Prandaj, ne nuk duhet të harrojmë së vlera të tilla si, liria ,barazia dhe vëllazëria u vendosën në Evropë përmes shpatës dhe gijotinës, përmes luftës e konfliktit, për të zëvendësuar një pushtet të vjetër i cili nuk njihte dinjitetin njerëzor me një pushtet të ri të perandorive moderne evropiane, të nacionalizmit, racizmit, gjenocidit e kolonializmit. Historia e Evropës, e krishterë ose jo, ka pasur problemet e saj me “dinjitetin njerëzor “ si themeli i demokracisë. Evropa sot e konsideron si arritje gjendjen aktuale të të drejtës publike sepse ajo vazhdon të vuajë edhe sot e kësaj dite frikën e rikthimit të pushtetit të Kishës, prandaj liria e fituar me aq shumë mund shihet e kompleksuar nga frika e humbjes së saj, nga frika e çdo gjëje religjioze e cila për historinë e Evropës do të thotë rikthim në qelinë e autoritarizmit dhe diktatit ekleziastik. Është pikërisht këtu gabimi që bën Evropa sot kur i qaset marrëdhënieve me muslimanët në rastin e karikaturave, sepse ajo mbron lirinë e shprehjes jo se nuk e kupton që ajo duhet të ketë kufij, por e konsideron atë si kufirin mbrojtës ndaj religjionit. Gabimi qëndron në të konsideruarit të fenomenit musliman me konceptimin dhe këndvështrimin që ata kanë për Krishtërimin dhe historinë e tij. Për këtë duhet kuptuar Islami dhe thelbi i tij, natyra sociale dhe qasjet që ai ka me demokracinë e sotme për të ndërtuar pastaj një përafrim më tipik në lidhje me pretendimet e muslimanëve përsa i përket respektimit të dinjitetit njerëzor.

Liria e shprehjes në këndvështrimin e muslimanëve

Në të vërtetë, kur bëhet fjalë për konceptin e lirisë së shprehjes në botëkuptimin e muslimanëve, duhet të kemi parasysh që të kuptuarit e rendit të lirisë, për të cilën folëm në kapitullin e mëparshëm, është më i ndryshëm se në shoqëritë perëndimore. Nëse kufizimi i lirisë në Perëndim kalon përmes frymës së ligjit i cili rregullon sjelljen publike me sjelljen private, në vendet muslimane rendi i lirisë e përshkon rrugën e vet përmes ndalesave që zanafillojnë me urdhëresat hyjnore të cilat pothuaj zhdukin hapësirën mes moralit dhe mënyrës,

³⁵ Arendt, Hannah. “The Origin of Totalitarianism”,(1951), *rieditur New York Schocken*, 2004

duke i njësuar ato. Ky njësim pasqyrohet në vetëdijën e përditshmërisë së çdo muslimani duke përbërë kështu individin, që raportin e tij me lirinë e sheh në prizmin e rendit dhe renditjes e cila zbret në formë transhendente nga Zoti Krijues i lirisë, tek individi si përkufizimin i saj. Në ndryshim nga Perëndimi ku moraliteti religjioz është shtyrë forcërisht në sferën private dhe përmes mekanizmave të ligjit bëhet një ndarje e fortë mes private dhe publike së një personi në shoqëri, në shoqëritë muslimane, përmes rendit fetar të lirisë, privatja dhe publikja në kuptimin e mënyrës dhe moralit shkrihen në një dhe nuk ka dallim të sjelljes morale në privaci me atë në kolektivitet, sepse tashmë marrëdhënia e muslimanit me lirinë kalon përmes dimensionit vertikal me Zotin e tij, në etikën e kësaj lirie. Në këtë kontekst, ka një të kuptuar të ndryshëm në mesin e muslimanëve, përse i përket lirisë individuale dhe rendit social. Inkurajimi i socializimit të individit në shoqëritë muslimane përmes termit *xhema* (*bashkësi*,) e shkrin ndarjen mes sjelljes publike dhe private të muslimanit duke unifikuar qëndrimin e tij ndaj lirisë si e lindur më të, si dhuratë nga Krijuesi i tij , sepse muslimani e gjen lirinë tek nënshtrimi ndaj Zotit dhe ligjeve të tij. Ndërkohë që përceptimi i lirisë në shoqëritë perëndimore anon nga përcaktimi dhe përkufizimi i saj nga ligji me autor njeriun.

Në Islam ashtu siç përmendëm në kapitullin për sistemin politik të tij, diversiteti dhe pluraliteti i mendimeve dhe besimeve të njeriut kanë qenë pjesë e pa ndarë e tij. Kështu individi është i lirë të përzgjedhë qoftë edhe fenë e tij, e vërtetuar kjo me postulatën kuranor : “Nuk ka dhunë në fe...”³⁶. Kështu njeriu kriminalizohet për veprimet e tij dhe jo në lidhje me besimet e tij. Në këtë kuptim, muslimani ndërton një marrëdhënie intime me lirinë e tij që moralitetin e saj e ka të zbritur nga Krijuesi, por duke qenë se Profeti Muhamed është në vetëdijën e muslimanit, i dërguari i Zotit në tokë, atëhere në të njëjtën mënyrë krijohet marrëdhënie intimiteti po ashtu me Profetin si manifestim i vullnetit hyjnor. Në rastin e karikaturave dhe filmimeve, shumë media në Perëndim u habitën me faktin e reagimit të muslimanëve ndaj këtyre publikimeve sepse ata nuk e kishin kuptuar se aktet që ata kishin prodhuar kishin cënuar intimitetin e muslimanit me lirinë e tij dhe me Profetin Muhamed si materializim i kësaj lirie. Sepse ashtu siç Saba Mahmood³⁷ shprehet:

*Muhamedi nuk është një emër i thjeshtë që i referohet një figure të veçantë historike, por një vulë ngjashmërie për secilin. Në këtë kuptim ai është një figurë imanence, nuk është një shenjë e veçuar reference e shkëputur nga thelbi.*³⁸

Vetëm duke vështuar marrëdhënien e cila është ndërtuar mes muslimanit dhe Profetit të tij, se si sjelljet, fjalët, veprimet apo mosveprimet e tij janë kthyer në një kushtetutë etike për besimtarët, në një ndërveprim intimiteti e dashurie,

³⁶ Kur'ani. Suretu Bekare, Vargu 256

³⁷ Saba Mahmood, lektore ne universitetet e Cikagos, Columbia University dhe New York University.

³⁸ Mahmood, Saba, “Religious Reason and Secular Affect: An Incommensurable Divide?” Në “Is

Critique Secular? Blasphemy, Injury, and Free Speech”, 2009 fq. 64

sepse ai është ligji, ai është liria. Vetëm duke kuptuar se si praktikohet dhe përfetohet liria e çdo muslimani, atëherë do të kuptohet edhe shkalla e dëmit të shkaktuar me publikimin e vizatimeve denigruese, do të kuptohet se sa është shprishur vija e dëmit për shkak të keqkuptimit të lirive. Jo vetëm kaq, por duhet evituar edhe pretendimi, se të kuptuarit më të drejtë të të vërtetës së lirisë, e kanë shoqëritë sekulare. Në këtë botë e cila po anon nga hegjemonia dhe hegjemonizmi, përfituesit më të mëdhenj të lirive janë padyshim të pasurit dhe të pushtetshmit, ndërkohë që të dobhtëve u mbetet të ngushëllohen me lirinë e ndërgjegjes së tyre, e cila vështirë të kuptohet në shoqëritë ku liria shihet vetëm si atribut juridik i përjashtësuar nga e brëndëshmjia e individit. Për këtë arsye bëhet akoma më e madhe nevoja për të kuptuar moralin e lirisë.

Fuqia e karikaturës në ndezjen e konflikteve sociale

Është tashmë i ditur fakti i përdorimit të karikaturave për të sjellë në vëmendjen e audiencës një situatë apo ngjarje, qoftë edhe politike, duke i dhënë ngjyrimë sarkastike asaj dhe njëkohësisht duke e veshur me elementë të ndryshëm artistikë. Në fakt, përdorimi i karikaturave është forma e preferuar e shumë organeve të shtypit, për të zëvendësuar pamundësinë e tyre për t'u shprehur qartazi për një fenomen kryesisht politik, dhe kështu përdorin një zhandër artistik që në mënyrë metaforike të japë domethënie e asaj çka ata mendojnë se është thelbësore dhe goditëse. Për këtë arsye në gjejmë në mediat më të mëdha botërore karikatura të cilat projektojnë çështjet më të rëndësishme të niveleve të ndryshme të cilat mund të përfshijnë personalitete, grupe shoqërore apo edhe kombe të tëra. Shpesh karikaturat janë përdorur nga mediat edhe si armë negociimi kulturor, racor dhe politik, lidhur me situatat të ndryshme konfliktuale, ashtu siç edhe janë përdorur për të ironizuar liderë apo sisteme politike duke i paraprirë edhe ndryshimeve socio-politike.

Në çdo vepër arti, por edhe më gjërë, paraprakisht është i nevojshëm ndërtimi i një strukture ideore mbi punimin i cili do të realizohet, dhe më pas krijimin e një strukture materiale mbështetëse e cila ndihmon në realizimin e plotë të tij. Kur një vepër ka nevojë për një strukturë, e cila pashmangshmërisht së pari është ideore, atëherë këtu gjëja e parë që të bie ndër mend është që kjo vepër qëndron e emancipuar nga rastësia dhe shpesh naiviteti. Kjo sepse një strukturë ideore paraprake e një vepre është e bazuar mbi një logjikë të domethënies komunikuese që ajo do të ketë, e cila mbështetur mbi historinë e së shkuarës përmes gjuhës së ngjarjeve që ajo ka shprehur, do të fiksojë perspektivën e vet në marrëdhëniet me audiencën. I njëjti proces aktivizohet edhe kur bëhet fjalë për zhandrin e karikaturës. Perspektiva e vet komunikuese duhet të kalojë përmes disa filtrash në mënyrë që misioni i saj të gjejë pritshmërinë më të madhe pozitive të mundshme. Pyetjes së parë që një karikaturë duhet t'i përgjigjet para se të ndërmarrë procesin e formësimit të vet, është se cili kontekst historiko-politik ajo do t'i referohet dhe se me çfarë ideje do të përshkruhet ky kontekst. E ndjekur më pas me subjektin i cili duhet të shënjestrohet në karikaturim. Kush është ai? Çfarë përfaqëson? Cilat janë marrëdhëniet e tija kontekstuale me realitetin social apo me historinë? Pasi

përcaktohen këto linja themelore të idesë qëndrore, karikaturës i duhen bërë pyetje të natyrës: Në çfarë konotacioni do të paraqitet subjekti qëndror? Në çfarë forme do të ketë deformim brënda normave të lejueshme të karikaturimit? Pastaj karikatura do të duhet të renditet në një nga dy grupimet kryesore që zakonisht i karakterizojnë ato. Do të renditet në karikaturat e portretizimit negativist e përcmues apo në grupimin e karikaturave sarkastiko-pozitiviste.

Tjetër element shumë i rëndësishëm i cili e shoqëron karikaturën është simboli që do të përdoret dhe roli i tij në simbolikën e përgjithshme të mesazhit komunikues. A janë ato (simbolet) përfaqësuese të një grupimi politik, social, racor, fetar, seksual etj? Në momentin që njëra nga këto përdoret, a është në kontekstin global apo i referohet thjesht subjektit të karikaturës? Në këtë rast a implikon karikatura shtresa të gjëra sociale në mesazhin e vet dhe nëse po, cili do të jetë qëndrimi i pritshëm që mund të shkaktojë karikatura ndaj këtyre grupimeve? Zakonisht karikaturat shoqërohen nga një tis filozofik i cili e fuqizon jashtë mase mesazhin e saj. Përveç kësaj karikaturat zakonisht shoqërohen me diçidura e cila përbën edhe qershinë mbi tortë të saj. Shpesh diçidura përdoret për të ç'tensionuar një karikaturë negativiste duke e çliruar nga kuptimi i saj i gabuar, ose mund të shprehë një domethënie tjetër nga ajo ç'ka audienca mund të ketë përceptuar për shkak të dykuptimësisë së vet figurative. Karakteristika thelbësore e karikaturës e cila përbën edhe sekretin e suksesit të saj është raporti që ajo ndërton me ekzagjerimin. Ky i fundit është element bazë i cili i ndërthurur së bashku me ironinë, tentojnë të shfaqin në një projektion emulativ një fenomen në një format më të hiperbolizuar se ç'është në të vërtetë përmes një tjetër domethënieje nga ajo literalisht e zakonshme. Tani, kur duam t'i qasemi "buqetës" prej 12 karikaturash të botuara nga "Jyllands-Posten", shohim se shumë elementë të sipërpërmendur kanë dalë nga korniza e tyre tradicionale dhe janë përdorur në luftën, ndaj siç ata preferojnë ta quajnë, "vetë-censurimit" gjithnjë e në rritje. Mirëpo, implikimi bazë që shohim në këtë sipërmarrje është se është përdorur metodologjia e njëjtë që zakonisht përdorej për të ironizuar sistemet politike në ironizimin e një tjetër sferë të shoqërisë siç është religjioni. Prandaj në këtë kontekst, shumë prej përgjigjeve që një karikaturë duhej t'i përgjigjej normalisht, në rastin e futjes së saj në kontekstin religjioz, ngelin jetime. Sigurisht që këto karikatura i përkasin grupimit sarkastiko-negativist me nota të theksuara përcmimi. Ideja qëndrore është përcmimi mbi bazë religjioni me nota racore dhe atribuimi i subjektit kryesor, (Profetit Muhamed) të anomalive aktuale sociale në një kontekst të shkuar historik. Pra një mbivendosje historiko-sociale pa bazë vërtetësie e cila implikon në formë globale jo tashmë një individ apo grupim të caktuar, por një pjesë të konsiderueshme popullsie së globit. Ekzagjerimi si element i saj është në përmasat jashtë normales dhe theyn çdo etikë e cila pranon ekzagjerimin. Ai nuk është ekzagjerim në raport me të vërtetën, por është ekzagjerim i ndërtuar mbi të pavërtetën. Mesazhi apo diçidura janë në një raport tëhuajsimi me mesazhin që subjekti qëndror i karikaturës ka transmetuar në realitetin e së shkuarës së tij, dhe në këtë rast, nuk kemi ironizim bazuar në artikulum por ironizim bazuar mbi sajësë.

Problemet që hasën me aktin e botimit të karikaturave fillojnë që me përjasjen e strukturës ideore të tyre të cilat nuk janë ironizim apo ekzagjerim

bazuar mbi të vërtetën historike. Këto karikatura mbi të gjitha nuk kanë edhe misionin e thjeshtë dhe kryesor që ka një karikaturë, atë për të bërë të qeshë audiencën. Elementi i humorit të shëndoshë aty mungon potësisht gjë që e vë në dyshim qënien të këtyre pikturave në zhanrin e karikaturës.

Karikaturat: Liri e fjalës apo fobi emigrantësh ?

Fleming Rose e konsideronte publikimin e karikaturave si një “akt gjithpërfshirjeje” duke bërë dallime racore dhe religjioze. Vetë shënjestra e karikaturave është e ndarë nga konteksti shoqëror dhe qëllimi që përmes kësaj ndarjeje të qartë të arrihet gjithpërfshirja, duket aq sa qesharak aq edhe jo bindës. E vetmja gjithpërfshirje që mund të konsiderohet këtu, është bashkimi i ndjenjave anti-emigrante në Perëndim. Nëse Rose e ka pasur fjalën për këtë të fundit, atëherë ai ka plotësisht të drejtë. Por nëse i referohemi intervistave të tij në “Washington Post” dhe “Spegel Online”, shqetësimi i tij përmes frazave të tilla si “shkalla e lartë e kriminalitetit tek emigrantët”³⁹ apo “përmbytja demografike nga emigrantët”, hedhin hije dyshimi mbi dëshirën e mirë të tij në lidhje me gjithpërfshirjen kulturore e racore. Këtë mendim na e përforcon edhe një fakt tjetër ku i njëjti Fleming Rose refuzoi të botonte në të njëjtën gazetë “Jyllands Posten” karikaturat që satirizonin holokaustin,⁴⁰ ndoshta sepse identiteti i tij hebre⁴¹ prevaloi mbi lirinë e shprehjes ! Parë në këtë dritë të respektimit të tabuve të të tjerëve, atëherë përse publikimi i karikaturave të Profetit Muhamed ishte kaq ndryshe ndaj këtij principi ? Në logjikën e thjeshtë nuk duket se publikimi i karikaturave të tilla do të ndihmonte në krijimin e një atmosfere gjithpërfshirjeje. Thirrjet për zjarr në mesin e një teatri evropian të mbushur plot me emigrantë, nuk ndihmojnë në dekurajimim e grupeve ekstremiste qofshin këto politike apo jo, as edhe në krijimin e një perspektive të re në marrëdhëniet delikate ndërkulturore. Aq më tepër kur parlamentarë të të djathtës ekstreme daneze i krahasojnë muslimanët me “qeliza kancerogjene”⁴², apo Geert Wilders në Hollandë dhe partia e tij, të cilat haptazi kanë krahasuar Kuranin me Mein Kampf duke kërkuar fundin e “inkursionit islamik” në Evropë.⁴³ Këtë deklaratë Wilders e pasoi me publikimin e filmit “Fitna” tërësisht fyes e denigrues në raport me muslimanët. Ngjarjet që rrodhën pas publikimit të karikaturave, konfliktet, bojkotet, protestat dhe shumë prishje të marrëdhënieve diplomatike, në fakt vërtetuan se gjithpërfshirja e “Jyllands- Posten” luhatej mes fobisë ndaj emigrantëve dhe hipokrizisë së mbrojtjes së të drejtave të tyre në Danimarkë. Fakti që këto karikatura u publikuan në vigjilje të nismës parlamentare për ligjin e ri ndaj emigracionit, ishin një sinjal i qartë i dëshirës së munguar dhe dështimit të autoriteteve daneze për të vazhduar në rrugën e komunikimit ndërkulturore. Në një sondazh të organizuar nga Komisioni

³⁹ Rose, Fleming, “Why I Ran the Muhammad Cartoons” *Spiegel Online*, 31 Maj 2006

⁴⁰ Shih: Eliot Jager, “An islamist new world order”, *Jerusalem Post* 22 Prill 2009

⁴¹ http://en.wikipedia.org/wiki/Flemming_Rose vizituar më 8.05.2013

⁴² Shih, Kahn A. Robert : “The Danish Cartoon Controversy and the Exclusivist Turn”, *Dhjetor 2008*

⁴³ Wilders, Geert, “Contribution to parliamentary debate on islamic activism” 6 Shtator 2007

Evropian mbi sjelljet raciste në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, del se ne vitin 1997, niveli i racizmit në shoqërinë daneze ishte tejet i lartë. Vetëm 17% e danezëve e identifikonin veten si “jo-racistë”, çka e bënte këtë përqindjen më të ulët në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.⁴⁴ Sipas të njëjti burim, del se nga studime të ndryshme të organizuara në Danimarkë, 85% e danezëve nuk kishin ndërveprim apo komunikim me minoritetet etnike, ku ndjenja raciste ishte më e zhvilluar ndaj minoritetit musliman se sa ndaj minoriteteve të tjera.⁴⁵ Duket se është ky formacion homogjen i kulturës daneze të mbyllur në vehte dhe jo komunikues, i cili e ka kthyer situatën të favorshme për racizëm kulturor ndaj kulturave të tjera migratore si formë e gabuar e ruajtjes së identiteve vetjake. Është pikërisht kjo ndjenjë e fortë përjashtuese brënda danezëve e cila përdoret politikisht nga partitë e politikë si dhe nga mediat e shkruara. Kur 83% e danezëve rezultojnë si “pro-racistë”, atëherë imagjini se çfarë artikulimi përhapet në mediat on-line dhe në hapësirën private daneze. Kjo përqindje e frikshme e racizmit detyrimisht shpërfaqet si gjuhë zyrtare edhe në hapësirën publike e cila si gjithmonë përdor kritikën sekulare si gardiane të fjalës së lirë dhe të sekularizmit si sistem. Kështu, ky masivitet dhe intensitet me promotore të herëpashershme median, çon në institucionalizimin e fshehtë të racizmit si kulturë alternative në Danimarkë. Publikimi i karkaturave në “Jyllands- Posten”, që është gazeta më e madhe e Danimarkës, shënoi edhe kulmin e racizmit mediatik nën emër të lirisë së shprehjes, liri e cila për hir të së vërtetës, nuk u përdor për të botuar karikaturat kundra hebrenjve pak javë më parë se të botoheshin ato të Profetit Muhamed.⁴⁶

Konkluzioni

Përmes metodologjisë krahasuese fenomenologjike, pamë se si në përgjithësi liria e shprehjes është një e drejtë e cila është e kufizuar nga të drejta të tjera të individëve të komunitetit bashkëpjestar të një shoqërie. Pra, kjo e drejtë mbështillet nga e drejta e të tjerëve dhe pikërisht kjo balancë të drejtash, përcakton edhe legjitimitetin e fjalës së lirë në marrëdhëniet e saja në një shoqëri, përndryshe tejkalimi i kufirit të njëres liri ndaj tjetres do të thotë sakrifikim i lirisë së tjetrit. Në këtë kuptim të drejtat e të dy grupimeve, të para në konceptin modern juridik, mund të konsiderohen në të njëjtën kohë si interesa shoqërore dhe roli i shtetit qëndron pikërisht në mbrojtjen e tyre ngase interesi shtetëror është i pandarë nga interesi publik (social). Pra, fenomeni duhet parë si ndërveprim të drejtash dhe lirish i cili shndërrohet në konflikt në momentin që shteti si rregullator i këtyre të drejtave, që në të njëjtën kohë janë edhe interesa, të sigurojë mbrojtje ligjore vetëm për njërin dhe duke e lënë tjetrin të pambuluar ose pjesërisht të mbuluar ligjërisht. Pë këtë arsye edhe argumentimi absolutist që vihet re kur përdoret Amendamenti i Parë i Kushtetutës Amerikane si shembull i

⁴⁴ Hussain, Mustafa., “Islam, Media and Minorities in Denmark”, *Current Sociology* 48 nr.4, 2000, f.95

⁴⁵ Po aty...

⁴⁶ Shih, refer. 119

lirisë së pakushtëzuar të shprehjes, duhet parë më me objektivitet, sepse shembujt e mësipërm tregojnë që edhe vetë Amendamenti i Parë, funksionon si garantues lirie në formë parimore, por jo përcaktues dhe përkufizues eksplisit në vetvehte.

Është pak e vështirë të argumentosh faktin, se liria si koncept duhet të qëndrojë e shkëputur, apo thënë ndryshe, e emancipuar nga rendi dhe renditja, nga norma dhe rregulli, për sa kohë ajo si kategori merr formë brënda këtij realiteti. Është pikërisht këtu gabimi që bën Evropa sot kur i qaset marrëdhënieve me muslimanët në rastin e karikaturave, sepse ajo mbron lirinë e shprehjes jo se nuk e kupton që ajo duhet të ketë kufinj por e konsideron si kufirin mbrojtës ndaj religjionit. Gabimi qëndron në të konsideruarit të fenomenit musliman me konceptimin dhe këndvështrimin që ata kanë për Krishtërimin dhe historinë e tij nga këndvështrimi i frikës që shkaktoi pushteti i Kishës në Evropën mesjetare.

Duhet vështruar marrëdhënia e cila është ndërtuar mes muslimanit dhe Profetit të tij, se si sjelljet, fjalët, veprimet apo mosveprimet e tij janë kthyer në një kushtetutë etike për besimtarët, në një ndërveprim intimiteti e dashurie, sepse ai është ligji, ai është liria. Vetëm duke kuptuar se si praktikohet dhe përjetohet liria e çdo muslimani, atëherë do të kuptohet edhe shkalla e dëmit të shkaktuar me publikimin e vizatimeve denigruese, do të kuptohet se sa është shprishur vija e dëmit për shkak të keqkuptimit të lirive. Liria e shprehjes transformohet në liri irracionale, në momentin kur e prish ekuilibrin, ç'orienton vijën e dëmit dhe del nga përgjegjshmëria duke u bërë pre' e pasioneve dhe dëshirave. Pra, kthehet në irracionale për sa kohë ndërhyt në territorin e lirisë së tjetrit, për sa kohë sfera publike konsiderohet si disiplinuese vetëm për të dëgjuar një argument dhe për të qenë e shurdhët ndaj argumentit tjetër. Prandaj qëndrojmë brënda racionalitet kur përpiqemi të kuptojmë dhe të interpretojmë sa më mirë pretendimin e tjetrit, dhe kthehemi në irracionale kur imponojmë pretendimin tonë mbi të drejtën e tjetrit.

Pamë gjithashtu se sa i domosdoshëm është një riformatim dhe rimoralizim i strukturës së kritikës dhe kritikizmit, mbështetur mbi faktin se njerëzimi është tashmë i vetëdijshëm se *"hegjemonia e arsyes"* nuk është e vetmja rrugëzgjdhje e të fshehtave të pafundme që bashkëjetojnë me njeriun. Në momentin kur njeriu ndërtoi hegjemoninë e arsyes së tij dhe e meremtoi atë përmes vetëm një lloji të kritikës, totalisht në funksion të kësaj hegjemonie, ai padashur e reduktoi qënien njerëzore nga një qenie shumëdimensionale, e cila ngrihej mbi imagjinatën, në një qenie të dënuar brënda qelisë së arsyes së vet. Kjo krijon tension mes idesë së të drejtës së qytetarit për privaci të plotë, ku përplotëson lirinë dhe moralin e vet, dhe mënyrës se si ligji ndërhyt në këtë privaci. Pra, kemi moralin në sferën private i cili teorikisht njihet, por që në mënyrë paradoksale zgjidhet me ligje që gjykojnë privaten me pyetje publike. Kështu individit dhe hapësira e tij nuk kanë rrugë tjetër vetëm se të transformohen në hapësirë publike brënda llojit të vet. Prandaj e gjejmë artikullimin justifikues të mbështetësve të publikimit të karikaturave, si procedurë e cila justifikon lirinë për të ndërhyrë tek sfera private e tjetrit nën emrin e një të mirë publike siç është liria e shprehjes. Por çështja e karikaturave, ndryshon nga sjellja rutinë e hapësirës publike sekulare, sepse tashmë ky konflikt nuk ka të bëjë me një shoqëri brënda llojit të vet, por i drejtohet disa

modeleve të tjera shoqërore, siç janë shoqëritë muslimane, të cilat kanë një mënyrë tjetër të të konceptuarit të hapësirës publike e private. Për këtë arsye palët nuk kuptojnë njëra-tjetrën për pasojat e konfliktit sepse më shumë se çështje skicimi artistik, karikaturat përbëjnë në vetvete konflikt për mënyrën se si konceptojnë hapësira publike e private në dy modele shoqërore të ndryshme, ku sekularizmi e kishte shtyrë religjionin në kufinj të individit, ndërsa shoqëritë muslimane religjionin e kishin moral publik.

Sot, bota në sajë të kanaleve masive të komunikimit, internetit, satelitit dhe shumë formave të tjera ndërmjetësuese mes njerëzve, nuk mund të konsiderohet një realitet lokalitetesh të veçuara në të cilat ligje lokale mbizotërojnë. Në kohët tona kur i gjithë planeti tashmë është kthyer në një *Agora* të përbashkët, ato që duhet të prevalojnë mbi vlerat lokale, duhet të jenë vlerat universale si përbashkuese të realiteteve multikulturore. Në këtë kuptim, konflikti mes dy formave të të kuptuarit të moralit të publike e private, në qytetëtime të ndryshme, rezultonte i pashmangshëm.

Problemet që hasën me aktin e botimit të karikaturave fillojnë që me përqasjen e strukturës ideore të tyre të cilat nuk janë ironizim apo ekzagjerim bazuar mbi të vërtetën historike. Këto karikatura mbi të gjitha nuk kanë edhe misionin e thjeshtë dhe kryesor që ka një karikaturë, atë për të bërë të qeshë audiencën. Elementi i humorit të shëndoshë aty mungon plotësisht gjë që e vë në dyshim qënie të këtyre pikturave në zhandrin e karikaturës. Karikaturimi i privatisë përmes kondesimit dhe kombinimit, çon në përplasje të pashmangshme sociale, sepse hapësira private individuale është dhunuar hapur nga hapësira publike e kritikizmit sekular, që në rastin konkret ka përdorur një zhandër si karikatura për të sanksionuar dominimin e vet në shoqëritë sekulare dhe për t'i prishur kufinj të komunikimit në emër të të ashtuquajturës luftë kundra “auto-çensurës”. Po në emër të kësaj lufte, prishet edhe kufiri i dëmit ndaj hapësirës private e cila është tashmë e dënuar të jetë më publike se kurrë. Prandaj përdorimi i karikaturave të ndërtuar me një strukturë konceptimi të një kulture tjetër ndaj po një kulture tjetër, pa kuptuar sensin dhe kontekstin e saj, shkakton “plagosje morale” të pariparueshme sepse tashmë nuk bëhet fjalë se është dëmtuar perceptimi për një subjekt imazherie siç është fjala për Profetin Muhamed, por është cënuar rëndë lidhja intime, vula e ngjashmërisë, përkatësia identitare e çdonjërit që ka ndërtuar këto marrëdhënie mimetizimi.

Për ta vërtetuar pikëpamjen e tij, Fleming Rose duhet që të vërtetojë bindshëm se, që në burimet tekstuale si dhe praktikat universale, Islami është i barazvlefshëm me totalitarizmin. Gjithashtu ai duhet të tregonte se kush i përcakton caqet e auto-çensurës dhe mbi cilin bie barra e çlirimit ndaj saj. Dhe, a është vërtet publikimi i karikaturave mjeti i duhur për të luftuar totalitarizmin si dhe eliminuar çensurën? I gjithë problemi qëndron në keqvendosjen e pritshmërive të Perëndimit në raport me kulturat e tjera migratore. Nuk janë të paktë ata që tregojnë një gadishmëri ekzemplare për të projektuar radikalizmin islam si kundërpalë të demokracisë dhe si kërcënim për rendin demokratik. Për këtë, një hulumtim më i thellë dhe më specifik është i nevojshëm lidhur me faktin se sa shkrirja e kufinjve të të kuptuarit të lirisë në kontekstet ndërkulturore, transformohet në balsamin e zgjidhjes së problemit.

Liri e besimit nuk mundet kurrë të trajtohet si opONENTE e lirisë së fjalës.

Sepse liria e fjalës është pjesë përbërëse e lirisë së besimit dhe anasjelltas. Ndaj edhe dilema liri e fjalës apo liri e besimit ngrihet vetëm nga një këndvështrim sekularist dhe teorive liberale. Kurse kufizimet që natyrshmërisht ekzistojnë dhe duhet të ekzistojnë brenda lirisë së fjalës kur preken dhe çënohen kufinj të rëndësishëm të shoqërisë njerëzore, në të cilin përfshihet edhe besimi, përkundrajt të qënurit problematikë janë një garanci e ruajtjes së sistemit dhe mbarëvajtjes shoqërore. Ashtu siç ka kufinj në lirinë e fjalës në një shoqëri sekulariste kur çënohet struktura dhe funksionimi i saj pikërisht si pasojë e kësaj lirie, ashtu ka dhe duhet të ketë kufizime në shoqëritë liberal demokratike dhe sekulariste kur çënohet liria e besimit, ngase kjo e fundit është pjesë integrale e saj, është frymëzuesja shpirtërore për lëvizjen e ingranazhit stërmadh të kësaj shoqërie.

General Guidelines

Review and Publication Process

A full double-blind refereeing process is used that comprises of the following steps.

- A submitted paper is sent to two reviewers for review. The reviewers' recommendations determine whether a paper will be accepted / accepted subject to change / subject to resubmission with significant changes or rejected.
- For papers which require changes, the same reviewers will be used to ensure that the quality of the revised paper is acceptable.
- Author/Corresponding Author will be notified about the possible date of publication.
- One hard copy of the published journal for each article will be sent to the author/corresponding author. The review process may take up to four weeks.

Copyright

Copyrights for articles published in BJH are retained by the authors, with first publication rights granted to the journal. The journal is not responsible for subsequent uses of the work. It is the author's responsibility to bring an infringement action if so desired by the author.

Manuscript Preparation

1. Language

The language of the manuscript must be in English, Albanian or Turkish.

2. Length of Paper

The length of the paper should not exceed 25 pages. Articles should be typed in double-space (including footnotes and references) on one side of the paper only (preferably A4) with wide margins. Authors are urged to write as concisely as possible, but not at the expense of clarity.

3. Title Page

Title page is a separated page before the text. It should include the following information:

Title

Title should be concise and informative. Try to avoid abbreviations and formulae where possible.

Author's Names and Affiliations

Please indicate the given name and family name clearly. Present the authors' affiliation addresses (where the actual work was done) below the names. Indicate all affiliations with a lower-case superscript letter immediately after the author's name and in front of the appropriate address. Provide the full postal address of each affiliation, including the country name, and, if available, the e-mail address, and telephone number of each author.

Corresponding Author

Clearly indicate who is willing to handle correspondence at all stages of refereeing, publication and also post-publication. Ensure that telephone numbers (with country and area code) are provided in addition to the e-mail address and the complete postal address.

Sponsoring Information

If the research is sponsored or supported by an organization, please indicate it.

4. Abstract

A concise and factual abstract is required (maximum length of 300 words). The abstract should state briefly the purpose of the research, the principal results and major conclusions. An abstract is often presented separate from the article, so it must be able to stand alone. References should therefore be avoided, but if essential, they must be cited in full, without reference to the reference list.

5. Keywords

Immediately after the abstract, provide a maximum of 8 keywords, avoiding general and plural terms and multiple concepts (avoid, for example, 'and', 'of').

6. References

Author(s) should follow the latest edition of APA style in referencing.

Please visit <http://www.chicagomanualofstyle.org/home.html> to learn more about Chicago style

7. Submission Preparation Checklist

Before submitting the manuscript, author(s) should check the following list.

- a) The submission has not been previously published, nor is it before another journal for consideration.
- b) The submission file is in Microsoft Word file.
- c) Manuscript has been made in the light of Journal's author guidelines.
- d) Author(s) did not mention his or her name and affiliation in the main text
- e) Author(s) has read all the terms and conditions of the journal.



Address

"Jordan Misja" St, Tirana - Albania

Contact: Tel: +355 4 24 19 200, + 355 4 24 19 222; Fax: +355 4 24 19 333
www.beder.edu.al, e-mail: bjh@beder.edu.al

